



100 VJET PAVARES!

# Rrugat e Arbërit



www.rrugearberit.com

GAZETË E PAVARUR. NR. 8 (76). GUSHT 2012. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

## OPINION

### Eksperimenti mijëvjeçar

Nga ARTAN LAME - FAQE 3

## REPORTAZH

### Radomirë, Radomirë...

Nga JAHE DELIA(SELMANI) - FAQE 6,7

## HISTORI

### Kuvendi i Arrasit dhe kryengritja kundër serbe

Nga MOISI MURRA - FAQE 15

## PORTRET

### Sheh Mustafë Zerqani

Nga HYSEN LIKDISHA  
DESTAN RAMA - FAQE 18

# Pyjet në rrezik, pas sëpatës vjen zjarri

Dibra, Mati e Bulqiza prej ditësh janë përfshirë nga zjarret. Shtëllunga të mëdha tymi kanë pushtuar çdo fshat e qytet të këtij qarku. Dëmi deri më tani është i pallogaritshëm. Zyrtarët fshehin shifrat, raportojnë të pavërteta

Nga HASAN PASHA

## OPINION

### Dibër, ku i ke bijtë?

Nga: ZAIM ELEZI

Dibra, një krahinë me histori, bëma e kontribute të mëdha. Fati në kohën e ndarjeve, kafshimit të kufijve, bëri që Dibrës ti merret qyteti i Dibrës së Madhe, ti hiqet pikërisht koka, të endet pa të vite e vite, ndoshta shekuj, të kalamendet e të mos identifikohet, e pse që të nënshtrohet më lehtë. Dihet teoria e lashtë e asgjësimit pjesë pjesë, pasi kursesi nuk mundej të asgjësohet si ndryshe.

E kështu fati i saj, i Dibrës dhe i qytetit të Dibrës së Madhe, do të ishte absolutisht i ndryshëm, një fat i arnuar, ku dy gjysmat dobridhna pa mundur të ishin si një herë e një kohë faktor në përcaktimin e fateve të vendit e më së pakti të fatit të vet.

I dhimbshëm po aq sa dhe i dy Dibrave do ishte dhe fati i bijve të tyre. Fati i bijve të Dibrës së Madhe do kërkohet e gjendet nëpër Evropë por në veçanti në Amerikë pasi Jugosllavia nuk do investonte as edhe një qindarkë në qytetin e Dibrës së Madhe për gjatë gjithë kohës së sundimit të saj. Po ashtu edhe Maqedonija me të njëjtën logjikë do e harronte qëllimisht Dibrën e Madhe, qytetërimin dhe historinë e saj, duke e fshehur nga harta e investimeve.

Për habinë e të gjithëve i njëjti fat do e ndiqte edhe Dibrën e këtej kufirit, Dibrën e vogël e cila për 47 vjet me radhë nuk e tërhoqi asnjëherë vëmendjen e qeverisë, të partisë, duke ngelur një skaj e cila ishte e detyruar të kënaqej thjeshtë me vlerësimin e njerëzve që kishin dëgjuar për të si "dibranët janë ndryshe" bëjnë përjashtim nga veriorët e tjerë, e të tjera lëndata të destinuara të konsumohen vetëm nëpër biseda pa asnjë lloj ndikimi për ecjen apo zhvillimin e krahinës.

(Lexoni në faqen 4)



Në foto: Pas prerjeve, Parku Kombëtar i Lurës po shkrumbohet nga zjarri

Pas 20 gushtit të këtij viti numri i vatrave të zjarrit shtohet me shpejtësi marramendëse, në të gjitha masivet pyjore të Qarkut. Lura për ditë me radhë digjet. Flakët kanë përpirë pisha, ah e bredh disa vjeçarë. Megjithëse gjendja paraqitet kritike të gjithë bëjnë sehir. Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor nuk ka mjete e forca për të ndërhyrë. Repartet zjarrfikëse nuk arrijnë në ato masive ku zjarret bëjnë kërdinë. Komuna bën sikur nuk ka ndodhur asgjë, i konsideron mall të huaj.

Jo vetëm Lura digjet për ditë me radhë. Në Hurdhë Tollë, Zallë Gjocaj, Macukull, Balgjaj, Martanesh, Tërnovë, Ostren, Trebisht, Selishtë, Qafë Shtamë, zjarret kanë dëmtuar masive të mëdha më drurë. Aq të mëdha ishin këto zjarre sa që nga larg nuk dalloje dot asnjë fshat a qytet të Qarkut Dibër.

Lexoni në faqe 5

## Ta gjallërojmë Rekën e Epërme

Nga Rexhep TORTE

Mërgimtarët shqiptarë kudo që ndodhen e kanë të ngulur thellë në shpirt mallin për vendlindjen ku janë lindur dhe janë rritur. Ata e vizitojnë shpesh vendlindjen me shpresë se një ditë do të kthehen.

Në këto pushime verore pata rastin të takoj Bardhyl Durmishin nga fshati Zhuzhnjë i Rekës së Epërme dhe dibranin Nexhmi Mati, që të dy mërgimtarë nga zona e Dibës së Madhe që punojnë e jetojnë në Trento të Italisë.

Bardhyl Durmishi njihet si biznesmen i suksesshëm në Trento të Italisë me ndërmarrjen e tij "Korabi" dhe të disa ndërmarrjeve tjera në disa komuna në Itali, që merren me thyerjen dhe modelimin e gurit kubeta dhe të pllakave guri tepër cilësore, të qëndrueshme dhe të kërkuara, që përdoren për shtuarjen e rrugëve dhe shesheve jo vetëm në Itali, por edhe në Shtëpinë e Bardhë në Washington të SHBA. Në pikat prodhuese të këtij biznesmeni janë punësuar afër 100 punëtorë kushërinj, bashkatdhetarë dhe bashkëkombas të tij. Biznesmeni Bardhyl Durmishi, i cili ka mërguar në Itali para vitit 1990, dallohet edhe për angazhimin dhe solitaritetin e tij duke siguruar 100 leje qëndrimi dhe vazhdimin e 40 lejeve qëndrimi për bashkëkombasit që tashmë po punojnë në Itali, por që u ka skaduar afati i lejeve. Bardhyli këtë angazhim të tij e bën me një zell e përkushtim të madh, duke siguruar dokumentacionin e nevojshëm nëpërmjet ndërmarrjeve të tij. (Lexoni në faqen 9)



Gazetë e pavarur.  
Nr. 8 (76). 1 - 31 Gusht 2012

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Njoftojmë zotërinjtë Lutfi Hanksu, Ali Hoxha, Bedri Tahiri, Ermira Babamusta se shkrimet e tyre janë në redaksi dhe do shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.


Shkrimet priten në redaksi deri më datë 20 të muajit.

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN "E".

Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:  
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:  
Musa Riçku  
Shaqir Skarra  
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:

Rexhep TORTE  
Abdurahim ASHIKU  
Hysen LIKDISHA  
Beqir SINA  
Hasan PASHA  
Artan LAME  
Zaim Elezi  
Shpëtim POLLOZHANI  
Mirela SULA  
Moisi MURRA  
Ali HOXHA  
Jahe DELIA (SELMANI)  
Bashkim LAMI  
Qazim HATA  
Rruzhdin BITRI  
Destan RAMA  
Xhelal ROÇI  
Mevlud BUCI  
Shukri HAJDARI  
Saimir SHATKU

Adresa e gazetës:  
Rr. "Zenei Baboçi",  
Pall. "Ferar", Tiranë  
Tel. +355 4 22 33 283  
E-mail: rrugaarberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet  
e botuara nuk shprehin  
domosdoshmërisht  
qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.



## Kaos në miniera: Vdekje, protesta dhe papunësi

### KRASTË, 2 TË VDEKUR

Krasta e Martaneshit është tronditur gjatë muajit gusht nga dy vdekje në gjatë muajit gusht. Më datë 11 gusht, në një nga galeritë e shumta private në zonën e Theknës, gjatë punës ka humbur jetën minatori Gani Doçi, 61 vjeç, pasi e ka zënë nën vete një masiv gurësh minerali të shembur nga tavani i galerisë. Viktima, për çdo ditë udhëtonte rreth dy orë nga fshati Karicë i rrethit të Matit për të punuar në galeri për mbajtjen e bukë të familjes. Ai kishte plot 35 vjet që punonte në këto galeri dhe ende nuk kishte dalë në pension, pasi familja nuk kishte asnjë të ardhur tjetër ekonomike përveçse punës së tij në galeri. Teksa po kontrollonte galerinë me levë për të nisur hapjen e vrimave në ballin e saj, një masiv gurësh kromi është shembur nga tavani i saj, duke e zënë nën vete 61-vjeçarin. I aksidentuari është nxjerrë nga minatorët e tjerë jashtë galerisë, por fatkeqësisht, ai nuk ka mundur t'u rezistojë plagëve të marra, pasi gjatë rrugës për në Spitalin e Bulqizës, ka ndërruar jetë.

Po ashtu, më 30 gusht ka humbur jetën dhe një tjetër është plagosur rëndë në një prej minierave të kromit. Ngjarja ka ndodhur në galeritë e minierës në Komunën e Martaneshit. Viktima është Murat Kaceli, 45 vjeç, nga Mati. Ndërkohë që kolegu i tij i plagosur është Abdulla Hoti, 47 vjeç, nga Mati.

Më 12 gusht, në një nga galeritë e shumta të zonës "D" është shembur një masiv gurësh që ka aksidentuar në gjendje të rëndë minatorin Surja Skara, 26 vjeç, banor i qytetit të Bulqizës. I aksidentuari është goditur nga shembja e masivit të gurëve të galerisë, duke marrë plagë të rënda në kokë dhe këmbë. Menjëherë pas aksidentit, i riu është transportuar në spitalin e Bulqizës për ndihmë mjekësore. Mjekët e këtij spitali konstatuan se gjendja shëndetësore e 26-vjeçarit ishte tejet e rëndë që kërkonte ndërhyrje të specializuara mjekësore. Kjo ka bërë që i aksidentuari të përcillet

me helikopter drejt Spitalit Usharak në Tiranë.

Reparti i Inspektimit Shpëtimor të Minierave, ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të vdekjes së dy minatorëve, G. Doçi e M. Kaceli, dhe plagosjes së dy të tjerëve. Sipas një njoftimi të Ministrisë së Ekonomisë, "Inspektorët e RISHM-it do të ndërmarrin një hetim të thellë me qëllim zbardhjen e plotë të të gjitha rrethanave të kësaj ngjarjeje të rëndë. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës është në ndjekje të plotë të kësaj situatë. Në të njëjtën kohë, METE po bashkëpunon ngushtësisht me pushtetin vendor dhe me Policinë e Shtetit", thuhet në njoftimin e METE-s.

### ACR PRISH MARRËVESHJEN, PUNËTORËT NË PROTESTA

Rreth 65 minatorë të Zonës D, kanë zhvilluar gjatë muajit gusht disa protesta kundër ACR, e cila ka ndërprerë kontratën e punës me firmën turke "Turalba". 66 minatorët e firmës turke nuk janë lejuar të hyjnë në galeri policia private e ACR-së.


"Kushtet janë krijuar për rinisjen e punës, u thanë minatorët medias qendrore, por pikërisht tani kur dhe duhet të rinisë puna për prodhimin e mineralit, drejtori i minierës lëshon një urdhër për të na bllokuar hyrjen në galeri edhe pse kontrata mes ACR-së dhe kompanisë nënkontraktore turke "Turalba" është firmosur sipas ligjit me METE-

### Marrëveshja

## ACR – 15 milionë dollarë për zgjerimin e thellësisë

Pas 20 vitesh që minatorët e Bulqizës por edhe komuniteti prisnin të ndërtohej pusi I thellësisë, Kompania Albanian Chrome sh.p.k (ACR) deklaroi se është gati për fillimin e punës në ndërtimin e minierës dhe siguron të ardhmen e mbi 700 familjeve në Bulqizë. Ky investim në Bulqizë kap shifren mbi 15m USD, duke siguruar kështu një perspektivë afatgjate jo vetëm për këtë rajon por edhe për industrinë minerare në Shqipëri.

Me datë 16 Gusht 2012, është nënshkruar memorandumi i mirekuptimit midis ACR dhe një kompanie të madhe kineze Mining Construction 2nd Division, e specializuar në ndërtimin e puseve minerare sipas të cilit, në minierën e Bulqizës do të ndërtohet një pus vertikal që do të japë akses thellësisë nëntokësore. Pas vizites dhe punës inxhinierike një javore në minierë dhe analizimit teknik dhe profesional të të gjithë strukturave, grupi perfaqësues i Kompanisë Kineze Mining Construction 2nd Division u shpreh shumë i impresionuar vecanerisht nga kushtet e



sigurisë në të gjithë minierën. Ata, gjithashtu u shprehën optimiste për kryerjen e punimeve të metejshme në minierë duke vlerësuar punën e jashtëzakonshme të kryer nga kompania Albanian Chrome gjatë 9 muajve të fundit për garantimin e sigurisë maksimale në punë si edhe për gatitjet për realizimin sa më shpejt të këtij projekti gjigand.

Pjesë e këtij projekti madhor është bërë edhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe dy strukturat e autoritetit mineral,

en, si dhe janë nënshkruar kontratat kolektive dhe individuale tonat me kompaninë turke "Turalba".

Nga ana tjetër, Shoqëria "Albanian Chrome" shpk (ACR) në një njoftim publik për mediat tha se "më datë 28 Mars 2012, ACR ka nënshkruar një marrëveshje me shoqërinë TUR-ALB për dhenien në administrim të galerive të ndodhura në Zonën D. Për shkak të mospermbushjes së një sere kushtesh thelbësore të parashikuara në këtë marrëveshje, më datë 3 Gusht 2012, ACR i njoftoi shoqërisë TUR-ALB zgjidhjen e menjëhershme të marrëveshjes, duke i kërkuar kesaj të fundit lirim dhe dorëzimin e kesaj zone. Njoftimi për zgjidhje të marrëveshjes i është bërë me dije zyrtarisht edhe METE-s, AKBN-se si dhe organeve vendore të ruajtjes së rendit. Nderkohe që ACR po merr masat e duhura për rifillimin e punës në Zonën D, konform të gjitha rregullave dhe procedurave perkatëse, Shoqëria Tur-Alb duke shfrytëzuar një grup punetorësh tenton të futet forcerisht në galeritë e zonës D me pretendimin se ACR i pengon të vijojnë punën normalisht". Ndërkohë, gjykata e Tiranës ka vendosur mosnjohjen e prishjes së kontratës mes ACR dhe Tur-Alb, por punimet akoma nuk kanë filluar. "Zona D e minierës, në shumicën e galerive të saj, vazhdon të mbetet problematike si për nga kushtet e sigurisë teknike në punë pasi është cilësuar nga specialistët si tejet e pasigurt, ashtu edhe nga përplasjet mes "të fortëve" për zaptimin e paligjshëm të galerive, që shpesh kanë degraduar deri në përdorimin e armëve dhe marrjen e jetëve njerëzore siç dhe ndodhi në janarin e vitit të kaluar, kur në një përplasje të tillë me armë mes dy grupeve rivale humbi jetën një person i pafajshëm që ndodhej në zyrën noteriale në qendër të qytetit", shkruan gazeta SHQIP.

Nga: ARTAN LAME

MINATORE TE SHTYPUR

Në Bulqizë u vra minatori i radhës. Para nja dy javësh ishte vrasë një tjetër. Lajm tejet i mërziqshëm, që edhe gazetarët vetë e dinin që nuk do tërhiqte vëmendjen e askujt. Nga halli, për ta bërë disi interesant, thanë se i vrari ishte baba i tre fëmijëve. Prapë nuk e bënë dot lajm interesant. Ca e lexuan në gazeta duke pirë kafënë e mëngjesit: Vritet minator në Bulqizë. –Kamarjer, edhe një kafe të lutem, ngrije pak edhe kondicionerin! Ca të tjerë e dëgjuan në lajmet e drekës, ndërsa i frynin supës në shtëpi: Vritet minator në Bulqizë. –Grua, do edhe pak kripë gjella, po pantoflat ku janë?

Këto ngjarje kanë një mekanizëm funksionimi, që çdo qeveri e pisët e njuh mirë. Halli është kur fatkeqësitë ndodhin për herë të parë. Në atë moment shoqëria shokohet dhe traumatizohet. Po qe se ngjarja është e rëndë, shoqëria bën vaki edhe mund të reagojë. Demonstron, bën grevë, zë rrugën, madje mund të shkojë deri në përlëshje. Në një popull si ky i yni, ku punëtori nuk bën dot grevë se e gjen vëndin të zënë kur të kthehet, zor se mund të arrihet deri në përlëshje, por sidoqoftë, në vdekjet e para nëpër miniera, edhe mediat reaguojnë gjatë, edhe publiku pati njëfarë reagimi. Pas vdekjeve të para, qeveria mund të flejë e qetë. Minatorët mund të vazhdojnë të vdesin edhe nga një në ditë dhe asgjë nuk do të ndodhë. Media mërziqet me faktin se nuk përbën më lajm, njerëzve nuk u tërheq më vëmendjen se është një gjë me të cilën janë mësuar.

Madje mendoj se gazetaret duhet të ndryshojnë edhe terminologjinë. Është e gabuar kur shkruajmë: Vritet minator në Bulqizë. "Vritet" është term heroik, që vlen kur flasim për ushtarë që i zë plumbi në llogore. Minatorët nuk e kanë këtë fat, ata thjesht shtypen nën dhë.

Unë vetë, kur filloi masakra e jetëve në Bulqizë, shkrojta një shkrim të gjatë dhe m'u duk se ç'është kisha bërë. Sipas zakonit, mora edhe mesazhe, SMS e e-mailë mbështetjeje. Pastaj vdekjet e minatorëve vazhduan me një ritual të mërziqshëm. Pas ca kohësh botova një shkrim të dytë për këtë çështje. Jam i bindur se edhe të tjerë analistë kishin bërë të njëjtën gjë. Por kësaj radhe as mesazhe, as SMS e as e-mailë. Jo se shkrimi s'ishte gjë. Jo, thjesht nuk përbente më lajm. Vdekja e minatorëve me gjoks të shtypur nën dhë dhe kërcinj të thyer nën gurë nuk është më krim, tani ajo është thjesht statistikë. Nuk është ndonjë shpikje e jona kjo, e ka thënë Stalini në kohë të vet: "Vrasja e një njeriu është krim, vrasja e një milion njerëzve është statistikë". Kështu që, të ulem e të bëj një shkrim të tretë për këtë punë, thjesht e vetëm se një tjetër fatzi humbi jetën në errësirë, nuk ja vlen barra qeranë.



# Ekspërimentit mijëvjeçar

GALERITË PRIVATE

Shqipëria, me kaosin e vet të një Svendi kontradiktor, prodhon kohë pas kohe terma absurde që pasqyrojnë dhe mund të ekzistojnë vetëm në situata absurde. Para ca vjetësh krijuam termin antimiting për shembull. Tani gazetarët kanë krijuar termin "galeri private". Ka kuptim të thuash miniera private, por edhe në këtë rast, ku dallon kjo nga galeria private?!

Arkeologët thonë se, dikur, në fillim të epokës së bronzit, pjesa më e madhe e sipërfaqes së tokës ishte e mbuluar me mineral bakri. Ndërsa sot bakri nxirret nga thellësitë e tokës, asokohe, 5-6 mijë vjet të shkuara, pjesa më e madhe e hapësirave të Euro-Azisë kishin me shumicë në sipërfaqe mineral bakri. Nga i gjithë ky mineral në gjendje natyrale, sot nuk ka mbetur asgjë. Në ata 3 mijë vjet që vazhdoi epoka e bronzit, njerëzit primitivë e mblodhën dhe e përpunuan të gjithin, duke e kthyer në bakër e bronz. Fillimisht, për qindra e qindra vjet mblodhën mineralin pranë vendbanimeve të tyre, pastaj atë që ishte disi më larg, pastaj gjithnjë e më larg nga krahina të tjera. Nuk duhej ndonjë mjeshtëri e madhe, ishte një punë që mund ta bënin edhe gratë e fëmijët, ashtu siç e bëjnë edhe sot ata nëpër pirgjet e Bulqizës.

Pastaj, duke u zhdukur gradualisht minerali sipërfaqësor, filluan të gërmojnë nga pak për të nxjerrë atë që ishte disi më thellë. Filluan të hapin vrime e gropa, tunele, puse e galeri, që shkonin deri në disa metra thellë. Punonte babai dhe vëllezërit e rritur brenda në vrime, ndërsa gratë e fëmijët mblidhnin në sipërfaqe koshat që nxirrnin ata me litarë nga poshtë. Tamam

**Në një popull si ky i yni, ku punëtori nuk bën dot grevë se e gjen vëndin të zënë kur të kthehet, zor se mund të arrihet deri në përlëshje, por sidoqoftë, në vdekjet e para nëpër miniera, edhe mediat reaguojnë gjatë, edhe publiku pati njëfarë reagimi. Pas vdekjeve të para, qeveria mund të flejë e qetë. Minatorët mund të vazhdojnë të vdesin edhe nga një në ditë dhe asgjë nuk do të ndodhë. Media mërziqet me faktin se nuk përbën më lajm, njerëzve nuk u tërheq më vëmendjen se është një gjë me të cilën janë mësuar.**

**Vdekja e minatorëve me gjoks të shtypur nën dhë dhe kërcinj të thyer nën gurë nuk është më krim, tani ajo është thjesht statistikë.**

**Midis epokës së bronzit dhe revoltave të skllëverve të antikitetit, kaluan rreth 2 a 3 mijë vjet. A thua se kaq kohë do të duhet të kalojë edhe në Bulqizë që bijtë, gratë dhe vëllezërit e atyre që japin shpirt ndën dheun e nëndheut, të ngrihen e të thonë "Mjaft më"!**

ashtu sikundër ndodh ende sot në Bulqizë.

Por vitet e shekujt kalonin dhe bëhej gjithnjë e më e vështirë për ta nxjerrë mineralin në nivel të bërthamës familjare. Në atë kohë u bë e domosdoshme organizimi në grupe më të mëdha e deri në struktura shtetërore. Vetëm shoqëritë e organizuara shtete të antikitetit, mund të vazhdonin të nxirrnin nga nëntoka mineralin e nevojshëm. Tashmë duheshin njerëz që të punonin thellë nën tokë, duheshin hapur rrugë për të transportuar mineralin e nxjerrë, duheshin mbajtur posta ushtarake për t'u ruajtur nga

sulmet e plaçkitjet, e kështu me radhë. Kjo ka ndodhur diku rreth mijëvjeçarit II para Krishtit dhe këtu nuk mund të bëjmë më krahasim me Bulqizën. Ajo që ndodh në Bulqizë është ende mblendhja e mineralit në sipërfaqe nga fëmijë e gra, apo nëpër galeri nga burra në nivel familjar, ashtu sikundër 4 a 5 mijë vjet më parë. Në shekullin e XXI pas Krishtit, Bulqiza është kthyer prapa diku në mijëvjeçarin III para Krishtit. Është një rast studimor që ja vlen të analizohet nga shkencëtarët. Një shoqëri e shekullit XXI që ja del me sukses të kthehet prapa gati 4 mijë vjet.

ARKEOLOGJI EKSPERIMENTALE

Ka një degë të arkeologjisë që quhet "Arkeologjia eksperimentale". Ajo merret jo thjesht me zbulimin e fakteve dhe gjetjeve nga e shkuara, por edhe përpjet t'i vëjë në funksionim zbulimet e bëra, për të parë se si funksiononin në realitet. Pra, nuk mjaftohet me zbulimin e një maji shigjete, por edhe përpjet që mbi bazën e saj ta riprodhojë të gjithë shigjetën, ta riprodhojë edhe harkun dhe të shohë se si funksionon.

Ajo që po ndodh sot në Bulqizë, është një rast i arkeologjisë eksperimentale, për të parë se si është nxjerrë minerali në periudhën e parë të epokës së bronzit, atëherë kur shoqëria nuk e tejkalonte organizimin familjar të punës. E kemi të gjallë e vepruese midis nesh, njerëzve të shekullit XXI, një pamje të tre mijëvjeçarëve më parë! Shkenca nuk mund ta lërë t'i humbë një shans i tillë! Mund të shërbejë ky eksperiment tragjik edhe për të përcaktuar vdekshmërinë e punëtorëve të 3 mijë vjetëve të shkuara, duke u mbështetur në vdekshmërisë së bulqizakëve të sotëm. Ose mund të shërbejë ky eksperiment i vërtetë, për të përcaktuar se sa kohë do t'u duhen njerëzve të shtypur kështu për të reaguuar ndaj shtypjes. Se ja, midis epokës së bronzit dhe revoltave të skllëverve të antikitetit, kaluan rreth 2 a 3 mijë vjet. A thua se kaq kohë do të duhet të kalojë edhe në Bulqizë që bijtë, gratë dhe vëllezërit e atyre që japin shpirt ndën dheun e nëndheut, të ngrihen e të thonë "Mjaft më"! Po qe kështu, si shumë i gjatë do jetë ky eksperiment. (Shqip)



Dibra, Mati e Bulqiza prej ditësh janë përfshirë nga zjarret. Shtëllunga të mëdha tymi kanë pushtuar çdo fshat e qytet të këtij qarku. Dëmi deri më tani është i pallogaritshëm. Zyrtarët fshehin shifrat, raportojnë të pavërteta

# Pyjet në rrezik, pas sëpatës vjen zjarri

Nga HASAN PASHA

Dibra, Mati e Bulqiza prej ditësh janë përfshirë nga zjarret. Shtëllunga të mëdha tymi kanë pushtuar çdo fshat e qytet të këtij qarku. Dëmi është i pallogaritshëm. Vetëm zyrtarët e Shërbimit Pyjor e thonë: "Vetëm pasi të kenë pushuar zjarret mund të llogaritet dëmi i shkaktuar në pyje".

Afro një muaj më parë në veri të Fushë Lurës një vatër zjarri e fuqishme përfshiu masive të tëra me pisha. Banorët dhanë alarmin dhe pas disa ditësh një togë ushtarësh nga Reparti i Burrelit mbërritën atje për të shuar flakët. Ndodhi mrekullia. Pas dy ditësh përpjekje me mjete rrethimore, një shi i fuqishëm shuan të gjitha vatrat e zjarrit në Lurë dhe zona të tjera të Qarkut.

Ndërkohë pas 20 gushtit të këtij viti numri i vatrave të zjarrit shtohet me shpejtësi marramendëse, në të gjitha masivet pyjore të Qarkut. Lura për ditë me radhë digjet. Flakët kanë përpirë pisha, ah e bredh disa vjeçarë. Megjithëse gjendja paraqitet kritike të gjithë bëjnë sehir. Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor nuk ka mjete e forca për të ndërhyrë. Repartet zjarrfikëse nuk arrijnë në ato masive ku zjarret bëjnë kërdinë. Komuna bën sikur nuk ka ndodhur asgjë, i konsideron mall të huaj.

Jo vetëm Lura digjet për ditë me radhë. Në Hurdhë Tollë, Zallë Gjocaj, Macukull, Balgjaj, Martanesh, Tërnovë, Ostren, Trebisht, Selishtë, Qafë Shtamë, zjarret kanë dëmtuar masive të mëdha më drurë. Aq të mëdha ishin këto zjarre sa që nga larg nuk dalloje dot asnjë fshat a qytet të Qarkut Dibër.

Ajo që u ka bërë përshtypje banorëve të Dibrës është mashtrimi i tyre nëpërmjet medieve të ndryshme vizive, të shkruara dhe radiofonike. Zyrtarë të Emergjencave Civile nuk e kanë patur problem të gënjejnë nga mënjësi në darkë. "Janë 4 vatra zjarri në Qarkun e Dibrës"-emetonte një ditë një media. Ndërkohë që tetë vatra aktive ishin vetëm në rrethin e Matit. Mjaftonte një vështrim vizual për të kuptuar sa vatra kishte në rajonin e Dibrës. Vesin e zyrtarëve të lartë e morën në ditët e mëpasme dhe drejtuesit lokal. Ata nuk raportojnë rreth vatrave të zjarrit. Shumë prej tyre preferuan të pushojnë në plazhe, të punojnë në fermat e tyre apo të dëfrehen ku të mundnin.

Pas këtyre fakteve rrëqethëse nuk mund të mos habitesh kur mëson se megjithëse situata ka qenë kritike në Dibër nuk është mbledhur deri tani Shtabi i Emergjencave Civile. Asnjë zyrtar nuk e ka prishur terëzinë, paçka se dëmi i shkaktuar është aq i madh sa ai nuk mund të llogaritet. Mbledhja e këtij shtabi mund të nxiste më mirë repartet e zjarrfikëseve, kryetarët e komunave, policinë, banorët e fshatrave për të ndihmuar në shuarjen e zjarreve. Ky shtab mund t'i kërkonte Qeverisë ndihmë për të ndërhyrë nga ajri, pasi terreni ka qenë i thyer.

Dëmi duhet parë dhe në aspektin ekologjik. Do të duhej dekada e shekuj për të zëvendësuar pyjet e dëmtuar. Një dru pisha, ahu apo bredhi do shumë vite të rritet. Veç prerjeve të paligjshme për dy dekada me radhë, djegiet e fundit janë dëmi më i madh që u shkaktohet pyjeve në Qarkun e Dibrës.

Burime zyrtare pranë Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Mat pohuan se nga të dhënat paraprake janë djegur plotësisht 30 hektarë me pyje të lartë dhe janë përshkuar nga



Pas 20 gushtit të këtij viti numri i vatrave të zjarrit shtohet me shpejtësi marramendëse, në të gjitha masivet pyjore të Qarkut. Lura për ditë me radhë digjet. Megjithëse gjendja paraqitet kritike të gjithë bëjnë sehir. Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor nuk ka mjete e forca për të ndërhyrë. Repartet zjarrfikëse nuk arrijnë në ato masive ku zjarret bëjnë kërdinë. Komuna bën sikur nuk ka ndodhur asgjë, i konsideron mall të huaj.

Jo vetëm Lura digjet për ditë me radhë. Në Hurdhë Tollë, Zallë Gjocaj, Macukull, Balgjaj, Martanesh, Tërnovë, Ostren, Trebisht, Selishtë, Qafë Shtamë, zjarret kanë dëmtuar masive të mëdha më drurë. Aq të mëdha ishin këto zjarre sa që nga larg nuk dalloje dot asnjë fshat a qytet të Qarkut Dibër.

Vesin e zyrtarëve të lartë e morën në ditët e mëpasme dhe drejtuesit lokal. Ata nuk raportojnë rreth vatrave të zjarrit. Shumë prej tyre preferuan të pushojnë në plazhe, të punojnë në fermat e tyre apo të dëfrehen ku të mundnin.

flakët më shumë se 300 hektarë të tjerë. Ndërkohë nga DSHP Dibër e Bulqizë nuk ka të dhëna në lidhje me sipërfaqet e djegura. Por një gjë dihet me saktësi. Edhe shifrat që jepen nga DSHP Mat janë jo reale. Dëmi është disa fish më i madh.

Për shkak të zjarreve blegtorët që ishin ngjitur në bjeshkë për verim janë detyruar të largohen, të mbrojnë kokën e tyre dhe bagëtive të pafajshme. Ka barinj që zjarret i kanë vënë për ripërtëritjen e kullotave, ndërkohë që kanë shkaktuar një dëm të paparë në pyjet e lartë dhe ato me dushqë e kullota.

A ka përgjegjës për zjarret në masivet pyjore të Matit, Dibrës e Bulqizës? Sigurisht që duhet të ketë. Policia lokale njoftoi ditët e fundit se ka dërguar për procedim penal 10 persona për dëmtim prone me zjarr. Menduam se ishin kapur zjarrvënës të qëllimshëm në pyjet e begata të Lurës, Balgjajt apo Tërnovës. Po jo. Bëhej fjalë për procedimin e disa banorëve të Maqellarës që kanë djegur traktorin e një firme ndërtimi. Ndërkohë dukej si gazmore kur komunikata zyrtare e policisë bënte të ditur se një i sëmurë mendorë i kishte vënë flakën një masivi në Fushë Bulqizë. Ku janë specialistët e Drejtorive të Shërbimit Pyjor, të ngarkuar në zonat përkatëse? Si nuk kanë arritur të identifikojnë qoftë një autor zjarrvënës? Si nuk "hetohet" barinjte që verojnë në male për këto zjarre? Kjo pandëshkueshmëri solli këtë katastrofë. Solli këtë rrimin të pyjeve në Dibër, Bulqizë e Mat. Solli këtë dëm që as pushtuesit nuk do ta bënin.



# Radomirë, Radomirë...

Nga: **JAHE DELIA(SELMANI)\***

Është viti i tretë që Radomira feston bashkimin e saj në Korab dhe populli ka të drejtë kur thotë: "E treta, e vërteta". U bë në vitin 2010, u bë në vitin 2011, u bë dhe sivjet e do të bëhet për jetë e mot, se urimi i të moshuarve në sofrën e madhe ku u ulën mbi 500 vetë më 29 qershor 2010 ishte "Për shumë vjet!" Tradita u krijua, tradita vazhdon. Ky vit ishte i veçantë, se dhe objektivat ishin të veçanta. Është viti i 100-Vjetorit të Pavaresisë e Radomira përkujton jo vetëm këtë ditë të madhe, por dhe 100-Vjetorin e Luftës së Qafës së Kolesjanit. Është folur e do të flitet gjithmonë për këtë Luftë që mbetet legjendë e gjallë e ku Bajraku i Radomirës e shkrepri i pari e dha dhe dëshmorin e parë, vetë bajraktarin, trimin e paepur Ibrahim Gjorgji. Emri i tij tani është bërë edhe më popullor, po përjetësohet në kengët e reja që janë një vazhdim i atyre që na kanë arritur fill pas atyre ditëve të stuhishme, si "Ibrahim Zeqiri fluturon si zog, Nuk e lamë për nesër, do t'i biem sot..."

Ajo ditë nëntori e vitit 1912 na ka ardhur e gjallë edhe nga dëshmitarë që luftuan për krah Ibrahimit, i cili nuk u pajtua me vendimin e shtabit të Luftës për të pritur mëngjesin e së nesërme duke dhënë argumente shumë bindëse: Ushtria serbe mëson udhët e ka kohë për masa të reja. Dhe mendimet e këtij bajraktari që nuk i kishte mbushur 30 vjet triumfuan, luftëtarët morën abdes e u përgatitën me vdekje. Ibrahim hidhet i pari me flamur, ushtria e Lumës dhe Dibrës hidhen e ushtria e madhe serbe fillon tronditjen që do t'i kushtonte 12000 mijë të vranë. Vritet i pari e plagoset shoku në krah dhe dëshmorë të tjerë do ta skuqin atë Qafë heroike.

Shoqata "Korabi-Radomirë" këtë vit mori masa të tjera për ta bërë "Festën e Korabit" edhe më domethënëse, që në fillim u bashkëpunua me pushtetin vendor për koordinimin e veprimtarive. Dhe veprimtaria e parë e datës 6 korrik ishte ceremonia e emërtimit të shkollës së Radomirës me emrin e dëshmorit Ibrahim Gjorgji. Por le t'i lëmë pak kohë udhëtimin nga Tirana në Radomirë para se të arrijmë të ceremonia. Ishte dëshira e të gjithëve që data e Festës të kalonte në korrik, se ditët e fundit të qershorit Korabi akoma ka borë dhe në dy vite na u desh të vishnim xhupa.

Dikush që nuk e njeh Korabin mund të çuditet kur mendon se vapa në fundin e qershorit në Tiranë është krejt prezente. Edhe ne që brenda ditës provonim këtë ndryshim klime nuk i besonim vetes, por Korabi i lartë i ka tekat e veta. U vendos ë Korriku. Patëm probleme, se dita që e zënë me dasëm, por që e vështirë ndërrimi i datës. Hazitimi i ditëve të para për mosardhje u zëvendësua me mirëkuptimin e Hajredinit, Sherifit, Nurishit, Lavdrimit, Nexhipit, Hakikut etj. Ata bënë sakrificë, bënë edhe Festën, edhe dasmën. Radomira përherë bashkë, në luftë e gëzime. Dhe ora e fiksuar ma parë njerëzit i gjeti para lokaleve Ahmati e Kupa, grupe-grupe po pinë

kafen e po çmallen, kamarrierët kanë shumë punë deri në nisje, kanë ardhur të na përcjellin dhe ata që kanë dasmën në shpi e shprehin keqardhjen që nuk mund të vijmë. Është vendi të pranojmë dhe gabimin e mosnjohimit nga Shoqata të datës së ndryshuar, por çdo fillim ka dhe gabimet e veta. E data nuk ndryshon, tani edhe emigrantët e kanë marrë vesh e, sipas mundësive, marrin pjesë. Dhe nuk qenë të paktë, mot do të jenë më shumë. Vargani i makinave merr udhë, shoferët nuk harrojnë të venë në xham logon e ditës që paraqet një pamje mbresëlënëse të Korabit ku bardhësia e borës që nuk do të dorëzohet dhe gjelbërimi i barit krijojnë pamje përrallore që shoqërohet me fjalët: "Radomira hapi krahët". Nuk qenë ditë të lehta ato para nisjes, njerëzit ishin të shpërndarë, por shokët e Shoqatës nuk përtuan, ata çdo mbrëmje mbledheshin te lokali "Kupa" e "Ahmati" për të marrë masat e duhura. Shpesh Abdylit, Hajredini, Lavdrimi qerasnin vetë, le që Xhevdeti Shkëlqimi, Limoni e të tjerë "tinëzish" kishin mbaruar punë me kamarierin. Ramazan Hima vjen nga Amerika, lokalet në Filadelfia i ndjek vëllai, Xhevdeti me njerëzit e tij që janë shtuar atje. Para disa muajsh, kur Shoqata do të hapte adresën në internet, nuk na la kohë të humbim, por nxorri nga xhepi gjithë shumën e duhur e duke na thënë t'i themi sa herë që Shoqata do të ketë nevojë. E si ky kanë vepruar dhe të tjerë si vitin e kaluar kur u investua për atë xhadenë e "famshme" që mbeti për ibret, si këtë vit për kryerjen e veprimtarive të planifikuara.

Modestia është veti kryesore e radomirasve, se udhëhiqen nga parimet kuranore që, "kur jep e djathta, të mos e dijë as e majta", por nuk do ta mbaj fjalën e do të përmend vetëm disa, se janë shumë. Vetëm në takimin e fundit te lokali i Hajredin Ahmatit koontribuan menjëherë Gzim Kupa, Shkëlqim Kupa, Zaim, Abdyl e Liman Kupa, Kujtim Ferati, Petrit e Riza Gjorgji. Vetëm një telefonatë dhe Sokol Daku dorëzoi shumën e konsiderueshme, biznesmeni Rexhep Selmani premtoi jo më pak se 500 mijë e do ta bëjë realitet. Hakik Daku nuk u mendua shumë kur dha po këtë shumë vjet apo Man Kupa, Ramazan e Rasim Daku, Hajredin, Nurish e Lavdrim Ahmati, të ndjerët vëllezër të paharrëar që ndërruan jetë brenda 10 ditësh siç u deshën në jetë, Adil e Seladin Hima e të tjerë që duhet të më falin pse nuk mund t'i përmend. Nuk është për t'u çuditur me këta djem, se janë pasardhës të atyra burrave të shquar që e kanë ndarë pasurinë me fukaranë, se Riza e Tasim Ahmati, Bajram Kupa, Rrahim Daku, Zabit Hima, Cen Canja, Ali Jakupi e shumë e shumë të tjerë nuk ndiheshin rehet kur shoku e komshiu nuk kishte, se Haxhi Hasani ndërtonte ujësjellësa e xhami kudo e nuk donte t'i përmendë emri, se kur Lufta Ballkanike i mori Radomirës afro 100 mijë kokë dele, humanizmi që vetia e parë, çdo gjë që kish mbetur u nda me njëri-tjetrin, se kur shumë blektorë linin në fushat

brenda e jashtë vendit tufat e dhenve nga sëmundje a metilit, menjëherë u krijohej tufa e re me të tjera që u jepeshin falas. E radha e argumentave që fillojnë me "se" mund të vijojë dhe me ato donacione dhjetramilionësh të viteve të fundit nga radomirasit në xhaminë e Radomirës, të Paskuqanit etj. e përsëri nuk duan t'u përmenden emrat. Ndofta u zgjatëm pak, por ia vlen, bile nuk mjafton.

## DY NGJARJE TË SHËNUARA BRENDA DITËS

Makinat nisen në kolonë e, pas kufizimeve të shpejtësisë deri në Milot, ato rrëmbehen nga autostrada e re që brenda orës i çon në Kukës. Ndajesa në Kukës kësaj here nuk është e gjatë, në orën 10 këshilli i komunës ka një mbledhje të veçantë: do të shpallë

"Qytetar nderi" dy figura që i bëjnë nder gjithë kombit: shkrimtarin e madh Dritëro Agolli dhe dhe historianin me famë Kristo Frashëri. Ç'koincidencë e bukur në vitin e 100-Vjetorit! Sa nder i madh e i merituar për popullin e Kalasë së Dodës e të Dibrës. Sa për kuriozitet: shkrimtari i madh ka pohuar se subjektin e romanit "Njeriu me top" e ka marrë në Dibrë, ai Mato Gruda me shpirtin që i zjen ka diçka nga vitaliteti dibran, kurse historiani i madh mbrojtë shkencërisht origjinën dibrane të Skënderbeut, siç bëri më pas dhe Fatos Daci. Arritëm pak vonë në qendër të komunës ku këshilli i saj shpalli unanimisht dy figurat e mëdha "QYTETAR NDERI I KALASË SË DODËS". Dhe takimi tjetër është të shkolla 9-vjeçare Radomirë. Atje na presin mësues, nxënës, prind e të ftuar. Ngazëllim te të gjithë, por më shumë të pasardhësit e Ibrahim Gjorgjit. Emri i tij që sot do t'i bëjë nder kësaj shkolle me jetë afro gjysëmshkulllore ku u edukuan shumë breza nxënësish shumica e të cilëve sot kanë ardhur nga brenda e jashtë vendit për ta kujtuar tempullin e dritës. Malli e nostalgjia na rrëmben të gjithëve, akoma janë mollët që mbolli e rriti mësuesi i talentuar, i ndjeri Fahri Hysa, janë gjurmët e pashlyeshme që la në këtë shkollë për shumë vjet ish-drejtori, i ndjeri Myftar Halili, akoma na duket se vazhdon të japë gjuhën e bukur shqipe i ndjeri Rifat Selmani që punoi një jetë të tërë këtu e në Paskuqan. Na del parasysh e duket sikur na uron për këtë ditë dhe mësuesi i talentuar Jashar Hoxha që nuk e arriti këtë ditë, se vdekja e ndau nga ne para kohe. E shumë të tjerë në punë e në pension në vendbanime të ndryshme si: Alush Cala, Rasim Deda, Sul Istrefi, Xhemal Domi, Agim Rrahim, Lulzim e Ethem Shehu, Fadil Daku, Shazivar e Zurie Koka, Hozur e Ilmi Daku, Nazene e Sabihate Domi, Rremzie Selmani etj apo të larguar më herët, Bajram Ndreu, Beqir Shehu, Mersim Sopot, Nazmi Laçi etj. Kjo shkollë e zhytur në gjelbrimin e stinës kurrë nuk priti aq mysafirë të largët, ose të ardhur nga larg, se janë bij të këtij vendi. Na pret drejtori i shkollës

Bujar Mahmuti, i cili na uron mirëseardhjen e gjen kohë të na qerasë më ç'mundet.

Në zyrën e tij modeste ka kohë që ka ardhur dhe drejtori i DAR Të Qarkut Dibrë z. Gëzim Kaba i shoqëruar dhe nga drejtori i gjimnazit Peshkopi Ylber Daci që edhe ka punuar te kjo shkollë bashkë me vëllain e tij, Bilbilin. Z. Gëzim duket si i shtëpisë, plot thjeshtësi e modesti përfshihet në organizim. Populli në oborr pret dhe ceremonia fillon. E hap drejtori i shkollës, i cili vlerëson nderin që po i bëhet shkollës e Radomirës e premtos për t'i çuar më tej arritjet në procesin mësimor. Kryetari i komunës z. Bajram Hima lexon Vendimin që emërtos këtë shkollë me emrin e dëshmorit. Kryetari i këshillit të komunës Kadri Visha zbulon pllakën ku është shkruar aq bukur: "Shkolla 9-vjeçare "Ibrahim Gjorgji" Radomirë. Ish mësuesi i kësaj shkolle Metush Skeja lexoi një material të veçantë e vlerësues për këtë figurë. Përsëritet z. Gëzim Kaba që vlerësoi këtë ngjarje si shtysë e detyrim për arritje më të mëdha. Atmosferën e bën shumë simbolike shpërndarja e fletëlavdrimeve 5 nxënësve më të mirë. Pasardhësi i familjes së dëshmorit që mbaroi shkëlqyeshëm Kl. IX Shefit Gjorgji, merr fletën e lavdërimit ku është emri i Ibrahim Gjorgjit. E simbolika mbaron me marrjen e kësaj flete nga nxënësi më i vogël Alltan Selmani djali i ish mësuesit Ismet Selmani që u nda nga jeta vitin e kaluar në moshë të re. Nuk mundi të vinte në këtë festë më i moshuari i familjes Gjorgji, Rasimi, që po plotëson shekullin, por ka dhënë porosi që asnjë pjesëmarrës të mos ikë "pa e pi një kafe" dhe djemtë e nipat e tij shpërndajnë pije të ndryshme. Ndërsa vazhdon ky koktejl aq origjinal nën hijen e pemëve, rapsodi Mifeterim Kupa e Fatmir Daku këndojnë këngën për Ibrahim Gjorgjin, këngëtar Arif Madana i sapokthyer nga një koncert në Austri me ansamblin "Shqiponja" këndon këngën për Radomirën, poeti Munir D. Hoxha reciton krijime për dëshmorin e për Radomirën. Ka sjellë dhe librin e tij të dytë, i cili nuk arrin t'i plotësojë të gjitha kërkesat. Ishte një promovim shumë domethënës. Atmosfera do të vijojë e tillë deri pasdite kur lodrat e culat do të ftojnë në valle mësuesin e drejtuesin veteran Rasim Deda që nuk e ndien fare moshën apo të talentuarin Nurish Ahmati që zotëron gjithë baçen i ndjekur nga kushërinjtë e tij. Largohe mi nga ky kënd i bukur e i qetë ku akoma duket se dëgjohej ato shakatë plot kripë të Sulejman Istrefit (Përzhiillës) dhe të ndjerit Ismet Sinani apo fizarmonikën e Lulzim Shehut që shoqërontë këngët e Ethem Shehut apo të grupeve të shkollës e të Kalasë në aktivitetet e shumta të atyre viteve.

Këtu mësuesi i talentuar Agim Shehu krijoi grupin e famshëm të djemve që korri sukses në Tiranë. Eh, sa shumë kujtime, nuk di si ndahesh nga ky vend, nga ky kënd i qetë që vlonte nga puna e entuziazmi e ku vështirësitë e kohës i përballonim në unitet e mirëkuptim. Largohe mi duke lënë një pjesë të qenies sonë, kështu ka ka jeta... Çuditërisht sot kanë ardhur dhe disa operatorë televizivë, ne i falenderojmë, vitet tjera nuk e mundësonte xhadeja e re që lidh me asfalt Dibrën me Kukësin, shpësojmë të lidhet dhe Tejsi, Sterdoku e Radet, se nga këtu fillon ngjitja për Korab. Atje do të ngjitemi dhe ne nesër.

## MIRË SE ERDHËT!

Ky është urimi i parë sapo zbresim në Tejsi pasi lëmë shkollën e Radomirës tani me një emër të ri të fshehur mes gjelbërimit e përballë sfondit madhështor të Gipsit të Çernjevës. Parkojmë kudo, bile dhe në Sterdok nga ku shfaqet ajo pamje e papërsëritshme. Veterani Fehmi Ahmati 90 vjet nuk i ndien vitet, rrugën për Korab as që e ka problem, na shoqëroi e na përshëndeti edhe të shkolla, por dhe tani ka arritur para nesh në Tejsi e uron mirëseardhjen bashkë me të tjerë. Gjallërohen lokalet, ato po shumëzohen e plotësohen. Lokali i Iljaz Ahmatit, i Esat Hoxhës, i Sutki Ahmatit e i Haxhi Himës mbushen me të ardhur e me pritës. Shërbehet gjithçka, gjallëri, entuziazëm. Zëri i Kasam Himës është pak më i lartë, ka marrë dhe vëllain, Halimin e po gëzojnë bashkë. Banojnë në Tiranë, por zemra nuk u ndahet. Shtëpitë këtu po i përshtatin më së miri, gjithçka moderne, por duke e ruajtur trditën e ndërtimit. Ramazani e ka marrë me vete gjithë familjen, këtu do t'i bëjë pushimet, të shtëpia që ka konstruktuar me vëllain. Ku ka më mirë? Sot nuk mungon asgjë, edhe ushqimet, edhe ajri janë ndryshe. Ulemi te lokali i Sutkit bashkë me gazetarin e operatorin e TVSH, Xhemal Reçi.

Udhëtuam bashkë, ishte "mysafir" në makinën time bashkë me Metush Skejen nga Cereni e që ka konsideratë të veçantë për Radomirën ku dhe ka dhënë mësim shumë vite. Xhemali të habit me eks-

perlicencën e tij të gjatë, ku s'ka qenë brenda e jashtë Atdheut, njeri i thjeshtë, i sakrificës, gjë që e tregoi dhe të nesërmen kur makina për Sorokol u prish e ai nuk u tërhoq, erdhi te Fusha e Korabit. Hëngrëm një drekë modeste me ushqime të krahinës që Sut-kiu i solli nga shpia, sa u kënaq Xhemali! Por edhe gjatë drekës syrit të tij nuk i shpëtonte asgjë. Befas ngrihet nga tavolina, se pa një çift të ardhur nga larg. E pamë që hyri në bisedë, mori disa kuadro. Na tregoi se vinin nga Krakovi, nga vendlindja e papa Vojtilës, këtij miku të shqiptarëve. E të tillë vizitorë Radomira e Kalaja e Dodës po pret çdo ditë, bile dhe në dimër. Tani nuk përdorin vetëm mikpritjen e zakonshme të këtyre banorëve apo çadrat, por dhe hotelet. Haxhi Hima me këtë rast inauguroi 5 dhoma me 10 shtretër ku nuk mungon asgjë.

-Kalova një natë të mrekullueshme, -u shpreh Xhemali që ishte mysafir te ky hotel. Edhe Sutkiu i ka në pëfundim, dalëngadalë po plotësohet harta turistike, një telefonatë dhe pritjen e keni me të gjitha të mirat. Baxhot e Sul Ahmetit dhe Hysen Tabullit janë në pikun e prodhimit, djathi i freskët i deles Rudë jepet pa kursim për vizitorët, është tradita e staniit, tradita e zonës. Dikush nuk harron të marrë nga ky djath me nam. Në një tavolinë ku është Islam Ahmeti janë disa të huaj. Kështu na u dukën, por ishin bij të kësaj zone, mes tyre Shehat Shehu nga Cereni e nipi i tij Dashmir Osmani me disa shokë. Punojnë në punë të ndryshme shtetërore në Shkup e Gostivar. Kanë marrë vesh përmes internetit dhe kanë ardhur. Me Islamin njihen më mirë, që nga viti 2001 kur Korabi ishte plot me djem të UÇK-së. Janë shumë të kënaqur me pritjen, me vendin.

-Kemi detyrime ndaj Radomirës, - shprehen ata. - Na ka pritur e ndihmuar në momentet më të vështira, na ka mjekuar plagët. E kujtimet vijnë varg, ndonjerin e tradhton një pikë loti kur flitet për trimin-strateg Tahir Sinani që u bë si bir i kësaj zone dhe e dha jetën në krahët e këtyre njerëzve të dashur e trima.

Biseda të pafundme e gjallëri nëpër lokale e përjashtë nën dritën e hënës deri vonë kur secili do të jetë mysafir diku e ku muhabeti shtrohet prapë. Me Enver Gjonikun thuajse e gdhimë pa gjumë të Shaban Ahmeti, një dashamirës aktiv i këtyra aktiviteteve. Enveri ka ardhur nga Anglia, e do shumë vendlindjen edhe pse iku shumë i vogël. Edhe vëllezërit e tij Shefiti, që me kamerën e tij e ka përjetësuar këtë vend, edhe Rexhepi që për të tretin vit sjell nga Tirana gjeneratorin në Korab, nuk ngopen me vendlindjen. Dëgjova se Enveri me shokun e tij nga Tejsi do të bëjnë një investim të sheshi i quajtur Krai e ku muhabeti e unitetit shpërfaqen jo vetëm verës deri vonë e me dritën e hënës, por dhe dimrit. Aty ka qenë dhe një xhami ku falëshin vaktet e ditës. Legjenda sjell nga lashtësia etimologjinë e këtij sheshi ku dhe Rroshi, ky burrë me famë kishte atë gurin e veçantë të gdhendur, prej mermeri e ku i hipte atit. Vjen nga fjala kryq. Banorët e hershëm kishin zbuluar bukur me kryq nga një gur ku njerëzit uteshin. Mysafirët uteshin diku, te guri i gdhendur më bukur dhe atë në ditë do të ishin miq të i zoti që e kishte gdhendur. Ç'mënyrë unikale e të treguarit të mikpritjes, s'besoj ta ketë përdorur ndonjë popull tjetër. Por ne njerëzit e shek.XI nuk kemi nevojë për këto simbole, se nuk kemi miq, por vendas. Shpërndahemi për t'u mbledhur në orën e të mëngjesit.

#### MOJ FUSHA E KORABIT. . . .

Në shekuj na është përcjellë një këngë bashkë me afshet e nënës që përcjell djalin për në kurbetin e gjatë a shtegtimin e largët, bashkë me dhëmbjet e babës që ndahet nga biri që ndofta nuk do ta shohë më, bashkë me lotët e nuses që përcjell burrin që e lë vetëm me fëmijën në gj. Duket se në të është mbledhur tërë dhimbja e botës, se nuk ka plagë më të rëndë se plaga e një ndarjeje që mund të jetë pa kthim, se pritja e gjatë e shpesh e pashpresë. Është një enciklopedi e dhimbjes. U krijua në Kalanë e Dodës, në Radomirë, por ka përhapje kombëtare e më gjërë, se problemet që ngërthen nuk i përkasin vetëm një zone.

Balada pikante e Rexhës e krijuar në Radomirë nisët nga ajo ngjarje tragjike që e dimë të gjithë, kurse "Moj Fushë e Korabit" është një krijim që mbart brenda disa të tilla, se p.sh. vetëm toponimi "Guri i mollave" ku të dashurat e nuset u hidhnin djemve kujtimin e fundit, mund të quhet baladë në vetë. Të na falë lexuesi që medituam ca si tepër, por e bëmë ngaqë do ta përshkojmë sot këtë rrugë e nga lartësitë e shekujve do të kujtojmë atë rrugë dhimbjeje, por me emocione të tjera, me ato të gëzimit. Që në orën 6 njerëzit kanë dalë, po pinë



kafen nëpër klube bashkë me mikpritësit që kurrsesi nuk të lënë të fusësh dorë në xhep. Ndjehe miq pak keq, se na duket se na quajnë si mysafirë, po s'kemi ç'bëjmë, nuk na dëgjojnë. Nisja bëhet nga rrugë të ndryshme, disa nga Sterdoku preferojnë udhën nga Preshi duke kaluar ato burimet e shumta, liqejt si kristal e duke peshkuar Shkallën e Preshit. Të tjerë rrugën e zakonshme që te gryka e Shpellave ta nxjerr djersën edhe dimrit e jo më verës. E këtë rrugë kanë zgjedhur miqtë nga Gostivari, nuk pranojnë kurrsesi as të venë çantat në kuaj e jo më të hipin. -E kemi bërë këtë rrugë edhe natën, edhe ditën, duam ta bëjmë si para 10-12 vitësh atëherë kur ngjiteshim e ndofta nuk ktheheshim, -përgjigjet njëri me tipare të imta e muskuloz.

-Kishte natë që shkante deri në fshatrat matanë kufirit, kryente misionin e përsëri kthehej sikur s'kishte ndodhur gjë, - thotë për të Islami që i njeh shumë mirë qysh atëherë. Disa të tjerë preferojnë nga Çishkrava në Gjstavaicë (sigurisht emër paramusliman) dhe pinë ujë te ajo çezma që t'i mpin duart sa t'i fusësh në të. Nuk dihet sa shekuj kanë kaluar qëkur është gdhendur ajo rrasë e gurtë që përcell ujën e akullit dimër-verë. Edhe nga ana e Sorokolit janë ngjitur disa fuoristrada, ata e kanë të lehtë pastaj zbritjen te Fusha e Korabit. Zaimi ka ardhur më shpejt me makinën e Shkëlqimit dhe menjëherë aktivizohet në problemet që lidhen me organizimit të Festës, se gjithë ajo rrugë nuk u bë vetëm për një piknik të thjeshtë. Njerëzit e të gjitha moshave pushojnë, bisedojnë dhe ndonjeri ha mëngjes. Sipas grupeve a familjeve fillojnë dhe përgatitjet e drekës.

Tufat e qingjave nuk janë larg, zgarat janë marrë me vete dhe shumë shpejt fillon pjekja e atij mishi të shijshëm që nuk i gjendet shoku. Të gjithë të ftojnë ta provosh, u mbetet hatri po e refuzove. Miqtë e ftuar e të pafuar zenë vend sipas njohjeve. Ka ardhur dhe z.Fatos Rexha, kryetar i komunës Paskuqan i cili përmend vlerat e Radomirës e të Kalasë së Dodës, se ai i ka njohur pa asnjë paragjykim në punën e tij.

-E kisha borxh, -thotë ai. Takimi i rastiit shkoi pak vonë, makina ku ishin mjetet e fonisë u prish dhe ato arritën me kuaj nga Sorokoli. Xhemali nuk u lodh, është i mësuar me këto avari, nuk lë moment pa fiksuar dhe mahnetet me këto bukuri natyrore që akoma pak njihen. Por s'është vetëm Xhemali, nga rruga e Rebive vijnë dy fotoreporterë lokalë të ORA NUJZ dhe Klan. Janë djersitur, nuk kanë hipur fere në kuaj. -U lodhëm, por nuk jemi pishman, ia vlen t'i shoh- ësh e t'i përjetësosh këto pamje e këta njerëz të gëzuar, - shprehen dhe përfshihen në turmë. I falënderojmë, se ndofta janë të vetmit bashkë me Xhemalin që "eksplorojnë" Korabin në një ditë të tillë. Disa shenjave të padurimit u vjen shpejt fundi, fonia arrin, gjëmon Fusha e Korabit nga

"O, moj Fusha e Korabit", nga "Radomirë, Radomirë" të A.Madanës, "Këngë Kurbeti" të Murat Gjonikut e nga këngët në seri të rapedit Miferim Kupa që sot erdhi me helikopter. Kënga e vallja ndërpritet nga një përhëndetje me këtë rast e ftesën për t'u përfshirë sa më shumë në Festën e Korabit që është jo vetëm mali më i lartë, por vend ku prehen eshtrat e shumë trimave e trimëshave në luftën kundër serbëve e zaptues të tjerë. Në këtë Festë që bëhet në kuadrin e 100-Vjetorit të Pavarësisë përulemi para aktit të Ibrahim Gjorgjit, Halim Leskës, motër e vlla Shaban Alia e Naxhie Murraku, Hebibi Kupa, Emin Gjorgji, Selman Domi e të tjerë. Përhëndesin vendas e miq. Kryetari i komisionit të Radomirës, garant i ruajtjes së atij intifaku që ka udhëhequr Radomirën në shekuj, Idris Ahmeti shpreh kënaqësinë e organizimit të kësaj Feste dhe shpreh nevojën e një bashkërendimi më efikas të punës me Shoqatën për zgjidhjen e problemeve.

Kasam Hima kërkon, me të drejtë, që të ngrihet zëri më shumë për njohjen e ruajtjen e këtyre vlerave që ka Radomira, të ndihmojë më shumë dhe

Ceveria me fonde për rrugën etj. Përhëndesin dhe miq të ardhur si Fatos Rexha që ndihet krenar që njeh vlerat e Radomirës, Shehat Shehu nga Gostivari që vlerëson mikpritjen e ndihmën e Radomirës në vitin.2001, Fatos Skeja që ndihet krenar si nip i Radomirës e të tjerë. Dhe koha e kthimit erdhi, Ahmetet e kanë lënë dasmën hapur, Nexhipi i ka nxitur të shkojnë në Radomië e të kthehen. Një ndarje ë fundit mes shokësh e miqsh dhe fillon ajo zbritja që nuk shumë e këndshme pas gjithë asaj veprimtarie të gjatë ditore e që u shoqërua vetëm me diell. Dikush nuk ka ditur të mbrohet nga rrezet e diellit në malin më të lartë, nuk e ka ditur se rrezet ultraviolett janë dy herë më të fuqishme kuto se në bregdet dhe rezultati u pa brenda ditës kur lëkura filloi të djegë. Mend për tjetër herë. Që tani u shpreh dëshira nga disa që viti tjetër ta përmirësojmë organizimin dhe ndryshojmë dhe vendin, se Radomira e Kalaja e Dodës nuk ka vetëm Fushën e Korabit, por dhe Preshin me ato bukuri të shfaqura e të fshehta, me ato liqene kristal e burime të akullta, ka dhe Mansat që ngjajnë me një amfiteatër gjigant e ngajnë me Punairin përrallor. Ndonjeri që nuk i ka parë këto vende munt të jetë dhe mosbesues, por ne i themi: "Merr mundimin, ec tri orë me makinë e tri me këmbë e do të na japësh të drejtë." Meqë ra fjala e Preshit, atij vendi magjik ku Dibra merr ujën e kristaltë e që e ka hallall, kur ai menaxhohet si duhet e jo kur në pikun e vapës ujit arat gjatë rrugës e fajtor bëhet Radomira, bëra një krahasim kur u kthym në Tiranë. Gazetari i nderuar Edispn Ypi Te gazeta "Rruga e Arbërit" në numrin e kaluar i kështon dy faqe Kalasë së Dodës. Ai stil transparent e energjik të mahnit, duket si një doktor që njeh çdo qelizë të trupit, ndofta është i pari që hyn aq thellë e lirishtë në zemrën e një zone aq të pastër shpirtërisht, faktet që vë në gojën e të itervistuarve krejt të rastësishëm, nuk lënë vend për hamendësime dhe e venë në "krye të vendit" Kalanë e Dodës". S'kemi pse humbasim modestinë, lexojeni e do ta vërtetoni me fakte.

Por kam përpara dhe një gazetë të nderuar kur një shkrimtar e skenarist i për mendur i letrave shqipe duket se ka derdhur tërë vrerin e pamerituar ndaj kësaj zone. Fajësohet tërë Kalaja e Dodës, në fakt ato gjëra që ndodhen vjet nuk duhet të hedhin balte mbi gjithë Kalanë e Dodës, fshatrat e së cilës të parat e kanë pësuar me marrjen e ujit. Mëlllefet politike në një kuadër shumë të gjërë marrin pikë referimi Kalanë. Zotëria duket se nuk e ka informacionin e duhur kur ato veprime që, në fakt, mund të ishin shmangur pa qenë nevojta të dërgohen tërë policët e Dibrës duke dhënë figurën më te keqe në një zonë aq paqësore, i vesh vetëm me ngjyrë politike. Shkrimi hedh dhe benzinë në zjarr, por e di populli i Dibrës se Radomira sakrifikon nga vetja për të dhe nuk bie pre e këtyre thënieve. Dhe pse ka pasur disa probleme "mesveti", i ka zgjidhur po vetë. Këtë e di populli i Dibrës, e dinë dhe drejtuesit e Dibrës që, dhe kur nuk ka ujë dhe për Radomirën, apo uji shkon kot nëpër arat në fushë, lënë të kuptohet se "E ka ndarë Radomira." Dhe me kaq shfaqësohen. Radomira sakrifikon, por të shtrembëren nuk e duron. Paranteza doli vetvetiu kur u përmend Preshi jetëdhënës e i bukur që, ndofta vitin e ardhshëm do të jetë vendi i Festës. Do të bashkëpunojmë më shumë me pushtetin vendor që këtë vit ka qenë shumë më aktiv, për hapjen e xhadesë për Presh, gjë që do të lehtësojë shumë mundimin e deritanishëm. Në kthim nuk shijojmë vetëm bukuritë e këtij vendi, por bëhemi dhe dëshmitarë të asaj punë të madhë që po tregojnë fshatarët për fushatën e barit, aq jetik për këtë zonë lektorale. Bari i korrur nesër pret më shumë punëtorë, se sot shumica janë në bjeshkë, në festë. Më pëlqen ta mbyll me titullin e reportazhit të z.Edison Ypi: "I AM FROM KALAJA E DODËS

\* Kryetar i Shoqatës "KORABI-RADOMIRË"

## NË TAKIMIN E SHOQATËS PËR "FESTËN E KORABIT"

Të nderuar miq që keni ardhur të gëzoni me ne sot e të sakrifikoni në rrugën e gjatë e të lodhshme për t'u bashkuar te ky vend i mrekullueshëm që deri para 7 dekadash qe Fusha e lotëve e sot është Fusha e gëzimit dhe e bashkimit. Ia vlen të veçojmë më të largët: Populli thotë: "E treta, e vërteta". Është i treti vit që Radomira bashkohet masivisht te ky vend i mrekullueshëm ku lindën të parët tanë e ku na lanë amanet ta ruajmë me gjak ashtu si e ruajtën ata. Dhe ne çdo vit po mblidhemi e po transmetojmë te brezi që po rritet në Radomirë, në Shqipëri e në botë, kudo ku ka shqiptarë po këtë mesazh historik. Dhe historia flet më qartë në këtë vend, më qartë se çdo libër e shkrim, se flasi murrat e shpërndara në gjithë Korabin e që janë bërë toponime të mirëfillta. Janë murrat e Halim Leskës nga Ploshani apo i Shaban Alisë e i motrës se vet Naxhie Murraku që ranë këtu kundër serbëve duke treguar se kur hasmi vjen në prag, çdo fshat e zonë e vendit është Atdheu ynë. Këtë mesazh dha Bajraku i Radomirës që mori nam në Qafën e Kolesjanit në Luftën më të madhë në prag të Pavarësisë bashkë me trimat lumjanë e dibranë. Këtu Radomira dha dhe dëshmorin e parë, vetë Bajraktarin duke e bërë edhe më të nderuar Radomirën tonë. Emrin e Brahimit, me këmbënguljen e pushtetit vendor, e vumë të shkolla, por është e pamjaftueshme dhe e vonuar. Përmasat e aktit të Ibrahim Gjorgjit nuk janë krahinore, por kombëtare. Dhe Shoqata ka në planin e vet të së ardhmes për nderimin e figurave të shquara.

Shoqata dhe shoqëria ka borxh edhe ndaj figurave të tjera të shquara që kanë mbetur pak në hije edhe pse kanë derdhur gjakun e vet për këto bjeshkë që janë me bukuri e resurse të papara.

Emri i dëshmorit Emin Gjorgji nuk gjendet në ndonjë rrugë a objekt. Emri i Hebibi Kupës që ra në këtë bjeshkë në lule të moshës dhe ia një tufë me jetima vetëm përmendet me respekt nga ata që luftuan me të e nga ne që kemi dëgjuar për aktin e tij heroik në mbrojtje të bjeshkës. A mjafton kjo? Nuk mjafton, emri i tij duhet të ishte në ndonjë rrugë, shesh apo objekt. Nga bashkëlufetarët na është transmetuar akti i Galip Hoxhës në luftën për bjeshkën, i cili e zu pozicionin i pari mes breshërisë së plumbave. Duhet nderuar siç e meriton, dhe pse e falen plumbat. Shoqata e ka detyrë që t'i nxjerrë nga hijja dhe mjaft figura të shquara të Radomirës që bënë emër me veprën e tyre brenda e jashtë vendit si Rroshi që nderoi Radomirën në çdo moment derisa u shpërngul, Shavellin që ka qenë bajraktar me herët, Xhelil Ahmetin që ishte bajraktar derisa u vu trimi i ri Ibrahim Gjorgji. Objekt i punës do të jenë dhe figura me përmasa jo të vogla si Sehu-ul-Islami i Prandorisë Turke për disa vjet Hysen Dika i Gjonikut nga Sterdoku që çdo verë vinte në vendlindje. Duhet të vlerësohet bamirësi i madh Haxhi Hasani që pajisi fshatra me ujë duke i blerë tubat në Shkup apo duke bërë dhe xhamia e objekte të tjera. Pak është vlerësuar Molla Vehbi Ferati me diplomë të artë në Stamboll që preferoi të punonte në vendlindje duke refuzuar poste të larta që ia ofruan për meritat e tij. Është hoxhë që i mësonet fëmijët, së pari, në shqip e që regjimi nuk arriti ta burgosë se, pikërisht atë ditë, u varros. Ka dhe të tjerë që që do të vlerësohen. Janë shumë vlera të Radomirës që duhet të jenë objekt studimi, është organizimi i jetës së vet me anën e Itifakut, këtij ligji të brendshëm të cilin të gjithë ishin të barabartë, se ai veprimi me sukses edhe kur vendi ishte pa qeveri dhe nuk kursente asnjërin kur e shkelte, aqsa vendimet arrinin deri në dënim kapital. Bile themi me krenari se ai vepron në disa drejtime dhe sot pa rënë ndesh me ligjet e, shpesh, në akord me to, siç janë rregullat për pyjet, kallotat etj. që ruhen me përgjegjësi nga komisioni i pesë fshatrave. Shoqata ka dhe shumë detyrime në drejtim të ruajtjes së trashëgimisë etnokulturore krejt origjinale duke filluar me atë traditë të shkëlqyer në mënyrën e jetesës që çuditë Hahnin para 150 vitesh e Jastrbovin më vonë.

Kemi dhe shumë detyrime për të vlerësuar trashëgiminë folklorike të transmetuar në breza e që sot po interpretohet me sukses brenda e jashtë vendit nga bijtë e Radomirës. Janë mundësitë për të bërë të përhapet më shumë kjo krijimtari, se dhe mundësitë financiare të bijve të kësaj zone janë të mundshme. Bijtë e Radomirës që po punojnë me një përkushtim të pasqor brenda e jashtë vendit kanë bërë të mundur të ngremë më lart cilësinë e aktiviteteve në Shoqatë, janë treguar të gatshëm sa u është thënë, atë janë të evidentuar, por modestia e trashëgurar nga brezat, na e bën të pamundur t'u themi emrat. Punët flasin vetë. Këto që u thanë e të tjera do të jenë dhe objektiva në punën tonë, ku vendin e parë për këtë vit e zënë aktivite- tet për 100-Vjetorin e Pavarësisë, një a dy promovime etj si dhe një bashkërendim edhe më i mirë me pushtetin vendor e organet e tjera. Faleminderit!

J.Delia(Selmani)

Asfaltimi i rrugës që gjallëron Fushën e Dibrës së Madhe dhe fshatin Bohmovë

investime

# Nxitje për zhvillim dhe vetë punësim

Nga REXHEP TORTE

Është kënaqësi të shohësh si gumëzhijnë gjatë ditës Fusha e Dibrës dhe fshati Bohmovë nga bujqit që janë duke punuar tokat e tyre bujqësore. Këtë e mundësoi asfaltimi i rrugës në fillimverën e këtij viti, nëpër të cilën është mundësuar arritja e kthimi i shpejtë e komod me automjete dhe mekanizimin bujqësor.

Argëtim Fida, kryetar i Komunës në Dibrë të Madhe, lidhur me asfaltimin e kësaj rruge, thekson se, " Në vazhden e krijimit të hapësirës për punësime të reja dhe në kuadër të politikës së Bashkimit Evropian dhe të politikës së Republikës së Maqedonisë për stimulimin e zhvillimit të bujqësisë, me që Maqedonia kryesisht është vend bujqësor me tendencë për zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e ekonomisë prodhuese jondotëse, duke mos pasur për momentin të ofrojmë investitorë me kapacitete të mëdha prodhuese ku do të hapeshin më shumë vende pune, si edhe duke patur parasysh faktin se dibranët kanë traditë në bujqësi, ne aplikuam te Banka Evropiane për Rikonstruim dhe për Zhvillim të Bujqësisë me projektin për asfaltimin e kësaj rruge. Pjesa më e madhe e tokës së punueshme bujqësore është rrafshi i Dibrës së Madhe, përkatësisht rreth rrugës së ashtuquajtur Fusha Aeroplanëve, që përfundon në drejtim të fshatit Shushicë dhe në drejtim të fshatit Bohmovë. Aktualisht për komunën tonë në bazë të numrit të banorëve si edhe për komunat tjera ishin ndarë rreth 50 milionë euro për tërë Maqedoninë. Mbi këtë bazë për këtë projekt komunës sonë i takuan 220 mijë euro. Projekti me të cilin ne aplikuam ishte rruga për në Fushën e Dibrës së Madhe e cila përfundon në fshatin Bohmovë, U asfaltuan 2 kilometra rrugë, ndërsa 200 metra tjera janë përgatitur me tamponim për tu asfaltuar. Me vendim të Këshillit të Komunës dhe të Këshillit të kryetarëve të bashkësive lokale, kësaj rruge iu dha përparësi. Kjo rrugë kalon përmes fushës më pjellore dhe me ujë, ku pas rikonstruimit të sistemit të ujitjes kjo fushë do të ketë mundësinë për ujitjen e ngastrave, Ne mendojmë që me 70 mijë euro nga Banka Botërore që kanë mbetur pa u shfrytëzuar pas përfundimit të asfaltimit të rrugës për në fshatin Kojnarë, në tenderin e dytë do ta asfaltojmë edhe pjesën e rrugës prej disa qindra metrash që ka mbetur për në fshatin Bohmovë. Kjo do tu mundësojë bujqve dibranë që gjer në 700 hektarët e tokave të tyre bujqësore me automjete të mund të arrijnë brenda 5 minutave, e jo si më parë që duhej afër dy orë për të arritur te ngastrat e tyre. Kjo rrugë do të ndikojë edhe në zvogëlimin e sasisë së karburanteve dhe të amortizimit të mekanizimit bujqësor. E tërë kjo do të mundësojë rentabilitet më të madh të bujqve dibranë për ta punuar tokën e tyre në këtë zonë si bujq individualë ose si punë plotësuese për nëpunësit pas orarit të punës zyrtare, Sipas planifikimeve tona në vitet që vijjnë duke punuar tokat e tyre bujqësore do të vetëpunësohen rreth 300 familje.

Rezultatet nga asfaltimi i rrugëve për në fshatra janë evidente. Kjo u dëshmuar edhe me rastin e asfaltimit të rrugës për në fshatin



Rruga e Bohmovës. Foto. R. Torte

Kojnarë, ku 80 përqind e ngastrave ishin lëmë pas dore, ndërsa gjatë këtij viti pa punuar kanë mbetur vetëm 20 përqind e ngastrave që janë pronë e dibranëve të cilët ndodhen jashtë Dibrës së Madhe.

Me këto rrugë cilësore mendojmë t'i stimulojmë bujqit dibranë që një pjesë e tyre t'i kthehen bujqësisë dhe ta sigurojnë ekzistencën e tyre nga pasuritë që ua kanë lënë në trashëgim prindërit e tyre. Edhe në të kaluarën por edhe sot, jo vetëm në vendet e Evropës Juglindore ku bëjmë pjesë edhe ne, por edhe në tërë Evropën, rreth 40 përqind e popullatës jetojnë nga bujqësia, si rrjedhojë e kësaj edhe Dibra e Madhe nuk mund të jetë jashtë këtyre standardeve. Kështu që një pjesë e popullatës dibrane do të ketë mundësinë të vetëpunësohet, pasi jemi të angazhuar që këto kushte t'i krijojmë, dhe impakti ekonomik nga shitja e prodhimeve do të jetë i rëndësishëm edhe për tërë qytetin. Aktualisht prodhimet bujqësore në Dibrë të Madhe vijjnë nga shumë vendbanime të Maqedonisë, Për prodhimet dibrane blerës mund të jenë edhe 150 mijë banorë matanë kufirit me Shqipërinë". tha në fund Argëtim Fida.

Mersim Marku, kryetar i Gjyqit Komunal dhe kryetar i Këshillit nismëtar të Fisit Marku për asfaltimin e kësaj rruge që çon edhe për në fshatin Bohmovë, shprehet se, "Bohmova që ndodhet përbri kufirit me Shqipërinë buzë

lumit Drini i Zi është fshat i bukur por i braktisur. Para se të asfaltohej këtë rrugë për në fshatin Bohmovë e mirëmbanin vetë banorët nga ky fshat me aksione vullnetare duke e shtruar me zhavor, sepse gjatë stinës së dimrit shirat e dëborat e demtonin duke shkaktuar rrëshqitje të shumta të dheu. Mbi fshat janë varrezat ku mes tyre dominojnë Varri i Mirë dhe Varri i Salë Markes, i figurës së shquar të këtij fshati dhe të zonës së Dibrës, Në këtë fshat shtrihen 560 hektarë tokë e punueshme, zabele, dhe livadhe. Mes shtëpive të rrënuara Kulla e Salë Markes ende po i sfidon kohën. Në kohën e lulëzimit ky fshat kishte me dhjetëra shtëpi, shkollën dhe xhaminë e fshatit. Këtu jetonte vetëm Fisi Marku me shumë anëtarë të familjeve.

Ajo që të mahnit duke shëtitur nëpër këtë fshat është infrastruktura e tij e dikurshme, që pasqyrohet nëpërmjet kanalit për ujitjen e ngastrave, çezmet dhe pusët në oborret e shtëpive, rrugët me kalldrëme dhe oborret e shtëpive të shtruara me kalldrëme. Siç tregojnë ish banorët e këtij fshati, rrugët dhe oborret e shtruara me kalldrëme shëndritshin nga pastërtia.

Migrimi në relacionin fshat qytet bëri që edhe ky fshat të zbrazët i tëri. Për këtë ekzistojnë një mori faktorësh. Shpërngulja nga ky fshat në qytet filloi menjëherë pas përfundimit të Luftës së II Botërore dhe pas viteve pesëdhjetë të shekullit të kaluar.

Ndër arsyt kryesore të shpërnguljes ka qenë dhuna e diktaturës komuniste e atyre viteve, si edhe gjendja e vështirë e rrugës fshat qytet, mungesa e ujës jellësit dhe e ambulancës.

Pas disa përpjekjeve të pasuksesshme për asfaltimin e kësaj rruge, në vitin 2007 themelua edhe Këshillin familjar të Fisit Marku, ku bëmë edhe projektiden për asfaltimin e kësaj rruge. Këshilli familjar bëri disa tentativa për grumbullimin e mjeteve nga diaspora, por pa sukses.

Më në fund Këshilli familjar i Fisit Marku për realizimin e asfaltimit të kësaj rruge iu drejtua pushtetit vendor, përkatësisht kryetarit të Komunës Argëtim Fida, i cili u angazhua me seriozitetin më të madh në hartimin e projektit dhe sigurimin e mjeteve financiare nga Banka Evropiane, për çka Fisi Marku e falenderon publikisht për këtë sukses të arritur në asfaltimin e rrugës për në fshatin Bohmovë. Asfaltimi i kësaj rruge do të ketë efekt të madh pozitiv në zhvillimin ekonomik të qytetit, sepse kjo rrugë është arterie kryesore që lidh Fushën e Dibrës së Madhe me fshatin Bohmovë dhe fshatrat Shushicë e Taranik. Jemi të bindur se pushteti vendor së shpejti do të gjejë mundësi që ta asfaltojë edhe atë pjesë që mbeti pa u kryer.

Pas asfaltimit të kësaj rruge vërehen bujqit dibranë që kanë intensifikuar punët e tyre në tokat bujqësore që degëzohen përreth kësaj rruge.

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?  
SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

Nga Rexhep TORTE

**MËRGIMTAR I SUKSESSHËM DHE NDIHMËTAR I DALLUAR**

Mërgimtarët shqiptarë kudo që ndodhen e kanë të ngulur thellë në shpirt mallin për vendlindjen ku janë lindur dhe janë rritur. Ata e vizitojnë shpesh vendlindjen me shpresë se një ditë do të kthehen.

Në këto pushime verore pata rastin të takoj Bardhyl Durmishin nga fshati Zhuzhnjë i Rekës së Epërme dhe dibranin Nexhmi Mati, që të dy mërgimtarë nga zona e Dibës së Madhe që punojnë e jetojnë në Trento të Italisë.

Bardhyl Durmishi njihet si biznesmen i suksesshëm në Trento të Italisë me ndërmarrjen e tij "Korabi" dhe të disa ndërmarrjeve tjera në disa komuna në Itali, që merren me thyerjen dhe modelimin e gurit kubeta dhe të pllakave guri tepër cilësore, të qëndrueshme dhe të kërkuara, që përdoren për shtruarjen e rrugëve dhe shesheve jo vetëm në Itali, por edhe në Shtepinë e Bardhë në Vashington të SHBA. Në pikat prodhuese të këtij biznesmeni janë punësuar afër 100 punëtorë kushërinj, bashkatdhetarë dhe bashkëkombas të tij. Biznesmeni Bardhyl Durmishi, i cili ka mërguar në Itali para vitit 1990, dallohet edhe për angazhimin dhe solitaritetin e tij duke siguruar 100 leje qëndrimi dhe vazhdimin e 40 lejeve qëndrimi për bashkëkombasit që tashmë po punojnë në Itali, por që u ka skaduar afati i lejeve. Bardhyli këtë angazhim të tij e bën me një zell e përkushtim të madh, duke siguruar dokumentacionin e nevojshëm nëpërmjet ndërmarrjeve të tij. Kjo ka rëndësi të madhe për mërgimtarët tanë të cilët në këtë mënyrë sigurojnë punën dhe të ardhurat për vete dhe familjet e tyre. Bardhyli nëpërmjet Lëvizjes "Vendlindja Thërret" gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë ka ndihmuar financiarisht këtë luftë, ndërsa nëpërmjet Shoqatës "Miq të Universitetit të Tetovës" gjithashtu ka ndihmuar financiarisht hapjen e këtij universiteti. Ai ka ndihmuar e sponsorizuar akyvitetet e shumta kulturore e sportive në Provincën Autonome të Trentos.

Nexhmi Mati, mërgimtar dibran njihet si aktivist në ruajtjen dhe promovimin e folklorit shqiptar në Itali, ndërsa është punësuar si operator në sindikatat italiane.

**FSHATI ZHUZHJË MARGARITAR I BRAKTISUR**

Për tu çmallur me Zhuzhnjën, fshatin ku është lindur Bardhyl Durmishi, më 27 gusht të këtij ne bëmë një vizitë disa orëshe në këtë fshat malor por tejet të bukur.

Në kilometrin 32 të rrugës Dibër-Shkup në të majtë fillon degëzimi i rrugës për në zonën e Rekës së Epërme. Në të majtë të zonës së Rekës së Epërme ngjitur shpateve të kodrave janë fshatrat Ribnicë, Grekaj, Nivishta dhe Tanusha.

Këtë radhë ne u nisëm në të djathtë të Rekës së Epërme ku janë fshatrat Nistrovë, Bibaj dhe fshati Zhuzhnjë që shtrihet rënzë malit

# Ta gjallërojmë Rekën e Epërme te Dibra Madhe



Shtëpia e Familjes Durmishi në Zhuzhnjë. Foto. R. Torte

Korab., i cili ndan Maqedoninë nga Shqipëria.

Rruga nëpër të cilën udhëtonim ishte gjithnjë në ngjitje përpjetë dhe përplot me kthesa, rrugë e shtruar vetëm me tampon dhe e ngushtë, sa që kur vjen ndonjë automjet nga ana e kundërt duhet gjetur ndonjë vend për t'ia liruar rrugën. Megjithatë pamjet gjatë udhëtimit në këtë rrugë janë mahnitëse dhe lënë mbresa të paharruara.

Pas 11 kilometra udhëtimi arritëm në fshatin Nistrovë që është i banuar, ku jetojnë 15 familje dhe ku ekziston shkolla me 18 nxënës, të cilët ndjekin mësimet nga klasa e parë gjer në klasën e tetë dhe ku janë të punësuar 5 arsimtarë. Në këtë fshat ndodhet xhamija e fshatit dhe shtëpia e iluministit Josif Bageri. Këtu hasëm edhe në një çezme publike ku ishin vendosur gota për të shuar etjen kalimtarët.

Nga Nistrova nis rruga gjarpëruese me përpjeta e tatëpjeta në gjatësi prej 5 kilometrash, të cilën e kishin hapur me vetëkontributin e tyre fshatarët e fshatit Zhuzhnjë që tashmë janë shpërngulur tërësisht. Hapja e kësaj rruge është bërë për të mundësuar arritjen me automjete dhe për të krijuar kushte për gjallërimin e këtij fshati në të ardhmen. Përkundër terrenit të thyer vërehen shumë gërmadha të shtëpive, por edhe vijëzimet e bahçeve dhe tokave që punoheshin gjersa këtu jetonin banorët e këtij fshati. Shihen drunjte e arrave, mollëve, dardhave, kumbullave dhe qershive, që përkundër braktisjes së fshatit po i qëndrojnë kohës. Fshati Zhuzhnjë ndodhet në lartësi mbidetare prej 1200 metrash dhe përfundon rënzë malit Korabi.

Nga porta e malit Korabi, siç e quajnë këtu rrjedh ujëvara që krijon edhe Përroin e thellë, i cili me ujën e tij ka theluar shtratin duke kaluar përmes fshatit, që pasi bashkohet me Përroin e Keq dhe Përroin e Nirtës derdhen në lumin Radikë.

Në fund të fshatit Zhuzhnjë shihen themelet e karakollit ushtarak kufitar nga ish Jugosllavia, por edhe istikamet e UÇK nga lufta e vitit 2001, sepse nga ky vend strategjik mbahej nën kontroll kjo grykë, me çka bëhej i mundur edhe transporti i armëve për UÇK-në nga Shqipëria nëpërmjet malit Korab.

Në fshatin Zhuzhnjë takuam disa ish banorë të këtij fshati të cilët kishin ardhur që gjatë verës të kullosin delet dhe lopët e tyre, por kishte edhe ish banorë që kishin ardhur për piknik ditë.

Në mesin e shtëpive që i kanë rezistuar kohës është edhe shtëpia e familjes Durmishi, nga më të mëdhatë në fshat, e ndërtuar në ashpërmasash që gjatë martesave nëpër derën e shtëpisë në rast dasme të hynte edhe nusja hipur mbi kalë. Dhomat e kësaj shtëpie janë të sistemuara mirë dhe funksionale sipas përdorimit. Tavanet janë me zburime drugdhendje, ndërsa muret me dollapë e sergenë. Kjo shtëpi dëshmon edhe pozitën ekonomike dhe shoqërore të kësaj familje në atë kohë.

**PRESIONET POLITIKE DHE EKONOMIKE SHKAKTUAN MËRGIMIN**

Siç na tregonte Bardhyl Durmishi, shoqëruesi ynë gjatë kësaj vizite, fshati Zhuzhnjë në lulëzimin e vet ka patur 40 shtëpi, shkollën dhe

xhaminë e fshatit. Në këtë fshat ka patur edhe një lagje ku kanë jetuar shqiptarët orthodoksë që dëshmon edhe kisha orthodokse. Varezat e vjetra me simbolet e tyre rreth kësaj kishe tregojnë se ky fshat e ka historikun e hershëm që në kohën ilire. Kisha më herët ka qenë katolike, ndërsa më vonë është shndërruar në orthodoksë.

Në fshatin Zhuzhnjë ka qenë e zhvilluar bujqësia, blegtoaria, pemëtaria dhe shfrytëzimi i lëndës drusore për djegie, ndërtimtari dhe mobilieri. Bjeshkët e Korabit kanë mundësuar të mbahen 25 mijë kokë dele dhe bagëti të trasha. Bylmeti dhe prodhimet e tjera bujqësore e blegtorale janë shitur në tregun e Dibres së Madhe dhe në qytete tjera përreth. Vetëm gjyshi Neshat Durmishi, asokohe ka patur 4 mijë kokë dele dhe është quajtur qahajë,

Banorët e këtij fshati i kanë punuar me përkushtim tokat e tyre bujqësore edhe përkundër terrenit të vështirë. Në këtë fshat kanë jetuar familjet Durmishi, Osmani, Zyferi dhe Rahmani. Familja më e madhe ka qenë familja Durmishi, e cila gjithnjë ka patur frymën e humanizmit e të solidaritetit, ka qenë e hapur dhe e gatshme tu ndihmojë familjeve në fshat dhe në fshatrat përreth në dimrat e ashpër dhe në raste martesë e mortore,

Për shkak të rrugëve të ngushta komunikimi ndërmjet fshatrave të Rekës së Epërme është zhvilluar me kuaj. Kjo flet qartë për guximin dhe qëndrueshmërinë e banorëve të kësaj ane.

Presionet e njëpasnjëshme ekonomike, infrastrukturale dhe politike bënë që ky fshat të fillojë të zbrazet. Siç tregon Bardhyl Du-


rishi, në mungesë të rrugës ishin të detyruar që të udhëtojmë disa orë në këmbë për të arritur poshtë te rruga që çonte nga Dibra e Madhe në drejtim të Shkupit. Mungesa e ambulancës e vështirësonte edhe më shumë jetën e banorëve në rast të ndonjë sëmundje. Presioni që u bëhej banorëve të këtij fshati për tu larguar ishte edhe për shkak të pozitës së tij në kufi me Shqipërinë. Shpërnguljet e para u bënë në vitin 1975 kur u shpërngul gjyshi im Neshat Durmishi dhe përfunduan në vitin 1987. Banorët e fshatit Zhuzhnjë fillimisht u vendosën në qytetin e Gostivarit për arsye të ndarjes së atëhershme territoriale dhe se këtu patën mundësi më të mira për vendosje dhe për të mërguar nëpër shtetet e tjera evropiane. Hajrulla Durmishi, babai im mërgoi në Gjermani, ndërsa disa tjerë në Hollandë. Unë mërgova në Itali, ku ishin vendosur edhe disa kushërinj të mi. Fillimisht u vendosa në Termoli të Pulia ku qëndrova gjer në vitin 1990. Pas kësaj kalova në Provincën Autonome të Trentos duke u punësuar në minierën sipërfaqësore për punimin e gurit. Pas kësaj kalova në Cembra në Ndërmarrjen e z. Casanda Ermano, që bënte prerjen e gurëve kubeta me makineri. Duke parë angazhimin dhe kujdesin tim në punë pronari i kësaj ndërmarrje më propozoi që të bëhem bashkëpronar, gjë që e pranova. Nuk kaloi shumë kohë kur bashkëpronari u tërhoq për arsye personale dhe kështu unë u bera pronar i vetëm i ndërmarrjes. Pas kësaj pranova ofertën nga Santori Valentino, zona e Kompartës, i cili më ofroi vend në ndërmarrjen e tij për t'i vendosur makineritë e mia për punimin e gurëve kubeta. Unë themelova ndërmarrjen tjetër "Lavorazione Perfidi Di Durmishi Bardul" duke e rritur dukshëm numrin e të punësuarve. Zyrat e ndërmarrjes sime ndodhen në Komunën Leona- Lases.

**OPTIMIZËM PËR RINGJALLJEN E FSHATIT DHE TË ZONËS**

Edhe pse jetojmë e punojmë larg vendlindjes ne mërgimtarët në mendje dhe zemër e kemi gjithnjë vendlindjen. Shpresojmë se do ta asfaltojmë rrugën për në fshatin Zhuzhnjë, duke krijuar kushte për ndërtimin e shtëpive dhe për kthimin gradual të mërgimtarëve, qoftë si pensionistë ose edhe më parë. Aktualisht fëmijët tanë janë duke ndjekur studimet në fakultetet e këtushme në degë të ndryshme. Kjo siguron një bazë të mirë intelektuale shqiptare që gjithsesi do ta japë kontributin e vet. Ndërkaq, u shpreh Bardhyl Durmishi, se kontributin e vet në përmirësimin e infrastrukturës rrugore duhet ta japë edhe shteti i Maqedonisë për ta përmirësuar sadopak gabimin që e ka bërë ndaj nesh. Sido që të jetë synimi ynë është që ta ringjallim Zhuzhnjën dhe tërë fshatrat e Rekës së Epërme, sepse me këtë do ta ruajmë historinë dhe identitetin tonë kombëtar, shpreh plot optimizëm Bardhyl Durmishi, mërgimtari në Itali nga fshati Zhuzhnjë i Rekës së Epërme.

Pas protestës së shoqatës së ish të burgosurve politikë shqiptarë në Maqedoni para qeverisë në Shkup

opinion



Nga SHPËTIM POLLOZHANI

Gjatë kohë e paralajmëruar dhe mirë e përgatitur Protesta e organizuar nga Shoqata e të Burgosurve dhe të Dëmtuarve Politikë Shqiptarë në Maqedoni, e përkrahur nga Shoqata e Historianëve Shqiptarë, Shoqata e Arsimitarëve Shqiptarë, Qendra për mirëkuptim, Ilirikum Libertas, Organizata e Veteranëve të Luftës (OVL-UÇK), Qëndresa-përfaqësues i mbi dhjetë shoqatave nga Kërçova dhe disa organizata të tjera, në 7 qershor 2012, ia ariti qëllimit. Protesta ishte e qetë, dinjitoze, civilizuese dhe përcolli mesazhin, për të cilin edhe u organizua. Vetë struktura e protestuesve fliste për nivelin dhe kapacitetin e protestuesve të popullit shqiptar në këtë vend. Në protestë, kësaj radhe merrnin pjesë burra-jo vetëm meshkuj, gra dhe fëmijë.

Protesta e 7 qershorit e vulosi ciklin e disa protestave të shqiptarëve në këtë pranverë. Protesta e Shoqatës e dha portretin tonë të vërtetë. Kjo ishte një protestë e vlerave Europiane, e dinjitetit dhe e unitetit. Protesta e 7 qershorit e vërtetoi një të vërtetë të pamohueshme, se sasia nuk përcakton cilësinë. Ky ishte edhe qëllimi i Shoqatës së të Burgosurve dhe të Dëmtuarve Politikë Shqiptarë në Maqedoni. Shoqata kishte qëllim që ta sensibilizojë problemin e çdëmtimit dhe të kompensimit material të të burgosurve politikë shqiptarë nga ish sistemi komunist i ish Jugosllavisë. Problemi është shndërruar në problem të vërtetë, dhe vetë lëvizjet që po bëhen tregojnë se Shoqata e ka arritur qëllimin. Në ditën e protestës përpara Qeverisë së Maqedonisë, nuk e di se si janë ndjerë banorët shqiptarë brenda mureve të saj. Nga protestuesit, Qeverisë iu dorëzua Propozim Ligji i Shoqatës për çdëmtim dhe kompensim material, për zullumin që na është bërë nga paraardhësit komunist, të cilët e kishin selinë aty ku sot ndodhen edhe qeveritarët e sotëm. Nuk ka asnjë mjet pagesor që mundet ta kompenzojë rininë e tretur, familje të plagosura, kariera të humbura, mijëra rugëtime kurbeti, dhe qindra të burgosur, të cilëve drita e diellit iu shuajt nëpër kazamatet Jugosllave. Shoqata, në protestë i ftoi të gjithë shqiptarët, në shenjë respekti për këto katagori njerëzish, mirëpo nuk na kuptuan të gjithë. Në protestë merrnin pjesë afër 500 protestues, edhe pse Shoqata në arkivin e vetë, ka regjistruar mbi 24.000 persona të dënuar dhe të persektuar. Për realizimin dhe inferioritetin e faktorit politik shqiptar për zgjidhjen e këtij problemi, Shoqata vendosi që secili ish i burgosur dhe i persektuar politik ta padisë shtetin për arsye se Shoqata nuk ka ekzistuar në kohën kur janë burgosur e persektuar këta persona. Kjo Qeveri është nga më të antishqiptarët se çdo qeveri e deritashme edhe pse e quan veten demokratike.

Në ditën e protestës Shoqata i dorëzoi Qeverisë së Maqedonisë kopje të padive, me të cilat të burgosurit dhe të persektuarit shqiptarë, padisin shtetin për kompensim dëmi që ua ka bërë paraardhësi i këtij shteti, ish Jugosllavia. Me këtë Padi, paditet edhe

# Në pritje të reflektimit pozitiv të qeverisë së Maqedonisë

vetëdija e të gjitha strukturave politike shqiptare në Maqedoni. Me pjesëmarrjen e tyre në Qeveri, ata këtij shteti i kanë dhënë legjitimitetin e një shteti, demokratik, i cili me këtë kredi po troket në dyert e botës së civilizuar.

Me aktivitetet që është duke i kryer Shoqata, dëshirojmë t'i tregojmë botës, se në këtë shtet ka një plagë të rëndë, e cila nuk mundet të shërohet, por më të paktën të mjekohet. Ne dëshirojmë tua bëjmë me dije autoriteteve ndërkombëtare, të cilët Maqedonisë i dhanë një Pyetësor, në të cilin ka mbi 3300 pyetje, të cilat Maqedonia duhet t'i plotësojë për fillim të negociatave për antarësim në BE. Në këtë Pyetësor për fat të keq, nuk ka asnjë pyetje që ka të bëjë me zgjidhjen e statusit të të burgosurve dhe të persektuarve politikë shqiptarë në Maqedoni. Për këtë arsye, ka kërkues, e cila i është drejtuar Shoqatës, nga disa shoqata që veprojnë në Bellgjikë, të organizojnë një protestë para selisë së Bashkimit Europian në Bruksel. Qëllimi i Protestës do të ishte, që në Pyetësor, i cili për vendet kandidatë është një fletore me detyra shtëpie, të futet edhe zgjidhja e statusit dhe kompensimi material i të burgosurit dhe i të persektuarit politik shqiptar në Maqedoni. Kërkesa është që protesta të mbahet në muajin tetor të vitit 2012. Shoqata jonë e ka miratuar këtë kërkesë të mërgimtarëve tanë, nga të cilët shumica janë viktime të represionit komunist sllav. Protesta do të mbahet në 27. 10. 2012, para selisë së BE në Bruksel, me ç'rast sekretariatit kompetent për këtë regjion do t'i dorëzojmë një Memorandum. Shoqata në këtë protestë do të përfaqësohej nga udhëheqësia e vetë më e ngushtë. Ne kemi të drejtë të dyshojmë, mos vallë problemi i çdëmtimit të të burgosurve dhe të persektuarve politikë shqiptarë, nuk është futur në raportet e përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare në vend, ndoshta me qëllim, dhe duke mos pasur informacion të vërtetë sekretariatit që përpiloi Pyetësorin për Maqedoninë nuk e përfshiu edhe këtë problem. Përfaqësues të Shoqatës, në takime me ambasadorë të BE dhe ambasada të ndryshme ua kanë prezentuar Propozim Ligjin e Shoqatës për çdëmtim, dhe problemet me realizimin e qëllimeve tona.

Sikurse që është i informuar opinioni shqiptar, Propozim Ligji i Shoqatës qëndron nëpër sirtarët e Parlamentit dhe Qeverisë që nga viti 2005. Ky projekt nuk është realizuar deri më sot nga partitë politike shqiptare për arsye se asnjë parti politike shqiptare deri në ditët e sotme këtë Propozim Ligj nuk e kanë futur në Programet e vetë politikë.

Të burgosurve politikë nga ish sistemi komunist, akoma u rinë në qafë dënimet e ish sistemit. Parlamenti duhet të sjellë një ligj, me të cilin do të shvleftësohen të gjithë aktgjykimet me karakter politik, dhe kjo do të hapte rrugën për çdëmtim material.

Janë shumë të kota orkestrat e papagallëve qeveritarë, të cilët vajtojnë (për këtë janë të paguar) për mospranimin e Maqedonisë në NATO e BE. NATO dhe BE nuk pranojnë kopukë, të cilët nuk janë në gjendje të pastrojnë me të kaluarën. Qeveritarët e Maqedonisë mendojnë se me miratimin e qindra ligjeve nga agjenda Europiane, i kanë hedhur sy pluhur Europës. Vërejtjet e përmotshme të Departamentit të Shtetit Amerikan, Vërejtjet e Komitetit të Helsinkit për shkelje të të drejtave të njeriut, vërejtjet se në Maqedoni praktikohet torturë ndaj të burgosurve, vërejtjet e Ombudsmanit, vërejtjet për gjyqësorin, dhe disa dhjetra vërejtje të tjera nga politikbërësit më të rëndësishëm botëror, i tregojnë pushtetit kopuk në Maqedonisë, se çfarë detyrash i presin. Papagallët e pushtetit le t'i përveshin krahët t'i zgjidhin problemet me të drejtat e njeriut në vend, dhe mandej ta ëndërrojnë NATO-n dhe BE-në. Le të mos harrojmë se edhe Greqia, Bullgaria, Rumania, dhe disa shtete të tjerë janë në NATO dhe BE. Ne i dimë problemet e Greqisë me pronat Çame, me turqit që nuk figurojnë askundi si turq, por vetëm si mysliman. I dijmë problemet e 2.000.000 turqve që u dëbuan nga Bullgaria në fillim të viteve të tetëdhjeta. I dijmë edhe problemet e 1.500.000 milionë hungarezëve, që qeveria Rumune i shpërnguli nga kufiri me Hungarinë në fillim të viteve të tetëdhjeta. Spanja ka probleme me Katallinjën, Baskët. . . . Ka disa dhjetra probleme në shtetet e BE, të cilat janë të ngjashëm me problemet e shqiptarëve në Maqedoni. Këto probleme llogariten si probleme të ngrira. Prandaj Shoqata i porositi megafonët qeveritar, zgjidhni problemet në shtëpi dhe mandej ëndërroni Europën.

Problemi me të burgosurit dhe të persektuarit politikë shqiptarë në Maqedoni, mundet më së miri të zgjidhet sipas modelit të Shqipërisë, Sllovenisë dhe Gjermanisë. Do tu kisha rekomanduar pushtetarëve shqiptarë në Maqedoni. Tirana është afër. Kontakti Komisionin e Ligjeve dhe Shoqatat e të Persektuarve Politikë të Shqipërisë, dhe futni zgjidhjen e problemit në programet e juaja afatgjata (në rast se i keni) Vetëm pasit të kryhen këto aktivitete, ne si Shoqatë do të kishim besuar se disa nisma që po përmenden në Parlamentin e Maqedonisë, për zgjidhjen e këtij problemi janë serioze.

Në Parlament, si fillim i zgjidhjes të këtij problemi le të sillt një ligj për shvleftësim të gjithë aktgjykimëve me karakter politik nga ish sistemi komunist i Jugosllavisë. Validiteti juridik i këtyre aktgjykimëve pengon fillimin e procedurës për çdëmtim. Këtë nismë, ne si Shoqatë do ta kishim kuptuar si një gjest të vullnetit të mirë

Për pjesëmarrje në Protestën e 7 qershorit kishte kërkesa të disa shoqatave dhe organizatave që të marim pjesë me parullat dhe folësit e tyre. Duka marë parasysh qëllimin informativ dhe paralajmërues të protestës në fjalë, organizatoti i Protestës nuk lejoi, as folës as dekor dhe as parulla, përveç atyre që i kishte paraparë Këshilli Organizativ i Protestës. Përveç Protestës përpara Selisë së BE në Bruksel, Në muajin tetor, Shoqata e jonë do të jetë pjesë e një Proteste, ku organizatorë do të jenë disa shoqata, të cilat do të paraqiten me dekor dhe oratorë secili për vete. Protesta e tetorit do të jetë antiqeveritare dhe më radikale. Do të kërkohej që protestuesve të bashkëngjiten edhe deputetët shqiptarë të Parlamentit të Maqedonisë, ose të japin dorëheqje.

Ne i japim kohë Qeverisë, që deri në pjesën e dytë të muajit tetor, t'i lëvizë gurët nga vendi, përndryshe deklaratat e Kryetarit të Grupit Parlamentar të BDI, z. Talat Xhaferi se BDI do ta zgjidhë këtë problem në Parlament dhe jo në rrugë, do ti marim si tentim për ta penguar mbarëvajtjen e Protestës së qershorit, e cila për ne ishte suksesshme, dhe protestat e ardhshme të Brukselit dhe atë të tetorit.

Protesta e qershorit kaloi. Të gjithë jemi të kënaqur. Ne si Shoqatë jemi të kënaqur pasi e dhamë mesazhin që deshëm. Kishim numrin që prisnim, edhe pse dështuan përkrahësit nga rrjetet sociale. Edhe Mijallkovi (shef i shërbimeve sekrete në Maqedoni dhe kushëri i Kryeministrit Gruevski) është i kënaqur, pasi klyshët e tij që flasin shqip dhe veprojnë maqedonisht e bënë argatllëkun e tyre të radhës, duke punuar në sabotimin e Protestës. Edhe 500 forca speciale të policisë, që rrinin në gjendje gadishmërie prapa Qeverisë dhe pranë Kalasë janë të kënaqur. Vetëm kuizlingët e kënaqur kanë haruar tekstin e njërës nga pllakatat e Protestës, i cili ishte. . . 24000 (ky është numri i të burgosurve e persektuarve politikë shqiptarë në Maqedoni) herë 30 persona, të cilët i ka secili i persektuar në rrethin më të ngushtë, rrezultoi se 720.000 shqiptarë janë të prekur nga persektimet e ish sistemit.

Autori është kryetar i Shoqatës së të Burgosurve dhe të Persektuarve Politikë Shqiptarë në Republikën e Maqedonisë. Shkrimi nuk shpreh qëndrimin e redaksisë.

Keni nje histori per te treguar?

Nje ngjarje per te kujtuar?

Nje liber per te promovuar?

Nuk keni nevojë per MIK, as PARA per te paguar...

vetem shkruani ne email in <rrugaearbërit@gmail.com>

Nga ABDURAHIM ASHIKU

Ishte një udhëtim i bukur, nga më të bukurit të jetës time. I treti-i vërteti.

Në udhëtimin e parë kisha përshkuar Mitrovicën në udhëtimin drejt Prekazit, i kisha ra tangjent qytetit në udhëtimin drejt kullave të Isa Buletinit për tu ndalur në Muzeun e Kistaleve dhe më tej për tu ngjitur bjeshkëve të mahnitshme të Bajgorës...

Në udhëtimin e dytë u ngjita mbi bedenat e kalasë së moçme të Novobërdës, hyra në zemër të malit të Mermertë të Gadimës për të bërë hapa "pyllit" të stalakтитеve dhe stalagmiteve të famshme...

Në udhëtimin e tretë hyra në zemër të Kosovës, bujta në Prishtinë, përshkova tek e tej Fushën e Kosovës, u përula për të dytën herë para varreve të familjes më të madhe historike shqiptare, familjes së Jasharëve, piva kafe me një ministër si të pija me një shok fëmijërie, prezantova në një sallë komode të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "NJERËZIT QË I DUA", portretet e emigrantëve shqiptarë në Greqi...

Bukuria e këtij udhëtimi lidhej me një ftesë, me Ftesën e Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës, ftesën për të qenë krahas tre shkrimtarëve kosovarë në "Ditët e Diasporës-2012" për prezantimin më 4 gusht të krijimeve letrare...

Po përcjell fjalët e mia për Njerëzit që i Dua...

\* \* \*

Quhem Abdurahim Ashiku. Kam lindur në pranverë të vitit 1941 në katundin Brezhdan, fshati më i madh i Dibrës së Poshtme.

Është kënaqësi e njëkohësisht nder i madh për mua të jem në Prishtinë me pesë libra për "Njerëzit që i dua", të jem në Kosovë e midis kosovarëve që në femininë time kanë hyrë e kanë bërë rrënjë si divat e përrallave, në një trevë të moçme shqiptare ku, siç tregonin pleqtë në "Odën dibrane", "misrin nuk e çan dot kali, grurin nuk e pret dot drapri dhe bostanin nuk e mban dot kerri". Sot Kosova përjeton "prodhimin" më të madh, mbjellë e rrit me grykën e pushkës, pushkën e Azem e Shote Galicës, pushkën e Adem Jasharit dhe bijve të saj më të mirë, Lirinë. Po të mos ishte gryka e pushkës e trimave dhe trimëshave kosovare unë nuk do të isha këtu para jush dhe ju para meje. Ta gëzoni lirinë!

Faleminderit Ministrisë së Diasporës të Kosovës për ftesën! Faleminderit Bibliotekës Kombëtare të Prishtinës për hapësirën që më ka krijuar të them dy fjalë, pak për vete e shumë e shumë për Njerëzit që i Dua, për emigrantët shqiptarë, për mësuesit vullnetarë shqiptarë në Greqi-Rilindësit e Kohës Sonë. Shpresoj që nëpërmjet fjalëve të mia t'i shihni ata në rrugën e mundimshme të ikjes dhe qëndrës, të rritjes dhe ngritjes plot jetë e dinjitet.

Shkrimi i parë i jetës sime daton më 8 maj 1957, 55 vjet më parë, një shkrim për bashkënxënësit e mi të Teknikumit Bujqësor të Fierit në një ekskursion në Pojan, në Apolininë e njohur që aso kohe flinte thellë tokës së lashtë shqiptare.

Më pas do të lidhesha me "Zërin e rinisë" si nxënës në Fier dhe si student në Tiranë, me Agjencinë Telegrafike Shqiptare si gazetar profesionist, me "Ushtimën e maleve" -gazetë e rrethit të Dibrës si redaktor, me gazetën e revistën, me RTSH, për ta mbyllur udhëtimin tim mes faqeve të shtypit, gjithnjë nga Dibra, e për tu nisur në verë të vitit 1996 rrugës së vështirë të emigrantit në një moshë kur krahu dhe këmba e kishin të vështirë të mbanin peshën e rëndë për bukën e ditës.

U largova nga shtypi i vendit tim për tu lidhur ngushtë po me "shtypin tim", tash në një vend të huaj, vend ku fjala e shkruar shqipe qe e ndaluar... Heronjtë e mi tash ishin hallexhinj si unë, njerëz "Nëntë male kaptuar" si në legjendat e njohura shqiptare, njerëz që kërkonin një punë për të derdhur

# Në Prishtinë me Njerëzit që i dua



djersën e pastër, një shans për të qëndruar në këmbë.

Kam derdhur fjalët e mija faqeve të shumë gazetave shqipe në emigracion, faqeve të "Egnatia", "Vëllazërimi", "E vërteta", "Emigranti", "Tribuna", "Gazeta e Athinës", "Plus Gazeta Athina"...

I dua njerëzit ndaj ciklit tim publicistik, tash prej pesë librash me mbi dy mijë faqe, i kam vënë titullin "Njerëzit që i dua". Duhet të duash që të shkruash, duhet të dashurosh që të shkruash. Pena pa dashuri nuk lëviz faqeve të bardha të letrës.

Kur përçolla për botim një tufë shkrimesh nga "Ivadihi" i krijimtarisë publicistike në mërgim, botuesi më tha se ishin jo për një por për "tre vëllime". U futa "gërshërën" duke prerë e vënë stavë më se dy të tretat. Mbi kopertinë, mbi një fotografi timen në perlën e bukurisë së Korabit, Bjeshkën e Panairit, shkrova "NJERËZ QË I DUA" - Vëllimi i parë.

"Këto radhë ua kushtoj prindërve të mi, Hajredinit dhe Defes, që më mbushën çantën me bukë misri dhe më vunë t'udhëtoj rrugës së bukur të dijes dhe dashurisë për njerëzit". Ky ishte përkushtimi im i parë...

Libri i dytë nis me një përkushtim në adresë të...

\* Mësuesve të mi që asokohe më vunë përpara një pllakë dhe një laps guri dhe më thanë: "Shkruaj gjuhën e bukur shqipe!"...

\* Mësuesve emigrantë, përkushtimi i të cilëve ngjan si dy pika loti me atë të Rilindësve të Mëdhenj të Kombit Shqiptar...

"Shoqës së jetës, Natasha Ashiku - mësuese në më se tri dekada në ciklin e ulët dhe në ushtrimoren e Shkollës Pedagogjike të Peshkopisë... në 60 Vjetorin e Lindjes.

...Dhe mbyllet me një meditim për vete dhe për mësuesit...

"Unë, gazetari emigrant, mora "bisturinë" dhe provova të hyj në një plagë, në plagën e madhe të asimilimit të vullshëm të gjuhës shqipe dhe të fëmijëve tanë në emigracion..."

Nuk e di se sa thellë ka hyrë "bisturia ime" dhe sa i kam bërë të ndërgjegjshëm njerëzit për rrezikshmërinë e saj.

Do të isha i lumtur sikur ky libër, këto fakte të jetuara, t'i merrnin në dorë në radhë të parë politikanët e pushtetarët, pushteti dhe shteti, Kuvendi dhe kuvendarët, të majtë dhe të djathtë dhe të reflektonin menjëherë, me vendime shteti e ligje kuvendi si masa parandaluese për mos gangrenizimin e plagës...

Do të isha i lumtur sikur mësimet e këtij libri t'i bënin të ndërgjegjshëm prindërit, gjyshet dhe gjyshërit për t'i marrë për dore fëmijët dhe nipërit e mbesat e për t'i ulur në bankat e shkollimit plotësues të GJUHËS SHQIPE...

Unë kaq munda dhe kaq bëra... Kjo nuk do të thotë se pena ime do të

ndryshket përballë:

"Shpendrave, hithrave, ferrave që sipër na kanë rënë dhe dritën na kanë zënë me fletë shumë të gjera." Athinë, 22 qershor 2008

Provova ta mpreh më tej lapsin. Libri i tretë - "Shkolla Shqiptare e Athinës- Rilindësit e kohës sonë-2" - nis me fjalë të dala nga shpirti i shenjtë i Nënë Terezës...

...Atyre që ndezin qirinj...në vend që të mallkojnë erësrirën.

Dhe mbyllet me meditimim e një mësuesi që ka hap të parën klasë të Shqipërisë në fshatin e largët grek Saranti të Thivas...

...Gjithmonë kam pas dëshirë të arrij këtë ditë. Gjithmonë e kam pas brenda vetes. Profesionimi i mësuesit më ka pas pëlqyer shumë. Kur u larguam ato vite, flas për vitin 1997, u ndjeva ngushtë, ishte një punë që nuk e çuam në fund, një punë që e lamë përgjysmë. Mbase kjo është ajo forca shtytëse më e madhe që më detyron, që më bren se kam lënë diçka pa bërë nga ajo që mundja të bëja.

Nuk flasim vetëm për ëndrra. Flasim këtu se kemi detyrime. Është ëndërr, por kemi edhe detyrime. Kemi detyrime ndaj Atdheut, në ofitë se do të themi këtë fjalë që sa vjen e nuk po dëgjohej më. Kemi detyrime ndaj atij mjedisi që na përgatiti ne për mësues, që të luanim një rol që duhet të luanim, por siç e thashë e lamë në gjysmë.

Shtoj edhe ndaj kërkesës që njeriu ka ndaj vetes. Ajo bile duhet të jetë kërkesa më e lartë: Çfarë kërkesash ke ti ndaj vetes? Këtë e bëj për të shlyer diçka që e kam lënë në gjysmë dhe në rast se do t'ia arrij qëllimit, siç duhet të them sinqerisht, do të ndjehem i lumtur. Është një ëndërr për mua sikur këta të arrijnë të lexojnë dhe të shkruajnë në atë shkallë që dua unë...

Libri i katërt i kushtohet Dibrës, vendlindjes dhe vend-dashurisë sime të madhe. Ai vjen nga larg me një thirrme ngjethëse...

"Është koha që të ngrihet zëri për mos mbytjen e Dibrës, bukurisë dhe historisë së lavdishme të luginës së Drinit", vjen me thirrjen: "PO DIBRËSI! JO SKAV ICËS!"

Është kjo një përmasë tjetër e dashurisë sime jo thjesht për Dibrën por për Shqipërinë mbarë që uji i zi i keqbërjes mos i kapë për fyti e tu mbulojë fytyrën.

Kërkova dhe kërkoi, u luta dhe lus që Lujna e Drinit të Zi nga Gjurica në Skavcë, lujna më e bukur e lumenjve të Shqipërisë, lujna ku lindi dhe u rrit Gjergji i Gjon Dibranit, lujna ku nga 25 beteja fitimtare të Skënderbeut 18 janë zhvilluar dhe fituar atje, të mos mbytet për hir të interesave kapitaliste, të mos detyrohen më se 40 mijë banorë të lënë themelet e shtëpive, tokat e mbrojtura me gjak në shekuj, varret e të vdekurve dhe

të vrarëve, të mos ikin siç ikën dibranët në vitin 1913 kur qyteti i tyre, Dibra e Madhe, iu dha serbit...

I pesti i serisë publicistike "Njerëzit që i dua" vjen "Rrëfimet e komshiut", tregime të jetuara, vjen me faqe jete në emigracion, mbijetesë në një vend ku racizmi dhe ksenofobia përballen me dashurinë e njerëzve të thjeshtë.

Libri vjen me përkushtimin...

"...Njerëzve të dashur, Natashës - shoqe e jetës, dy djemve - Altinit dhe Indritit, vajzës - Erblinës, Gurjonit, Ebit dhe Eralit - mjaltit të mjaltit të jetës sime, miqve të emigracionit - pjesë e gjallë e këtyre tregimeve, njerëzve që i dua..."

Athinë, 11 maj 2011- në 70-vjetorin e jetës sime"

Libri nis me "Një letër në vend të parathënies", me një pikturë mbi kopertinë ku ka dorë mësuesi, kanë dorë edhe nxënësit shqiptarë të fshatit Saranti.

Nis me gjuhën shqipe... dhe mbyllet po me gjuhën shqipe, nis me një letër nxënësishe...

...Më tepër se kopertina e një libri kjo skicë e thjeshtë është një bashkëpunim me fëmijët e shkollës "5 Maji" të fshatit grek të Sarantit. Po, po, nga duart e tyre është bërë ngjyrosja. Duken gërvishtjet e lapsave, duket dora feminare në bashkimin e shkronjave, duket dëshira dhe dashuria e Dhimitrës e Aldos, e Megit, e grekut të vogël Panajotis, e Aspasisë, Erit, Frrokut, Kledit...

Donin të gjithë të vinin diçka në këtë kopertinë, sepse edhe xhaxhi Duro i do dhe i ka ndihmuar kaq shumë.

Kjo kopertinë nuk ka shkëlqimin e atyre që prodhohen në studiot moderne, por ka sinqeritetin feminar të pa interpretueshëm vetëm se nga duart e tyre.

Përsëndetje!  
Grupi i fëmijëve: Dhimitra, Aldo, Megi, Panajotis, Aspasia, Eri, Frroku, Kledi, Melina, Amela...Mësuesi Eqerem Elezi.

...Dhe mbyllet po me gjuhën shqipe, me DËSHMITAR NË GJYQIN E GJUHËS SHQIPE, gjyqin ndaj drejtoreshës së shkollës së Gravas në Athinë Protonotarjo dhe mësueses shqiptare Karkallo.

Drejtesia greke i dha pafajësi drejtoreshës së shkollës fillore të Gravas në Athinë Stela Protonotario dhe mësueses së gjuhës shqipe Denada Karkallo, pushuar nga puna dhe akuzuar se kanë hapur klasat për mësimin e gjuhës shqipe në shkollë publike...

Do më pyesni për të ardhmen?  
Kam shumë, shumë njerëz që i dua.

Janë mësues të rinj të gjuhës shqipe, Rilindës të shqipes që shpresoj t'i mbledh bashkë në një vëllim të ri me titull: "Mësuesit, këta Rilindës çudi".

Janë njerëz të punës që më zgjojnë dëshirën ti takoj, ti fotografoj, të shkruaj për ta.

Dua të botoj një libër të veçantë për shtyllën e jetës në emigracion, për gratë emigrante, këta "shpinë këputura e punë pa dukura" që pastrojë Greqinë, mbajnë shtëpinë, lindin e rrisin fëmijë.

Merak e kam t'i mbledh gjithë kritikën e mia në adresa mes nesh e jashtë nesh në një libër me titull "FLAS KOT"...

Unë flas kot,  
Ti flet kot,  
...  
ASKUSH NUK DËGJON  
Unë shkruaj kot,  
Ti shkruan kot,  
...  
ASKUSH NUK LEXON.  
Megjithatë...  
UNË FLAS...  
UNË SHKRUAJ...  
Shpresoj që shkrova dhe fola plot, që më dëgjuat sot dhe do të më lexoni sot e mot.

*"Mendoj, se donacionet e mia në shumë sfera në Dibër, kanë ndikuar pozitivisht në jetën e bashkëqytetarëve të mij. Dua të thërras dhe biznesmenët e tjerë që të bëjnë donacione me të cilët përmirsohet jeta e bashkëqytetarëve në komunë ku jetojmë"*

## Ibrahim Kolari nderohet me Çmimin: "Filantrop Individual - humanisti më i dalluar" për vitin 2011 në Maqedoni

Nga BEQIR SINA, New York

DIBER E MADHE : Siç ka njoftuar nëpërmjet faqes së saj të internetit i Qendrës për Zhvillim Institucional CIR-a, i nominuari nga Qendra për Zhvillim të qendrueshëm të komunitetit, biznesmeni i sukseshëm nga New Yorku Ibrahim Kolari, i cili ka investuar edhe në Dibër të Madhe, është fitues i çmimit për filantropi individuale nga diaspora e Maqedonisë në organizim të Qendres për Zhvillim institucional CIRA.

Qendra për Zhvillim Institucional – CIR-A me seli në Shkup edhe Filantropi, duke ndarë Çmimin për filantropistin më i mirë individual i vitit në Republikën e Maqedonisë, thotë se ndau këtë Çmim për zoti Ibrahim Kolari, për donacionet e shumta që biznesmeni i sukseshëm dibran në New York ka dhënë gjatë vitit 2011 në ndërtimin dhe sanimin të objekteve të arsimit, objekteve fetare, ndihmë në furnizimin të aparaturave në sferën e shëndetsisë, sportit dhe sfera të tjera në komunën e Dibrës dhe komunat përreth saj.

Pra sipas CIR-A, "Për këto vlera humanitare, solidariteti dhe etikës, biznesmeni nga New Yorku - SHBA, Ibrahim Kolari, i jepet Çmimi: "Filantrop Individual - humanisti më i dalluar" për vitin 2011 në Maqedoni.

Mes fituesve të cilët kanë dhënë kontribut të veçantë në sferën e filantropisë dhe përgjegjësisë qytetare janë, për këtë vit janë edhe Media Print Maqedoni, Banka Komercijale, Alkaloid, Tineks, ONE shërbime telekomunikacioni, të cilët siaps kësaj organizate kanë treguar interes të posaçëm dhe investim në vlerat e solidaritetit, respektit, etikës dhe humanitetit.

Ibrahim Kolari i cili më se 20 vite jeton dhe punon në New York - SHBA është një veprimtarë i dalluar i komunitetit. Anëtarë i hershëm i kryesisë së Federatës PanShqiptare të Amerikës VATRA, ish kryetar i Shoqatës Atdhetare Dibra në New York, dhe është një ndër bisnismenët e parë dibran që pos bizneseve që ka në SHBA, ka bërë investime edhe në vendlindjen e tij në qytetin e Dibrës së Madhe. Ai disa vite më rradhë është edhe një donator, i cili ka ndihmuar shumë aktivitete në komunitet dhe në Dibër të Madhe.

Duke iu referuar shtypit dibran Kolari ka thënë se ky çmim është një obligim edhe më i madh për të dhe shton se edhe viteve të kaluara por edhe në vitet e ardhshme do të vazhdojë të ndihmojë institucionet por edhe oorganizatat e ndryshme humanitare. Duhet theksuar se biznismeni Kolari

**■ CIRA: Kolari, merr çmimin për donacionet e shumta që biznesmeni i sukseshëm dibran në New York ka dhënë gjatë vitit 2011 në ndërtimin dhe sanimin të objekteve të arsimit, objekteve fetare, ndihmë në furnizimin të aparaturave në sferën e shëndetsisë, sportit dhe sfera të tjera në komunën e Dibrës dhe komunat përreth saj.**

në Dibër ka investuar në fabrikën për përpunimin e betonit "Korabi- Redimix", para më shumë se një dekadë dhe me sukses ia ka arritur qëllimit.

"Donacione kam patur, citohet të ketë thënë zoti Kolari, dhe kam edhe në SHBA, thot Kolari dhe shton se humanizmi duhet të jetë present tek të gjithë personat që kanë mundësi të ndihmojnë. Mendoj, se donacionet e mia në shumë sfera në Dibër, kanë ndikuar pozitivisht në jetën e bashkëqytetarëve të mij. Nuk dua të flas për donacionet, por dua të thas dhe biznismenët e tjerë që të bëjnë donacione me të cilët përmirsohet jeta e bashkëqytetarëve në komunë ku jetojmë" ka thënë Kolari.

Kolari poashtu thotë se do të bëjë edhe investime të reja në Dibër të Madhe

Dëshiroj që investimet e mia edhe në qytetin e vendlindjes-Dibrën, sa do pak të zbusin papunësinë e të rinjve por edhe mërgimtarë të tjerë dibran të investojnë në Dibër. Ndërsa ne që duam të investojmë në qytetin tonë do të mundohemi që të fitojmë tendere për të investuar si në infrastrukturë rrugore ashtu edhe në ndërtime të tjera.



**Çfarë është CIR-A ?**

CIR-A, është institucion i pavarur, jo-qeveritare e cila është themeluar në shtator të 2003 nga stafi vendor i Programit të Rrjetit të për Demokraci - të sponsorizuar USAID-it (DemNet) realizuar në Maqedoni nga viti 1995 deri në vitin 2004. Gjatë kësaj kohe, CIR-a, ka ofruar grante për më shumë se 350 organizata të shoqërisë civile (OSHC) dhe ka mbështetur financiarisht 317 projekte të shpërndara në fusha të ndryshme të kontaktit me një buxhet total prej 8.050.000 dollarë amerikan.

Përveç kësaj, CIR-A, ka krijuar mbi 200 seanca trajnuese që ishin projektuar dhe do të delegohen me qëllim të forcimit të shoqërisë civile në Maqedoni. Misioni i Qendrës për Zhvillim Institucional CIR-A, është forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile dhe komunitet lokal për arritjen e ndryshimeve të prekshme të komunitetit. CIR-A përpiqet për të arritur synimet e saj nëpërmjet forcimit të kapaciteteve, duke promovuar pjesëmarrjen e publikut dhe mobilizimin e resurseve lokale në zgjidhjen e çështjeve lokale në nivel komuniteti. Qëllimet strategjike të saj janë: . Ndërtimi i organizatave dhe institucionve efektive dhe efikase 2. Zhvillimi i filantropisë në Maqedoni 3. Pjesëmarrëse zhvillimin e komunitetit të biznesit.

## DY BOTIME TË REJA NGA NAIM BERISHA




... Ajo që e dallon poezinë e Naim Berishës është se çdo gjë e thotë në mënyrën e vet, pa përsëritur të tjerët. Pra, krijimet e tij kanë originalitet dhe kur i lexon thua: - Sa bukur i ka vajtur në mendje poetit!

Ca si mësues e ca me intuitë, Naimi e di mirë se pa një fabul, pa një gjetje, pa një të papritur, pa një detaj dhe pa një shpoti nuk mund të ketë vjersha për fëmijë. Prandaj në poezitë e tij këto gjëra i gjen të shkruara në një. Pa këto, sado e bukur të jetë vjersha, fëmija nuk e kupton, nuk e shijon dhe e harron poetin dhe poezinë e tij.

Pra, Naimi e ka gjetur rrugën për të bashkëbiseduar me lexuesit, prandaj poezia e tij do të pëlqehet shumë...

Naim Berisha  
KUR GRINDEN SKELETET  
Fabula +  
Botimet "M&B"  
ISBN: 987-99956-04-79-0  
Çmimi: 300 lekë

Naim Berisha  
LEJLEKËT E LUMIT TIM  
Poezi  
Botimet "M&B"  
ISBN: 987-99956-04-78-3  
Çmimi: 300 lekë



# intervistë

Në foto: Dashi Alpion, 2012.  
Poshtë: Gëzim dhe Dashi Alpion  
në Universitetin e Durhamit, 1996

## Si gjeta ekuilibrin e artë mes karrierës dhe familjes

Intervistoi: MIRELA SULA

*"Dashi është një bashkëshorte ideale. Çështja nuk është se sa e kam përkrahur unë Dashin, por se sa vendimtare ka qenë dhe mbetet përkrahja e Dashit për mua". Kështu thotë sociologu Gëzim Alpion, bashkëshorti i Dashi Alpionit, këshilltarrë karriere në Universitetin e Birmingamit. Teksa jemi mësuar të shohim burra në karrierë, të mbështetur nga gra të forta që menaxhojnë shtëpinë e fëmijët, në rastin e Alpionëve askush nuk është tërhequr. Të dy kanë ecur krah për krah duke gjetur ekuilibrin e duhur mes karrierës dhe familjes. Në një intervistë, Dashi Alpion tregon se si ia doli mbanë në Angli të ndërtonte jetën e saj pa u ndierë inferiore për origjinën e saj nga një vend i vogël si Shqipëria.*

**Ju i përkisni asaj kategorie shqiptarësh që e kanë kërkuar dhe e kanë gjetur suksesin.**

Në Angli ne erdhëm për studime dhe që në fillim e kishim të qartë se çfarë donim të arrinim. Sigurisht që kemi punuar shumë, por pa përkushtim asgjë nuk arrihet.

**Si arrin një grua që jeton në vend të huaj ta ruajë balancën mes familjes, karrierës dhe kulturës nga ajo vjen?**

Si intelektuale kam balancuar me sukses përkushtimin ndaj familjes dhe karrierës. Kjo është bërë e mundur edhe nga përkrahja e vazhdueshme e Gëzimit. Si nënë, sigurisht që rritja e fëmijëve bëri që karriera të kalojë në plan të dytë për disa vite, gjë të cilën e bëra me shumë dëshirë.

**Tani ju jeni në një pozicion dinjitoz në Universitetin e Birmingamit. Si ndihen mes kolegëve dhe mjedisit që ju rrethon?**

Posti i ri është kurorëzimi i një periudhe intensive studimesh dhe eksperience të aku-



muluar në disa universitete dinjitoze angleze. Departamenti i Karrierës dhe Punësimit në Universitetin e Birmingamit është ndër më të suksesshmit në Angli dhe për mua është kënaqësi që jam pjesë e një kolektivi me një standard kaq të lartë profesional.

**Shpesh gratë duhet të sakrifikojnë karrierën e tyre për t'ua lënë radhën burrave, ndërkohë që te ju shohim një rast të veçantë – edhe ju edhe bashkëshorti juaj jeni në kulmin e karrierës. Si ka ndodhur ky koordinim?**

Sekreti i arritjeve tona si akademikë qëndron në dashurinë dhe mirëkuptimin që ka mbetur i njëjtë që ditën që jemi njohur. Besoj se edhe në Shqipëri mentaliteti patriarkal ka ndryshuar për të mirë në mënyrë që gratë të kenë mundësitë të përparojnë në profesionet

e tyre dhe të ndihen, të konkurrojnë dhe të trajtohen të barabarta me burrat në tregun e punës.

**Duke qenë edhe nënë e dy fëmijëve që tashmë janë të rritur, si keni arritur ta menaxhoni kohën që u takon atyre?**

Për mua dhe Gëzimin dy fëmijët tanë të mrekullueshëm mbeten gjithmonë parësorë. Jeta jonë profesionale bën që të kemi një aktivitet shumë të ngjeshur, megjithatë, ne gjithmonë jemi në gjendje të balancojmë aktivitetin profesional dhe jetën familjare. Fundjavat dhe pushimet e shpeshta janë shumë të rëndësishme për ne si familje.

**Cilat janë ambiciet tuaja për të ardhmen?**

Shpresoj që me kalimin e kohës të emërohem "konsulente karrierash".



### PASAPORTA PROFESIONALE

Pasi përfundon studimet për gjuhën angleze në Universitetin e Tiranës në vitin 1989, ajo jetoi në Egjipt dy vjet, ndërkohë që i shoqi, Gëzim Alpion, kryente studime pasuniversitare. Në vitin 1993 Gëzimi filloi doktoratën në Universitetin e Durhamit, ndërsa ajo u punësua në Qendrën e Linguistikës të Universitetit. Në vitin 2001 përfundon "Master of Arts" në Studimet Angleze në Universitetin e Birmingamit. Gjithashtu ka kryer edhe dy kualifikime pasuniversitare në Universitetin e Reading dhe Universitetin e Warwick. Në fillim të këtij viti Dashi Alpion është emëruar këshilltarrë karriere (Careers Adviser) në Universitetin e Birmingamit. Ky post akademik erdhi si rezultat i një karriere të suksesshme 10-vjeçare po në këtë fushë në disa institucione akademike si Newman University College dhe Universitetin e Aston-it. Është autore dhe bashkautore e disa studimeve në fushën e karrierave. Si Gëzimi, ashtu edhe Dashi me kënaqësi pranojnë të ndajnë eksperiencën e tyre të pasur akademike dhe profesionale me universitetet në Shqipëri në mënyrë që të përfitohet nga eksperiencia britanike në një fushë që akoma nuk njihet sa duhet në Shqipëri.

vetëm  
600 lekë  
në vit

# kontribuo për gazetën merr kopjen tënde

është koha për tu pajtuar...

Email: [rrugaearberit@gmail.com](mailto:rrugaearberit@gmail.com)

Rrëfen për gazetën ish i dënuari politik Lutfi Kazani, kryetar i Shoqatës të Persekutuarve Politik të rrethit Bulqizë.

# Ju tregoj për "grupin armiqësor" të Shupenzës

Nga HYSEN LIKDISHA

Ka qenë fillimviti '75 që përkonte me përfundimin e goditjes së grupeve të ashtuquajtura armiqësore në ushtri dhe përgatitjeve për nisjen e një tjetër goditje që do tu jepej grupeve armiqësore në ekonomi, kur dhe u përvijua nga ish Sigurimi famëkeq i Shtetit, goditja e një tjetër grupi të ashtuquajtur grupi armiqësor i Shupenzës, në rajonin e Dibrës, që bëri mjaft jehonë për kohën. Ja çfarë tregon i akuzuari si kryetar i këtij grupi, Lutfi Kazani. - Mëngjes, 23 janar 1975. - Kurrë nuk ma merrte mendja se ky do të ishte mëngjesi i arrestimit tim, pasi nuk kisha bërë asgjë përveçse punës në kooperativë. Sapo bëhesha gati për të shkuar në punë, punoja brigadier arash në fshatin Boçevë të kooperativës bujqësore Shupenzë, kur në shtëpinë time ja beh i plotfuqishmi i zonës, Faik Çera. - Do vish me mua në Shupenzë, pasi kemi një punë të rëndësishme bashkë, - më thotë ai. Sapo hyjmë dhe ulemi, në zyrën e të plotfuqishmit ja behin edhe 4-5 sigurimsa të tjerë. - E ke pasaportën me vete? - Po. - Ma jep mua më thotë i plotfuqishi. Sapo jap pasaportën më sulen nga prapa dhe më kryqëzojnë duart sigurimsat. - Në "emër të popullit" je i arrestuar!? - Nuk po kuptoja asgjë se pse dhe për çfarë mund të akuzohesha, pasi isha më se i sigurt se nuk kisha bërë gjë që të më çontë në prangosje. Pasi më çuan në dhomat e izolimit të ish Degës së Punëve të Brëndshme Peshkopi, në mbrëmje vonë hetuesi më konfirmoi edhe akuzën e arrestimit; "tradhti e lartë ndaj Atdheut", për organizim të grupeve armiqësore që kërkojnë përmbyshjen e pushtetit popullor. Brënda ditës pas meje ishin arrestuar edhe Sabri Llanin, Kalosh Murra, Setki Manjani dhe Muharrem Rusi të gjithë nga zona e Shupenzës, të afërm dhe miq të mi, duke kompletuar kështu sipas tyre grupin e plotë "armiqësor". Vetëm pas dy ditëve hetuesi, e cila niste në orën 15.00 dhe mbaronte në 03.00 të çdo nate, më ndërrojnë hetuesin, duke sjellë atë ish të tmerrshmin e hetuesisë së Dibrës, Pashk Jushin, i cili ka ushtruar torturat nga më çnjerëzoret ndaj meje. Torturat ishin aq të rënda dhe barbare sa për çdo natë prezent në këto tortura ishte një mjek dhe një infermier që ndërhyjnë në këto grupe të ish zyrtarëve të lartë të partisë dhe shtetit komunist.

**Po përse Sigurimi i Shtetit, kishte sajuar grupin armiqësor të Shupenzës?**

Këtë Lutfi Kazani e lidh me Mane Dumanin, dajën e tij, i arratisur në atë kohë në ish Jugosllavi, ku për 12 vite radhazi punoi si agjent i UDB-së, me një veprimtari të spikatur



në zonën kufitare të dy Dibrave, këndeje dhe andej kufirit.

**-Po kush ishte Mane Duman?**

Mane Duman ishte daja im nga fshati Stushaj i Shupenzës, pjesmarrës aktiv në luftën Nacional-Çlirimtare me Çetën e Dibrës krahu përkrah me Haxhi Lleshin, njëherësh drejtues, shok e mik i ngushtë i tij. Por me gjithë kontributin e dhënë në luftën Nacional-Çlirimtare, pas çlirimit të vendit ndjehet i pa begenisur nga regjimi i kohës, pasi lihet krejt i papunë dhe i shpërfillur. - Ka qenë gushti i vitit 1950, vijon të tregojë Lutfiu për gazetën, kur në festën e Zërqanit, gjatë drekës së shtruar për udhëheqjen pjesmarrëse në këtë festë, Manja bën fjalë me Haxhiun. -A kështu e patëm fjalën o Haxhi, t'i në udhëheqje dhe unë i papunë, - i thotë Manja. -Ngadal or Mane, se e ka në dorë jugu, - ja kthen Haxhiu. Sherri mes tyre u agravua deri sa dy burrat ish udhëheqës të Çetës së Dibrës, të nxjerrin revolet njëri-tjetrit. Fill pas këtij shërr, Mane Duman, duke ditur se miku i tij i ngushtë, Haxhi Lleshi, kishte natyrë të spikatur hakmarrëse, nis planin për tu arratisur në ish Jugosllavi. Kështu, pa e zgatur më tej, në një natë gushti të vitit 1950, Mane Duman si bashku me të vëllanë dhe 13 pjestarë të familjes, kalojnë ujrat e lumit të Drinit të Zi që në zonën e Shupenzë-Gjoricës shërben edhe si vijë kufitare ndarëse me ish Jugosllavinë duke përfunduar në Dibrë të Madhe. Këtu menjëherë duke shfrytëzuar edhe njohjet e miqtë e shumtë që Manja kishte në Dibrë të Madhe, në shenjë hakmarrje ndaj Haxhi Lleshit e pasuesve të tij, vihet në shërbim të policisë sekrete të ish Jugosllavisë UDB-së, ku pati një aktivitet të spikatur agjenturor për plot 12 vite radhazi. Me veti shumë të spikatura në fushën e zbulimit dhe njohës i mirë e me mbështetje në zonën kufitare të Dibrës, Mane Duman

u bë një agjent potencial i ish zbulimit jugosllav. Duhet thënë se Manja kishte një memorie për t'u admiruar, kishte lidhje të shumta, si dhe episode jo të pakta në sferën agjenturore. Pas goditjeve të forta, me 1948, ndaj grupeve "armiqësore titiste" në gjirin e lartë të udhëheqjes së Partisë së Punës e të shtetit komunist, Koci Xoxes e kompani, jo vetëm nuk mund të bëhej fjalë për "muaj mjalti" në marrëdhëniet me Jugosllavisë e Shqipërisë, por përkundrazi, situata precipitoi në gjendje lufte. Shqipëria e shihte tani Jugosllavinë si agjenturë të imperializmit amerikan, si një kërcënim të rrezikshëm për sovranitetin e saj dhe si armike të betuar të marksizëm-leninizmit. Ndaj dhe kohë pas kohe e akuzonte atë për ndërhyrje në punët e brëndshme të saj me anë të agjenturave të përgatitura e drejtuara nga UDB-ja. Natyrshëm që një situatë e tillë favorizoi shumë punën e Mane Dumanit në aktivitetin e tij agjenturor me UDB-në, duke u bërë atë një ndër aktivistët kryesorë të këtyre grupeve diversioniste ndaj shtetit komunist shqiptar. Një veprimtari e tillë ngjalli mjaft shqetësim për Sigurimin e Shtetit Shqiptar, i cili u vu në kapjen e tij. Por, për 12 vite radhazi nuk mundi ta realizojë një gjë të tillë, falë eksperiencës, shkathtësisë dhe përvojës tepër të spikatur që ai kishte në fushën e zbulimit. Në vitin 1962 pas 12 viteve punë intensive agjenturore me UDB-në, Manja familjarisht vendoset përfundimisht në Florida të SHBA-së ku dhe e mbylli jetën e tij.

**-Mendon se arrestimi juaj si dhe cilësimi si kryetar i "grupit armiqësor" të Shupenzës ka lidhje edhe me dajën tuaj të arratisur Mane Duman?**

-Absolutisht që po edhe pse ai kishte 13 vjet që ishte vendosur në SHBA dhe nuk ushtronte më aktivitet me UDB-në dhe kështu

nuk kishte mundësi të ekzistonte grupi armiqësor i Shupenzës, ku unë akuzohesha si kryetar i tij. Kjo pasi edhe personat e tjerë të këtij të ashtuquajtur "grup armiqësor" ishin të mirsajuar nga ish Sigurimi i Shtetit, pasi Kalosh Murrën e kisha djalë tezeje pra edhe ky ishte si unë nipi i Manes dhe Sabri Llanin e kisha dhëndërr, burrin e motrës. Kështu në opinion sigurimsat kishin një armë të fortë në dorë për ta bërë të besuar ekzistencën e këtij "grupi" edhe pse ai as kishte ekzistuar ndonjëherë, pa le më të kishte vepruar.

**-Lidhja e grupit me Manen veçse për tu bërë i besueshëm në opinion, mos ishte edhe një "hakmarrje" indirekte ndaj tij?**

Daja, për 12 vite kishte punuar intensivisht në lojrat zbuluese që UDB-ja nga njëra anë dhe Sigurimi i Shtetit Shqiptar nga ana tjetër organizonin në zonën kufitare të Dibrës, duke u vënë kështu në qendër të goditjeve të Sigurimit për eliminimin fizik të tij, por që në asnjë rast nuk e realizoi dot. Grupet armiqësore diktatura komuniste i sajonte sipas situatave sa herë ja kërkonte nevoja. Ndaj edhe grupi "armiqësor" i Shupenzës, ishte i mirsajuar e menduar në kohë pasi njëherësh edhe largonte vëmendjen nga dështimet në ekonomi, ku të ardhurat për ditë pune në ish kooperativat bujqësore po zeroheshin, por edhe ktheheshin në gjueti shtrigash brënda vetë nomenklaturës së lartë komuniste, ku drejtuesit e lartë të saj luftonin për eliminimin e njëri-tjetrit. Ndaj për më tepër se një hakmarrje, duke inkriminuar njerëzit e afërt të tij, sajimi i të ashtuquajturit "grupi i Shupenzës", ishte për të bërë të besueshëm ekzistencën e këtij grupi të sajuar prej tyre dhe njëherësh nëpërmjet tij duke na përdorur në të implikonin në grupin tonë edhe njerëz të tyre me funksione të larta në udhëheqjen e lartë të partisë dhe shtetit komunist. Kjo u bë e qartë që në ditët e para të hetuesisë.

**-Pse çfar tu tha copë në hetuesi dhe për sa kohë vazhdoi ajo?**

Hetuesia që vijoi për 16 muaj, ishte dhe do mbetet perudha më e vështirë e jetës, ku jetën dhe vdekjen i ndante vetëm se një mesë e hollë qepje, pasi kam provuar torturat më çnjerëzore që mund t'i bëhen një njeriu. Që në fillim të hetuesisë mu tha copë; - trego pjestarët e tjerë të grupit.

**-Dhe ju nuk treguat?**

Po ç'të tregoj, kur grupi nuk ekzistonte, por ishte veçse një sajësë e pështirë e Sigurimit, për të realizuar qëllimet e mbrapshta të tij. Pas disa akuzave bajate për sabotim të tipit kenë ndarë ujin e vijës së mullirit që të mos bluajnë fshatarët, hetuesi i pashpirt njeriu, Pashk Jushi, i përshkallëzonte akuzat, duke lexuar emra personash si gjoja pjestarë të grupit që unë drejtoja. Këtu fillon edhe befasia e çudia e madhe, por edhe zgjidhja e enigmës se përse u fabrikua nga Sigurimi i Shtetit, grupi "armiqësor" i Shupenzës. Dhe kjo ndodhi kur

në listën e të implikuarve në këtë grup u përmend krahas emrave të tjerë që një pjesë të mirë prej tyre as i njihja fare edhe emrat e Sami Kamberit dhe Sul Bahollit, i pari ish funksionar i lartë i Degës së Punëve të Brëndshme Peshkopi dhe i dyti ish Sekretar i Parë i Komitetit të Partisë të Rrethit Dibrë. Më kërkohet të bashkëpunoja me Sigurimin për të implikuar si të përfshirë në "grupin armiqësor" ku unë isha kryetari krahas mjaft emrave të tjerë edhe këta dy funksionarë të lartë të partisë dhe shtetit komunist. As vetë nuk e imagjinoj se si u kam rezistuar torturave çnjerëzore të hetuesisë për plot 16 muaj rresht, ku për çdo natë kaloja në vdekje klinike dhe vetëm ndërhyrja e mjekut dhe injeksionet që më bënin më risillnin në jetë. Si pasojë e këtyre torturave çnjerëzore që mu bëjnë në hetuesi, nga 75 kilogram përfundova në 30 kilogram dhe shtrimin në spitalin e Sanotariumit pasi Spitali i Burgut në Tiranë nuk mund të më mjekonte në gjendjen që isha katandisur. Por, në asnjë moment nuk pranova të bashkëpunoj për të pranuar ekzistencën e këtij grupi, që nuk ishte gjë tjetër veçse një sajësë e Sigurimit, për të implikuar jo vetëm njerëz me lidhje gjaku me Mane Dumanin edhe pse ai i kishte ndërprerë tashmë lojërat e zbulimit me UDB-në jugosllave të asaj kohe prej 13 vitesh dhe ndodhej në SHBA, por edhe funksionarë të lartë të shtetit komunist.

**-Gjyqi, akuzat me të cilat u përballët dhe dënimi.**

Gjyqi në një farë mënyre ishte edhe shpëtimi jonë pas torturave 16 mujore në hetuesi. U përballëm me akuzën e "tradhtisë së lartë ndaj atdheut" për krijim grupi armiqësor në shërbim të agjenturave të huaja.

**E pranuar akuzën?**

Në asnjë mënyrë, por edhe në gjyq e kundërshtova me forcë atë. Por përkundër mospranimit, qendrim që e kasha mbajtur edhe në hetuesi, pas një procesi krejt farsë, trupi gjykues dha pretendencën duke më dënuar me 25 vite burg.

**-Dënimi juaj pati konsekuenca për familjen?**

Shumë. Ishte ajo që e pagoi më tepër dënimin tim, pasi ndaj saj filloi persekutimi i gjithanshëm komunist. Më e goditur bashkëshortja që duhet të rriste 7 fëmijë e vetme pa asnjë lloj ndihme e përkrahje, por vetëm me punën në kooperativë, ku vlera e ditës së punës ishte vetëm 2 lekë, por edhe aty duhej të punonte ku ishte puna më e vështirë pasi ishte me biografi të keqe. Djali i madh, Bardhuli, mbaroi shkollën e mesme me mesatare të lartë 9.2, por nuk iu dha e drejta e studimit për në shkollë të lartë. Djali tjetër Bashkimi, me intuitën e mbijetesës, mundi të bëhet teknik për riparimin e televizorëve, por nuk iu dha e drejta e ushtrimit të profesionit. Për mbijetesë nisi të punonte privatisht, jasht orarit të punës në kooperativë, por vihet në pranga dhe dënohet me 10 muaj burg për ushtrim zanati

(Vijon në faqen 23)

# 100 Vjet Pavarësi

## Kuvendi i Arrasit

### dhe kryengritja e përgjithshme kundër serbe, gusht 1920

Nga MOISI MURRA

Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore dhe të fitores të Bllokut Qëndror, ushtritë serbe u drejtuan përsëri nga krahinat verilindore të Shqipërisë. Mbretëria serbe-kroate-slllovene nuk qe e kënaqur dhe nga coptimi që iu bë trojeve shqiptare në Konferencën e Londrës të vitit 1913. Ajo vazhdonte të mbante me forcë krahina të tëra brenda piramidave politike të vitit 1913. Kthimi i tyre e keqësoi mjaftë gjëndjen ekonomike, politike e sociale të trevës dibrane. Kishte tetë vjet që lufta nuk pushonte në Dibër. Fshatrat ishin djegur. Prodhimet bujqësore merrnin udhën e Beogradit. Blegtoria rrëmbehej e dëmtohej nga ushtria. Fuqia punëtore shfrytëzohej për ndërtimin e urave e objekteve ushtarake. Lënda drusore pritej e transportohej në Jugosllavi. Në këto kushte dibranët kishin kaluar në një qëndresë të kufizuar si rezultat i së cilës ishte krijuar një vijë fronti nga ura e Vezirit persëgjat rrjedhës së Drinit të Zi, vazhdonte Zallit të Shupenzës dhe tek ura e Çerenecit degëzohej. Një degëzim ndiqte rrjedhën e Zallit të Bulqizës deri tek kulla e Shabës, ndërsa drejtimi tjetër përsëgjatë Zallit të Okshtunit deri në shkallë të Borovës<sup>1)</sup> Qeveria e Tiranës duke qënë në korent të masakrave serbe në Dibër i kishte tërhequr vëmendjen parisë së krerëve të Dibrës për t'iu shmangur çdo konflikti që mund të shpërthente ndërmjet ushtrisë serbe dhe popullsisë së kësaj treve. Nga ana tjetër Qeveria e Sulejman Delvinës i kishte kërkuar disa herë Beogradit për tërheqjen e trupave nga tokat shqiptare. Por qëllimi shovinist për realizimin e ëndrrës së vjetër të Karagjorgjeviçeve serb ua kishte errësuar sytë për t'i parë problemet me ftohtësi e të drejtat kombëse të deputetëve të Dibrës: Ramis Dacit, Dine bej Maqëllarës, Dine Demës dhe Osman Litës, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.424, datë 4 korrik 1920, vendosi formimin e prefekturës së Drinit (Dibrës). me qendër në Peshkopi. Kjo prefekturë përfshinte nënprefekturën e Lumës, Hasit dhe Home-shit. Si prefekt emnohej Ramiz bej Dibra. Si fuqi për qetësinë e brendshme dhe për me sigurue kufijtë caktoheshin 500 xhandarë.<sup>2)</sup> Qeveria e Sulejman Delvinës megjithëse kishte miratuar ngritjen e kësaj prefekturë dhe kishte emëruar dhe nëpunës për drejtimin e administratës i kishte porositur deputetët e Dibrës si dhe Ramis Dibrën, që paralel me funksionet e prefektit kishte dhe atë të komandantit të ushtrisë kombëtare në prefekturën e Drinit, që hëpërhë të qëndronin diku në Qafë-Murrë dhe që andej të organizonin dhe drejtonin Prefekturën e Drinit, duke iu shmangur çdo konflikti me ushtritë serbe. Në tëvërtetë edhe disa nga krerët e Dibrës pajtoheshin me Qeverinë e Tiranës, e ndërta dhe Elez Isufi, por që nuk hiqnin dorë nga përgatitja e një kryengritje kundra serbëve. Aty rreth 10 korrikut 1920 krerët e Dibrës u mblodhën në shtëpinë e Sel Bajraktarit në Arras, të cilët ngarkuan Dine Hoxhën që t'i dërgonte një letër Ramiz bej Dibrës, ku t'i kërkohej të mos kalonte Qafë-Murrën. Dinja



nisi Liman Gjonin për t'ia dhënë letërën Ramis beut. Ky pasi e lexoi letërën porositi Liman Gjonin t'i thoshte Dine Hoxhës që kjo pari na kërkoi që të vijmë në Arras. Në të vërtetë vendosja e prefekturës në Qafë-Murrë e vështirësonte ndërlidhjen e drejtëpërdrejtë me masat popullore, me prijësit e fshatrave e veçanerisht me zonat e pushtuara nga ushtritë serbe. Vendosja e prefekturës në Qafë-Murrë ishte sikur ta vendosje në Krujë a Tiranë e prej aty të kryente detyra në të mirë të Dibrës, Lumës dhe Hasit. Ramiz Dibra, Ramis Daci, Dine bej Maqëllara, Dine Dema, Osman Lita, Jashar Erebara në një pleqërim që bënë tek Pazari i Urës, në Klos, nuk i morën në konsideratë as udhëzimet e qeverisë së Sulejman Delvinës dhe as dakortësinë e parasisë së Dibrës. Këta pasi kaluan Qafë-Murrën ranë në Arras, në konakun e Riza Lushës. Shumë thonë se Riza Lusha shkoi vetë në Qafë-Murrë dhe pasi i siguroi se do t'i mbante në kullën e tij, i udhëhoqi e ranë në Arras. Administrata, deputetët e Dibrës dhe 150 xhandarë, që kishte marrë me vete prefekti, nga 500 që kishte miratuar qeveria, nga 12 korriku deri më 17 gusht 1920 qëndruanë në shtëpinë e Riza Lushës dhe të mjedisëve për rreth. Pleqët, kryesisht nga Çidhna, duke kujtuar gjestin bujar të Riza Lushës, kanë treguar se në oborrin e tij në çdo tre-katër ditë therej një ka. Poeti thuri vargje:

Trimni e mend/Pat Riza Lusha.  
Ku shkoi la nam./Emnin e zanin  
Kombit ia ngriti;/Pa lule e tufa,  
Thjeshtë: Riza Lusha.<sup>3)</sup>  
Nga kjo kullë nisi veprimtarinë e saj, më 12 korrik 1912 Prefektura e Drinit (Dibrës). Administrata e prefekturës kishte një personel shumë reduktuar: Prefekti-Ramiz bej Dibra, sekretar duket Jashar Erebara, komandanti i xhandermarisë-Dulejman Çela, dhe nga letër këmbimi me qeverinë del se dhe Ramiz Dacit kishte funksion ushtarak dhe atë financiar. Më 7 gusht 1920, 3000 dibranë festuan fitoren e luftës së Vlorës kundër italianëve në një manifestim tek xhamia e Arrasit duke brohoritur "Rroftë Vlorë, Shqipëria e flamuri" nga ora 3.30 (15.30-M.M) deri në mbrëmje.<sup>3)</sup> Lajmi mbi fitoren e shkëlqyer të luftës së Vlorës e ndezën në kulm tensionin në popullsinë dibrane. Ramis Daci, pjesëmarrës në Kongresin e Lushnjes dhe deputet i



"Drinit" në një fjalim të mbajtur më këtë rast në substancë qe shprehur: "Kanë luftuar të parët tanë e ne na i kanë lanë t'i gëzojnë këto troje. Sot që na i ka pushtue serbi, do të luftojmë ne t'i gëzojnë fëmijët tonë. Do të luftojmë, or burra, se na ka ardhur rradha..."<sup>4)</sup> Foli dhe Sheh Shazumani i Vleshës i cili pasi bekoj armën shqiptare bëri duanë për dëshmorët e rënë në luftën e Vlorës e bëri thirrje për çlirimin e viseve shqiptare të okupuara nga ushtritë serbe. Pastaj prefekti Ramiz bej Dibra priti në prefekturë, në Kullën e Riza Lushës, gjithë parinë e Dibrës, që e uruan për fitoren e arritur në Vlorë. Por ndër kohë qeveria serbe e ndërseu ushtrinë e saj. Më 10 gusht 1920 trupat serbe pushtua befas territorin shqiptar në krahinat e Shkodrës, Dibrës dhe Elbasanit. Ata po marshonin në thellësi të vendit duke bombarduar fshatrat, duke shkatërruar çdo gjë në rrugën e tyre dhe duke përhapur tmerrin dhe vdekjen.<sup>5)</sup> Në situatë e krijuar Prefekti i Drinit, Ramis bej Dibra thirri në Arras, më 13 gusht 1920, krerët e Dibrës. Në katin e parë të kullës së Riza Lushës zunë vend: Ramiz Bej Dibra, Dine Bej Maqëllara, Izet Bej Maqëllara, Ramiz Daci, Jashar Erebara, Dulejman Cela nga Patini i Matiit, Ismail Strazimiri, Dine Hoxha, Selman Alia, Selë Bajraktari, Selim Noka, Haxhi Noka (Grykë Nokë), Murat Kaloshi, Avdi Kaloshi, Selim Kaloshi (Sinë), Met Skepi, Dan Cami, Selman e Hakik Mena nga Lura, Llan Destani (Lukan), Kurt e Dik Spata (Grykë Nokë), Destan Puca- Sopot, Osman Lita i Ploshtanit e shumë burra të tjerë me zë nga të gjitha Dibrës. Në kuvend u morrën një seri vendimesh që nga populli u quajtën vendimet e "Qeverisë së Arrasit". Krerët e mbledhur në Kuvendin e Arrasit, ashtu si krerët e kuvendeve tradicionale të Nandë Maleve të Dibrës, kapërcyen çdo mosmarveshje, u besatuan si burra dhe u vunë nën urdhërat e një shtabi luftarak. Kuvendi nxori komitetin e luftës me anëtar: Ramis Dibrën, Ramis Dacin, Elez Isufin, Duleman Çelën e Patinit (Mat), Isuf Xhelilin, Jashar Erebarën, Ismail Strazimirin, Destan Pucën, Dine Hoxhën, Riza Lushën, Osman Litën, Shaqir Demën, Dan Camin. Komandant i Përgjithshëm edhe pse u ndodh në Lashkizë të Dardhës, ndër-

kohë që mbahej kuvendi në Arras, u caktua Elez Isufi. Kuvendi miratoi një seri vendimesh si: Zgjedhjen e një komiteti luftarak; vënia e gjithë kryengritësve dhe e udhëheqësve popullor në një komandë unike; hyrja në lidhje me përfaqësuesit e Kosovës për t'i dhënë kryengritjes trajta ndërkrahinore, po kështu dhe me qarqet politike maqedonase që kërkonin mvetësinë e Maqedonisë, e gjithë puna për planizimin, organizimin dhe drejtimin e veprimeve luftarake do t'i ngarkohej komitetit luftarak.<sup>6)</sup> Komiteti lufës nxori shtabi e udhëheqësve popullor, i cili brenda 2-3 ditëve zgjidhi një seri detyrash me karakter politik, ekonomik e ushtarak si: përgatitjen e planit të veprimeve luftarake mësymse, planin e shmangies së popullsisë së paaftë për luftë nga zona e veprimeve luftarake, bëri studimin e forcave armike dhe mundësitë luftarake të tyre, etj.<sup>7)</sup> Në këtë kohë në Dibër ishin përqëndruar 10 batalione këmbësorie dhe disa bateri artilerie me hadhje të largët. Në Dibër të Poshtme operonin dy batalione serbe, në Gollobordë dy, në Bulqizë një dhe në Tërnovë-Zerqan një. Trupat serbe ishin përqëndruar në pika dominuese si në: Pasmarr, Gjorajcë, Smolonicë, Kulla e Shabës në Bulqizë. Kala të Dodës, Lisi i Nelit, Shkeka të Shumbatit, Kodra e Gështenjës (Kastriot), Kodra e Kabës, Llasen, Lisi i Trenës, Maranica, Çerenec, Okshtun, Shkalla e Borovës. Për drejtimin e veprimeve luftarake shtabi i trupave serbe e kishte ngritur vendkomandën në Llasen, një lartësi në lindje të qytetit të Peshkopisë. Forcat kryengritëse dibrane përgatiteshin për të nisur kryengritjen me rreth 3000-4000 luftëtar popullor të armatosur me pushkë turke, serbe, austriake, bullgare një pjesë me sëpata, cfurqe e këmasa për luftim ndeshës trup me trup. Kuvendi ngarkoi Shtabin luftarak, që përbëhej nga Ramis Dibra, Ramis Daci e Dulejman Çela të përgatiste planin e veprimeve luftarake mësymse të forcave kryengritëse popullore dibrane. Kryengritësit e Reç e Dardhës e Ujë e më Ujë të prirë nga Suq xhelili e Cen Elezi iu dha urdhër të sulmonin garnizonin serb në Shkeka të Shumbatit, pastaj do të vazhdonin për çlirimin e Kalasë së Dodës, ku aty pasi të bashkoheshin me forcat kryengritëse të Osman Litës e të Sheh Halimit të Reçit do të vazhdonin mësymjen drejtë Prizrenit. Nga Thanast e Xhike, nën Mustafë, Kodër Leshe e Kepi i Qytetit do të zinin vend forcat e komanduara nga Selë Bajraktari me objektiv goditjen e trupave serbe Shkeka-Lugjapravë. Në kodrën Shënediell dhe kodrën e Rame mbi urën e Muhurrit, iu dha detyrë forcave të Sinës që prireshin nga Abdi e Selim Sulë Kaloshi i Sinës. Nga Cekat e Xhike, Brakat e Marqene, barnat e Arrasit iu caktua Selman Alisë, Kurt Spatës, Dervish Lushës, Haxhi Nokës, Dik Spatës, Selim Nokës, Met Skepit. Dine Hoxha, Murat Kaloshi, Ali Tahiri, Dan Leka, Hysen Mani me forca e tyre do të sulmonin nga Molla e Hoxhe- Gajrajcë-Peshkopi -Llasen. Në boshtin kryesor Arras-Ostush-Kastriot-Peshkopi-Llaseni ishin caktuar të mësynin dhe 150 forca qeveritare dhe forcat e Elez Isufit. Në këtë drejtim do të lëvizte dhe Ramis bej Dibra, Ramis Daci, Dulejman Çela, Jashar Erebara, Ismail Strazimiri dhe Riza Lusha. Nga ana e Bulqizës forcat e Mehmet Durici dhe 200 forcat qeveritare të komanduara nga ma-

(Vijon në faqen 16)

# Kuvendi i Arrasit

## histori

## dhe kryengritja e përgjithshme kundër serbe, gusht 1920

(Vijon nga faqja 15)

Jor Shefki Shatkat do të mësynin garnizonin serb tek Kulla e Shabës. Nga Meja e Kalasë në Homesh dhe deri në kodër të Mikoreshi (Çerenec) do të zinin vend një fuqi vullnetare e Grykës së Vogël e komanduar nga vëllezërit Dine e Shaqir Dema. Nga Kodra e Mikoreshit deri në Viçisht do të vendoseshin forcat e Grykës së Madhe të komanduara nga Destan Puca i Sopotit dhe Miresh - mali i Vrabçit, mbi Urën e Spiles, kishte marrë urdhër Dan Cami me forcat e tij të sulmonte. Një sasi forcash kishin zënë vend dhe në Shkallë të Borovës e Steblevë. Më 13 gusht 1920, atë ditë që mbahej kuvendi në Arras, artileria serbe nga Lisi i Trenës nisi bombardimin e stacionit të xhandarmërisë, që ishte vendosur në shtëpinë e Hazis Manukës në Luzni,<sup>8)</sup> nën komandën e toger Jashar Zenelit nga Bllaca. Një ditë më pas, më 14 gusht 1920, shtabi luftarak i forcave kryengritëse, i dërgoi një ultimatum komandës së trupave serbe në Llasen, me të cilën i kërkonte largimin e trupave brenda 24 orëve nga tokat shqiptare.<sup>9)</sup> Edhe Plaku patriot, Elez Isufi, në një deklaratë verbale bërë nëpunësit politik serb Nikolla bënte presion se: " Në na ngucshi shumë, paska qenë thënë ne të ngelim pa shtëpi e ju pa koka "<sup>10)</sup> organizoi 1000 vullnetarë dibranë dhe priste urdhër për të sulmuar trupat serbe në Dibër të Poshtme. Qeveria e Tiranës që kërkonte një frymëmarrje të shkurtër nga fitorja e Luftës së Vlorës dhe ajo e Koplikut, i qetësonte dibranët për një kohë më të përshtatshme "qëllimi do të realizohet kur të vijë koha" <sup>11)</sup> Nga ana tjetër Qeveria e Sulejman Delvinës i kishte kërkuar disa herë Beogradit për të tërhequr trupat përtej kufirit të 1913-tës,<sup>12)</sup> por qëllimet e mbretërisë shoviniste, për realizimin e ëndrës së vjetër të Karagjergjevicve serb nuk ishte tërheqja e trupave nga viset verilindore, por përkundrazi futja në thellësi të trojeve shqiptare. Qeveria e Tiranës në kushtet aktuale vazhdonte demarshet diplomatike pranë Fuqive të Mëdha për ndalimin e masakrave në krahinat verilindore. Zyra e shtypit shqiptar në Paris shpërndante notën e delegacionit shqiptar Fuqive të Mëdha për të ndaluar agresionin serb ndaj Shqipërisë. "Megjithë sigurimet që Qeveria Shqiptare i ka dhënë gjithmonë Qeveria Jugosllave, për dëshirën e saj të zjarrtë që të jetonte në paqë me të, më 10 gusht 1920 trupat serbe invaduan befasisht territorin shqiptar në krahinat e Shkodrës, Dibrës dhe Elbasanit."<sup>13)</sup> Komanda serbe e bindur plotësisht se dibranët e pakët e të paarmatosur nuk do të kishin mundësi të sulmonin nuk iu përgjigj thirrjes. Atëherë shtabi luftarak i kryengritësve popullor sipas planit të hartuar që më parë, u dha urdhër kryengritësve për sulm. Duke gdhirë 15 gushtin i 1920 forcat kryengritëse u ishin afruar garnizoneve serbe në heshitje me grupe të vogla dhe prisnin sinjalin e sulmit. Sipas urdhërimit të shtabit luftarak sulmi do të fillonte në të gjithë Dibrën kur të ndigjonin tri të shtënat nga arma e Suf Xhelilit në Shkeka të Shumbatit. Për çudi atë ditë, 15 gusht, një shi i imët kishte nisur të binte. Elez Isufi, ky usta i luftës popullore, i mbështetur pas një lisi në Arras, me jakën e kopranës të hedhur në kokë, me fytyrë nga Shumbati, shfrynte: "Ç'po ndodh kështu?", "Pse Sufa s'po jep sinjalin e sulmit?", "Pse s'po fillon sulmin", "Dita po zbardh mirë e sulmi s'po fillon", "Po na shkon munda kot, t'hë, t'hë!"<sup>14)</sup> Elez Isufi s'iu durua më dhe drejtua Riza Lushës: "Shkrepe, or Riza Lusha! Pesë të shtënat e Riza Lushës nga Arrasi, në mëngjesin e 15 gushtit dhanë sinjalin e fillimit të kryengritjes në të gjithë Dibrën. "Në luftë!" dha urdhër Elez Isufi. Një thirrje e fuqishme oshtiu në të gjithë Dibrën: "A besa besë burra t'i kapim me dorë shkëjti!" Dhe me të vërtetë dibranët sulmuar me kaq tërbim e pasion luftime të papërmbajtur sa që brenda një ore e gjithë Dibra ishte përf-

shirë në kryengritje. Fuqia e Suf Xhelilit dhe e Cen Elezit sulmuar dhe në pak çaste e shkatërruan garnizonin serb në Shkeka të Shumbatit. Malësorët e Çidhnës të prirë nga Selman Alia, Kurt Spata, Dervish Lusha, Haxhi Noka, Dik Spata, Selim Noka, Met Skepi, me bazë nisje në Arras, pasi kaluan veshur e me shpejtësi Drinin e Zi, dolën në Ostush. Krahu i majtë i luftëtarëve që prirëshin nga Selë Bajraktarit, pasi kaluan Drinin tek Rrasa e Bollës vazhduan ecjen me luftim në drejtim të Bllaçës. Të dy krahët dolën në vijën: Shkeka të Shumbatit-Kodra e Salbatër-Ostushit. Dhe një "A besë besë" u desh që ushtria serbe të fillonte tërheqjen nga gjithë garnizonet. Sulmi i kryengritësve këtë rradhë qe tepër i fuqishëm. Në shumë vende u kalua në luftim trup me trup duke përdorur çfurqet, cakorret e sëpatat. Boshti i qëndrës, ku lëvizte Elez Isufi, Ramiz Dibra, Dulejman Çela e Riza Lusha, Jashar Erebara, pasi lanë Arrasin dolën me luftim në Ostush-Kastriot dhe u bashkuan tek varret e Deli Hasanit me forcat e krahut të djathtë që prirëshin nga Dine Hoxha, Murat Kaloshi, Abdi e Selim Sulë Kaloshi i Sinës, Dan Leka e Hysen Mani, që e kishin krehur ushtrinë serbe: Muhurr-Brezhda\_Kodër Kabe. Të dy krahët sulmuar vendkomandën serbe në Llasen, duke e detyruar të tërhiqen në drejtim të Skërdecit. Po këtë ditë dhe forcat kryengritëse të Bulqizës të komanduara nga Mehmet Duriçi dhe ato të Steblevës si dhe 200 ushtarë të ardhur nga Qeveria e Tiranës nën komandën e Shefki Shatkat sulmuar batalionet serbe në Bulqizë-Zerqan, Gollobordë dhe i detyruan të tërhiqen drejtë kufirit politik të vitit 1913. Nga krahu i majtë ku mësynin 600 dibranë të prirë nga Isuf Xhelili e Cen Elezi, Osman Lita e Sheh Halimi i Reçit pasi çliruan Klalanë e Dodës marshuan drejtë Kullës së Lumës e dolën në jug të lumit Bistra të Prizrenit. Luftimet në të gjithë vijën e frontit u zhvilluan të ashpra dhe gjatë ditës së 16 gushtit. Vlenë të përmenden dy raste tipike. Rasti i parë është ai i Osman Pacit cili u hodhë në pozicionet e serbeve dhe vrau 7 ushtarë në lufim të afër trup me trup. Rasti i dytë është ai i Rushit Sinës, i cili edhe pse ishte plagosur në dy duartë nuk largohet nga lufta, por e mbushte dhe shkruhe armën me gishtat e këmbëve. Në mbrëmjen e 16 gushtit 1920 ushtria serbe ishte tërhequr nga treva dibrane "duke braktisur gjithë vijën strategjike" pasi la katër a pesëqind të vrarë dhe 800 rob e shumë armatime, municion e materiale të tjera luftime. Sipas gazetës serbe "Radničke Novine" të 6 shtatorit 1920, ushtria serbe pati 800 të vrarë e 40 oficerë të kapur rob. Autoritetet serbe të qytetit të Dibrës së Madhe të trembur nga paniku i ushtrisë së tyre, që vazhdonte tërheqjen e shpartalluar drejtë Grykës së Radikës, u bashkuan me ta në udhëmarshim drejtë Gostivarit e Shkupit. Nga krahu i majtë ku mësynin 600 dibranë të prirë nga Isuf Xhelili pasi çliruan Klalanë e Dodës marshuan drejtë Lumës e Prizrenit. Të nesërmen, më 17 gusht 1920, shtabi luftarak dha urdhër për tërheqjen e kryengritësve në Dibër të Madhe. Po këtë ditë Elez Isufi në një deklaratë me shkrim që iu bëri autoriteteve serbe i njoftonte të ktheheshin në Dibër të Madhe. Pas kësaj deklarate autoritetet serbe, ushtarake e civile, u rikthyen në qytetin e Dibrës së Madhe. Forcat kryengritëse dibrane muarën urdhër dhe zunë pika kyce për gjatë kufirit politik të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës. Më 17 gusht në Peshkopi u ngrit zyra e Prefekturës dhe xhandarmërisë shqiptare. Autoritetet civile të prefekturës së Peshkopisë duke e vlerësuar realisht situatën, iu drejtuan Qeverisë së Tiranës për të marrë masa konkrete në rast të një kundërmësimje serbe. Megjithatë shtabi luftarak organizoi mbrojtjen e kufirit shtetëror në disa drejtime: Gollobordë-Viçisht, zonë pozicione mbrojtje trupat vullnetare të komanduara nga Dan Cami; në Çerenec Destan Puca; Shupenzë-

Mej të Kalas Dine Dema; në Bllat-Spas Dine Hoxha; në Maqellarë Ismail Strazimiri e Dine Maqellara; në Sorakol Suf Xhelili e Osman Lita; në Skërtec toger Ramis Varvarica Cen Bellova dhe Miftar Kaloshi Komanda e lartë serbe pasi bëri rigrupim trupash në afërsi të kufirit shtetëror dhe duke përfutur nga krenimi i festës fetare të Bajramit, që binte me 26 gusht 1920, filloi mësymjen e përgjithshme duke futur në luftim tre divizione këmbësorie në 90 km front: Kala e Dodës-Gramë-Skërtec-Bllatë-Viçisht-Gollobordë. Fuqitë vullnetare, e për rrjedhojë, shtabi luftarak, duke mos e vlerësuar në kohë (çështjen 5-6 ditësh) kundërmësimja serbe ishin kthyer nëpër shtëpi për të krenuar ditën e Bajramit. Pak forca kishin mbetur në Lumë, Gramë, Skërtec e Bllatë të komanduara nga Suf Xhelili, Ramis Varvarica Ismail Strazimiri, Dine Hoxha, Selim Kaloshi i Sinës dhe Osman Lita i Kalas Dodës. Por dhe këto forca nuk kishin më shumë se 10-15 fishek dhe një pjesë të pa armatosur fare. Në mëngjesin e 27 gushtit 1920 artileria serbe nisi goditjen e pozicioneve të mbrojtjes dibrane përsëritë gjithë kufirit shtetëror të vitit 1913 nga Kalaja e Dodës e deri në Gollobordë. Sapo artileria serbe ndaloi zjarren, 40 batalione këmbësorie kaluan në kundërmësimje të përgjithshme. Forcat vullnetare dibrane pasi bënë një qëndrës të jashtëzakonshme, filluan tërheqjen e organizuar në drejtim të kodrave të Qenokut. Po kështu trupat vullnetare që mbronin drejtimet: Gollobordë, Viçisht, Çerenec, Skërtec, Sorokol filluan tërheqjen me luftim duke iu dhënë mundësi pleqve, fëmijëve e grave të largoheshin përkohësisht në thellësi të krahinave fqinje e deri në Tiranë. Më 3 shtator ushtria serbe hyri në Peshkopi dhe pastaj duke mbledhur e organizuar mbeturinat Esadiste iu vërsulën Shqipërisë së Mesme. Në këtë kohë për shtetin e ri shqiptarë intervencioni serb u bë rrezik serioz. Ushtria kombëtare pasi shtypi mbeturinat esadiste në Martanesh e detyroi komandën e lartë serbe t'i tërheq ushtritë nga tërë fronti dhe t'i përçëndronte në mbrojtjen e "vijës strategjike": Qafë-Studen, Qafë-Buell, Qafë-Murrë, Lanë-Lurë. Autoritetet ushtarake serbe në vendet e pushtuara shpërthyen një terror të egër kundër popullatës së pafajshme dibrane. Fshatrat u bënë shkumb e hi. Vetëm gjatë muajit gusht 1920 ushtritë serbe kanë sulmuar, plaçkitur dhe shkatërruar në themel ose pjesërisht 153 katunde shqiptare, dogjën 6603 shtëpi, shkatërruan 113 mullinj, 101 dyqane e magazine, 50 xhami, 18 manastire; granë në mënyrë barbare 238 vetë, 39 fëmijë të therrur, pushkatun 200 të tjerë, hedhën në zjarr të gjallë 300 vetë, prej të cilëve 146 gra e 91 fëmijë. Ushtria serbe grabiti 37.072 dele, 6228 qe e lopë, 1535 kuaj e 11.052.730 kg grurë. Për barbarizmat serbe të kesaj periudhe kanë qenë të detyruar të pohojnë dhe gazetaret serbe. Kështu "Radničke Novine", më 6 tetor 1920 jepte denoncimin e një oficeri të lartë serb: "Mënjëherë ndërmorëm një sulm duke mos kursyer asnjë dhe asgjë. Robërit menjëherë i vramë, bagëtitë i rrëmbyem, fshatrat i dogjëm me rradhë dhe në shumë vende nuk kursyem as gratë dhe as fëmijët." Në këtë kryengritje u martirizuan 34 dibranë: Osman Paci -Fushë Alie, Halil Doçi-Kastrioti, Adem Hoxha-Fushë-Çidhna, Halil Shaban Gjeçi-Çidhna e Poshtme, Shazuman Fishti-Vrajt, Karaman Ismail Hoxha - Grazhdani, Halil Lusha, Shaban Doda, Dali Koka e Abaz Baloshi- Kala e Dodës; Tahir, Adem e Hasan Duriçi-Vajkali (Bulqizë); Halil Hyseni, Murat Hyseni-Reçi; Demir e Bajram Leshi -Kastrioti; Mane Noka - Grykë-Noka; Xhemil Kanxha e Vehbi Bala -Trebishti; Sherif Bali-Sohodolli, Allaman Zeneli-Kovashica, Ismail Boduri-Okshatina, Alush Bunguri-Greva, Allaman Salkurti (Rashnapojë), Rushit Spata e Ali Tota - Bllaçet, Hasan Tola - Çidhna. etj Shumë

dibranë lanë vatrën e tyre, si më 1913, dhe muarrën udhën e muhaxhillëkut. Francezi J. Godart në një monografi mbi Shqipërinë "L'Albanie en 1921" (Shqipëria më 1921) ka shkruar: "Ne donim të dëgjonim nga vetë refugjatët historinë e vuajtjeve të tyre". Më 2 maj 1921 në Tiranë pyetëm disa prej tyre. Ishin dibranë. Baftjar Kuka nga Kovashica tregon: Ditën e 5-të të Bajramit të Vogël, gusht 1920 (17 a 18) ushtarët u mblodhën në qendër të fshatit. Kryetarin Sali Lamin e vranë. Elmas Jasharin (Hoxhë) dhe djali i tij u shpuan me bajonetë. Edhe në Dovalan 60 shtëpi u shkatërruan rëndë. U vranë 22 vetë si dhe një fëmijë në djep... Ali Kora nga Kandri: "Serbët arritën para mbramjes. Ata shtinë mbi fshatarët duke vrarë 3/4 e tyre. Midis tyre kishte gra e fëmijë. Nexhip Rexhepi: "Serbët erdhën ditën e 5-të të Bajramit të Vogël "Ata vranë t'ëmën, gruan dhe vajzën 5 vjeçe. Ai pa serbët duke shpuar me bajonetë trupat e shtrira për tokë. Rabie Velia-mundi të shpëtojë me fëmijët e saj (8 e 5 vjeç). Burri dhe vëllai iu masakruan, shtëpia iu shkatërrua dhe ajo tani nuk zotëron veçse disa reka për t'u mbulluar. Rukie Mustafa - plakë që kishte si veshje kryesore një xhakëtë burri pa mangë e të grisur kishte pasur 150 krerë, midis të cilave 15 qe e 7 lopë. Qëndrimi i saj ishte krenar. Djali i saj 30 vjeç u masakrua... Vajza e djalit të saj (3 vjeç) u dogj e gjallë në shtëpi..."<sup>15)</sup> Vërtetë treva dibrane u pushtua dhe popullata po masakrohej egërsisht, shpirti kryengritës i dibranëve nuk u mposht kurrë. Pavarësisht se fitorja e arritur me forcën e armëve, në gusht të 1920, nuk u konsolidua, ajo u tregoi forcave kryengritëse dibrane se duhej të organizoheshin më mirë dhe në plan më të gjërë ndërkrahinor e deri kombëtar për mbrojtjen e trojeve të tyre. E parë në tërësi, veprimtaria e Prefekturës së Drinit, "apo "Qeverisë së Luftës", Kuvendi i krerëve të maleve dhe kryengritja e gushtit 1920, ruajnë vlera që njehohen me qeveritë, parlamentet dhe lëvizjet më të njohura të Evropës së sotme modern sepse: kryengritja e Dibrës nxiti ndjenjat atdhetare dhe të krahinave të tjera në mbrojtjen e trojeve shqiptare; së dyti për herë të parë u bë organizimi i forcave kryengritëse vullnetare dibrane dhe u vunë në një komandë unike, të një shtabi luftara; së treti kryengritësit u tërhoqën me luftim të organizuar, duke u dhënë mundësi pleqve, grave e fëmijëve të shmangeshin nga zona e veprimeve luftarake. Së fundit, Kryengritja e gushtit 1920 shënoi dukuri të shkëlqyera të udhëheqësve popullor e të forcave kryengritëse vullnetare dibrane kundra një armiku të pabarabartë në ushtarë, armatim e municion.<sup>16)</sup>

1) Ilmi Sadiku, Lufta e armatosur kundër pushtuesve serb në Dibër në muajt gusht-shtator 1920, tek Kongresi I Lushnjës dhe lufta e Vlorës, Tiranë 1974, f.254.

\*) Ilir Spata, Kangë për Riza Lushën, New York (SHBA), 8 tetor 2007.

2) Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar, (Përmbledhje dokumentesh), vëll.II, 1918-1920, Tiranë 1976, dok.nr.339, dok.nr.38, f.438-439.

3) Po aty

4) Moisi Murra, Kuvendi i Arrasit dhe kryengritja e përgjithshme antiserbe në Dibër, në gusht të 1920, shih tek Dibra dhe etnokultura e saj, Dibër, 1995, f.339.

5) Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar, vëll.II, Tiranë 1976, f.439.

6,7) Moisi Murra, Kuvendi i Arrasit dhe kryengritja e përgjithshme antiserbe në Dibër, në gusht të 1920, shih tek Dibra dhe etnokultura e saj, Dibër, 1995, f.340

8) Haki Stërmilli, vepër e cituar, f.110; Ismail Strazimiri, Lufta kundër pavarësisht të Shqipërisë...f.104.

9) Ismail Stazimiri, lufta kundër pavarësisht të Shqipërisë, Tiranë, 210, f.104; K.Frashëri, Revista "Për mbrojtjen e atdheut", nr.8, 1977, f.80.

10) H.Stërmilli, vepër e cituar, f.115

11) Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar, vëll.I, Tiranë 1976, 395.

12) Po aty, f.395

13) Po aty, 439.

14) Moisi Murra, Kuvendi i Arrasit dhe kryengritja e përgjithshme antiserbe në Dibër, në gusht të 1920, shih tek Dibra dhe etnokultura e saj, vëll.I, Dibër, 1995, f.342

15) Justin Godart, L'Albanie en 1921, Paris 1921, f.229-230.

16) Moisi Murra, Kuvendi i Arrasit dhe kryengritja e përgjithshme antiserbe në Dibër, në gusht të 1920, shih tek Dibra dhe etnokultura e saj, vëll.I, Dibër, 1995, f.346

# portret

## Hasan Ballanca, atdhetari dhe publicisti

(Vijon nga numri i kaluar)

Për të arritur në këtë kuptim të drejtë të gjendjes dhe në mbrojtjen e këtij qëndrimi sa realist aq dhe patriotik, nuk ishte e lehtë, koha kërkonte zgjidhje të tillë të marrëdhënieve dhe kontradiktave me Stambollin, në përputhje me gjendjen ndërkombëtare, pa harruar rreziket e jashtme të shumta dhe në rritje. Parë me syrin e momentit qëndrimi që mbajti mbase Lëvizja Kombëtare e Prizrenit, ishte më i drejti.

Korrespondencat që ai i dërgoi shtypit, si kjo që u përmend më sipër, flasin për aftësitë, qartësitë dhe mprehtësitë e tij politike, ashtu dhe ndikimin e tij të vogël që ai gëzonte jo vetën në vendlindjen e vet e rrethinat e saj, por sidomos në ata që kanë më tepër rëndësi, në trevat përreth. Pikëpamjet e mendimet e veta të përparuar e të peshuara mirë, me durim e urtësi, ai i përhapte në masat popullore. Hasan Ballanca, ishte korrespondent i gazetës "Drita" të Manastirit, njëri i penës, njëri i veprimeve konkrete. Ai ka lënë një trashëgomi publicistike mjaft të pasur e me vlera njohtëse e dokumentuese për ngjarjet e zhvillimit të tyre në Shqipëri, Kosovë e Dibër në prag të pavarësisë dhe në vitet e para e pas fitores së saj.

Me sa dimë shkrimet e tij nuk janë mbledhë e përcaktua të gjithë, sepse, përveç me pseudonimin "MIROSH DIBRA", në shtypin e kohës, ai ka botuar edhe shkrime të tjera pa emër autori, me iniciale ose dhe pseudonime të tjera ende të panjohura. Me vlerë janë korrespondencat e tij për ngjarjet në Dibër, në Kosovë të viteve 1911-1912. Po veçojmë ndonjë prej tyre marrë nga gazeta "Drita" e Manastirit. "Janar 1912, qeveria osmane dërgoi në Dibër të Madhe Hamit Beun për të mbledhur popullin e për të vendosur se me cilin alfabet do të shkruhej shqipja"... Kur filloi pra bisedimi, Shaqir Beu i Jegonollit muar fjalën dhe tha: "Në Dibër, nuk është kush, që do shkollë shqipe edhe në pastë ndonjë, me shkronja arabisht i do... Këtë ia preu fjalën Haxhi Ibrahim Doçi, i cili it ha të deleguarit se ata pleqtë që ndodheshin në mbledhje nuk përfaqësojnë dëshirat dhe vullnetin e vërtetë të Dibrës. Fjalën e tij të zjarrtë e mbylli duke thënë: "Edhe gurët e varrit kur të vdes do t'ja lë me porosi, të më shkruhen me shkronja tona kombëtare." Gazeta "Drita" e Manastirit, 26.1.1912.

Një tjetër tha në mbledhje, se një që shkruan me shkronja shqipe, ai është kaurr tradhëtar, ka dale fejet dhe e ka dënuar zoti...

Në lidhje me këto ngjarje, Hasan Ballanca, në Gazetën "Drita" të Manastirit, datë 13.03.1912 botoi artikullin "Çdrejtësia" (Pa drejtësi) nuk ka qëndrim dhe jete të gjatë, ku demaskoi, stigmatizoi fuqishëm parësinë e Dibrës duke e quajtur të pa karakter, fanatike, që kurrë nuk ka punuar për të mirën e popullit por që ka tërhequr gjithmonë nga vetja dhe në dem të interesave kombëtare. Hasan Ballanca, kur shkoi të bashkohet me çetën e Mahmut Zajmit, i shkruan një mikut të tij "...Trupi im do të ngjyhet me ngjyrë të kuqe e të bëhem dëshmor i Skënderbeut. (Gazeta "Liria e Shqipërisë" datë 27.04.1912). Ai kështu u bë. Ai ra dëshmor. Qeveria osmane nuk e kishte harruar kundërshtarin dhe armikun e tij të vjetër. Ate e ndjek dhe e kap në qytetin e Stambollit dhe duke e torturuar e vrasin në mënyrë barbare në një moshe fare të re. Hasan Ballanca u bashkua me Mustafa Zajmin e Pejës në Kosovë, të cilin e kishte shok dhe mik të afërt. Në këtë kohë ai u bën thirrje dhe u drejtohet të gjithë shoqërive atdhetare brenda dhe jashtë trojeve shqiptare dhe të gjithë patriotëve shqiptarë që të japin ndihmën e tyre me të gjithë format me arme në dorë, se ka ardhur koha më e përshtatshme dhe ja sot, ja kurrë për të fituar të drejtat tona Kombëtare. Kjo thirrje firmoset nga krerët e kryengritjes së Kosovës, Mahmut Zajmi, Bajram Daklaram e të tjerë. Këtë thirrje e nënshkruan edhe Hasan Ballanca me cilësinë e tij si sekretar i kryengritjes dhe përfaqësues i përfaqësues së Dibrës. Thirrja botohet në gazetën "Liria e Shqipërisë", me 9 maj 1912. Kjo gazetë që në muajin mars 1912 kishte lajmëruar nga Prishtina se atë ditë do të bashkohej me çeta e Pejës edhe një atdhetar tjetër, njëri i ditur edhe me virtyte të larta, por sot, vazhdonte korrespondenti i gazetës në fjalë - "mundet të ja përmendim emrin. Ky atdhetar ishte pikërisht Hasan Ballanca. (Artikulli "Ç'po korr qeveria xhonturke nga veprimet e saja") Gazeta "Liria e Shqipërisë" nr. 38 datë 10.04.1912.

*Drita prej Shkupës (katund në Grykë të Vogël) të Dibrës.*

### Gjendja e sotme e Malësisë

Me qeneje si e cila dukje dftoi mendimi i përgjithshëm i Malësisë dhe me qenë që mendimi i çfarëdo gjeje që ipët nëpër Malësi e po përpiket dhe përfundet dhe dukjes së kësaj anë, që ban që dy tre prej tre Malësitë e po përpiket dhe përfundet dhe dukjes së kësaj ane, që ban që dy tre prej tre Malësitë e qytetit të Dibrës së Madhe që emërohen "Gryka e Madhe", "Gryka e Vogël" dhe Bulqiza. Luftën që filloi Italia, duke shkelur gjithë miqësitë e nomet morën evropiane, bënë një përshtypje të madhe shumë në zemrat e sejcilit shqiptari Malësori. Kjo përshtypje i vu te deftojnë ndjenjat fisnike e dashurinë e zjarrtë që mban sejcili për Atdheun Otoman, i vu të tregojnë se janë më besnikë të gjithë racave që bashkojnë Perandorinë Otomane më mbajtjen e një metingu në Fushë të Gjoricës prej 1450 vëdash të maleve, u betuan se do të derdhim pikën e fundit të gjakut edhe për shperblimin e një guri të Atdheut. Mbasi lidhën besën se janë gati për të shkuar të gjithë malësorët në luftën që ngjau dhe kudo që të ngjajë si vetëdashës. (vullnetar Xh.R.) çuan në një qëndrim të përgjithshëm katër pleq tek mysafiri si mëkëmbës (përfaqësues) të gjithë malësisë, Osman Kaja, ASLLAN Zejneli, Selman Kurtin dhe Jakup Canin (Sofraçanin) që e bani metingu i madhi malësorvet, si malësorët e Malësisë së Dibrës janë gati të vënë vëtdashës.

Nuk mund të vishen ushtar derisa tu përgjigjet qeveria kerkimeve qe ka Malësia si ata që janë të veshur në sherbim ushtarak, si dhe ata që do të grishën mbas ca ditësh. Gjer sat ë merren vesh mirë e mirë ashpërsimet dhe kërkimet që shfaqen mes popullit dhe qeverisë, të mos shtërngohen asnjëra anë të shkojnë pa udhë, nuk e marrin ndër sy gjendjen e hollësishtme e saj të sotme. Lulet Malësia që qveria të mos e shohë për të keq këto fjalë dhe sjelljen kësij soj e malësorvet, sepse nuk kamë t'i kundërshtohen qeverisë, por ti sherbejnë Atdheut si më besnikët e Perandotrisë Osmane duke u refuzuar më të drejtat e tyre. Njer sat ë mbahet lufta dhe njer sa të paqetohet mbrëteria me shtetet kufitare. Malësia jep besën se do të qëndrojë heshtjen besnikët e nuk do të çelet çështjet e kërkimeve që ka me qeverinë.

Këto fjalë ju thanë me gojë prej pleqve zangojë sipër mytesarifit dhe u ndanë në përgjigjen qe u dha mytesarifit do t'i përgjigjet qeveria zyrtarisht mbasi të mërret vesh me Valiun e Manastirit, e i këshilloi që të përpiqen sat ë mundën ti bindin ata që kërkohen sot në sherbim ushtarak. Ja si është gjinia (gjendja Xh.R.) e Malësisë Dibrës sot. Mbas pak diësh do të mirrë vesh vesh kujtoj përgjigje që do të jap qeveria dhe do t'ju shkruajme sit ë jete.

Mbas një lajmi që morëm sot prej Dibre, u lajmëroj se për të mbushur taborret që mbeten të metë (mangut Xh.R.) nga most ë ardhurat e Malësorve, u grishën dhe redifet me lindje te viteve 1884-1885 te qytetit të Dibrës. (Redif-Rekurt). Kjo na bën të marrim vesh se qëndrimet (vendimet) e metingjeve te malësorvet që ju dhanë qeverisë u vrunën me rëndësi dhe kërkimet e tyre nuk do të shifen e nuk do të përfundosen me lodhje të gjakshme sikur ngjarjet e dhunët e para të Shqipërisë.

*Vjeshhtë e Dytë 1911 H.B. Hasan Ballanca. Gazeta "Drita" nr. 38 datë 9.X.1911. Nga muzeu historik i Peshkopisë.*

Si njohtës i gjuhës shqipe dhe turke, Hasan Ballanca, e ndihmonte mjaft çetën, duke i shkruar momerandume, protesta e të tjera qeverisë së Stambollit e përfaqësive diplomatike të huaja në vilajetin shqiptar dhe duke mbajtur korrespondencë me të gjithë atdhetarët, të mali e të fushës, për bashkërendimin e veprimeve në kryengritjen e përgjithshme shqiptare, të udhëhequr nga Isa Boletini, Bajram Curri, Hasan Prishtina e tjerë, ku një rol të rëndësishëm luajti edhe çeta e Mahmut Zajmit të Pejës.

Hasan Prishtina ishte ndër intelektualët e parë të kohës që e kuptoi, se Froni kryesor i luftës edhe për këtë element ishte tashmë ndër male, pranë luftërave të pushkës. Lufta për shkrimin shqip dhe për shkollat shqipe, kishte dalë në plan të dytë.

Lufta nëpër shoqëritë patriotike, ia kishte lëshuar vendin luftës me armë. Kjo do të zgjidhte jo vetën detyrat politike kryesore që qëndronin para Lëvizjes sonë Kombëtare, por edhe detyrat e karakterit kulturor e arsimor. Hasan Ballanca shpjegonte se kishte ardhur koha që të gjitha organizmat e Lëvizjes Kombëtare si komitetet klubet, shoqëritë duheshin vënë tërësisht, pa asnjë rezeve, në sherbim të organizimit, zhvillimit dhe të përfundimit me sukses të kryengritjes së përgjithshme antiosmane që po përçatitej. Vepra e Hasan Ballancës në këtë kohë ishte vlerësuar edhe nga patriot të shquar që kanë qenë artitektë të pavarësisë si Lëk Gruda (Luigj Gurakuqi), i cili e vlerësonte Hasanin trim të rreptë në artikullin e tij, "Kryengritja në Gëgëri" e botuar në Gazetën "Liria e Shqipërisë" datë 19 qershor 1912.

Hasan Ballanca bashkëpunonte me një nga çetat më të para që filluan luftën në Kosovë kundër regjimit xhonturk në vitin 1912. Kjo çetë dha sinjalin e parë të fillimit të kryengritjes së përgjithshme antiosmane. Ajo sulmoi në Gjakovë forcat qeveritare që shoqëronin Ministrin e Puneve të Brendshme të Perandorisë Osmane, Haxhi Adil Beun. Gjatë misionit të tij për të studiuar kinse mundësinë e zbatimit "veprave" në Shqipëri. (Gazeta "Liria e Shqipërisë" nr. 35 dhe 40 datë 16.03 dhe 27. 04.1912.)

Çeta e Pejës ku bënte pjesë Hasan Ballanca zhvilloi përpjekje të ashpër në Istog kundër dy batalioneve osman që vinin nga Mitrovica e pazari i ri (Novipazari). Petritët Shqiptar shkruante shtypi i kohës luftuan aq rreptë me ushtarët turq, më një trimëri që vetëm në historinë e Skënderbeut e gjejmë. (Gazeta "Liria e Shqipërisë" nr.42 datë

20.05.1912.)

Këta luftëtar të Pejës u erdhën në ndihmë forcat e komanduara nga Sadik Rama i Gjergjevikut. Kjo çetë mori pjesë së bashku me forcat tjera kryengritëse në sulmin e organizuar mbi Gjakovë. Çeta e Pejës me Hasan Ballancën e filluan shumë herët luftën kundër forcave xhonturke në kundërshtim me interesat e parashikimet e Beogradit. Komandanti i Çetës së Pejës, sapo doli malit me armë në dorë u beri thirrje, siç e dëshmon shtypi i kohës, njerëzve të shkolluar, që dinin mirë shqip e turqisht, ta ndihmonin, të lidhesh me qarqet e gjera atdhetare, brenda dhe jashtë vendit si dhe për formullimin e shpalljes së synimeve kombëtare të luftës së kryengritëse. (Gazeta "Liria e Shqipërisë" nr. 38 datë 10.04.1912.)

Një ndër të parët e ndër të rrallët që iu përgjigjen kësaj thirrje që Hasan Ballanca. Kryengritëseve Shqiptarë u duhej të përballonin presionet, shantazhet, propagandat e të gjitha makinacionet e provokimet e agjenturave te huaja xhonturke, imperialiste e shoviniste serbe e greke që punonin për të penguar e sabotuar Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, për të shtrembëruar e shkatërruar karakterin kombëtar të luftës së armatosur të popullit shqiptar. Propagandat e huaja ushtronin presion të plotë mbi udhëheqësit e armatosur të Kosovës me synim që këto të hiqnin dorë nga përpjekjet e tyre për sigurimin e autonomisë administrative të Shqipërisë. Realizimi i kësaj kërkesë të shqiptarëve përbehte një pengesë të madhe për synimet e qarqeve shoviniste të Beogradit, Athinës e Cetinës.

Përballë presioneve të tilla kryengritësit e ndienin më tepër nevojën e një bashkëpunimi të ngushtë të qarqeve të gjera politike brenda dhe jashtë vendit, në radhë të parë me intelektualët. Këtë domosdoshmëri e shprehte thënia e mësipërme. Parë me këtë sy kuptohet edhe më mirë rëndësia e bashkimit të intelektualëve atdhetarë si Hasan Ballanca me kryengritësit shqiptar.

Hasan Ballanca i veshi opingat dhe doli malit i gatshëm, siç shkruante një i afërt i tij, para se të bashkohej me çetën, "për të dhënë jetën për lirinë e Atdheut". Vajtja në një nga çetat më të para e më luftarake të Kosovës u ndie menjëherë në qëndrimin e kryengritëseve që në kërkesën e parë të tyre. Në fillim të muajit prill kryengritësit e Pejës i dërguan një ultimatum qeverisë osmane dhe i paraqisnin disa kërkesa. Nja nder këto kërkesa, sipas shtypit të kohës ishte hapja e shkollave shqipe

në Shqipëri me shkronja kombëtare. Nëpunësit të jenë të gjithë shqiptarë në Shqipëri dhe shërbimi ushtarak shqiptarët ta kryenin Brenda kufijve të Shqipërisë. Këto kërkesa kishin karakter kombëtar dhe kjo bëri që disa atdhetarë si Hasan Ballanca të bashkoheshin me luftëtarët e lirisë.

Kërkesat vetëm për autonomi nuk ishin të plota për Shqipërinë. Shqiptarët duhet të pretendonin e të luftonin për më shumë, për çlirim të plotë kombëtar e shoqëror. Forcat kryengritëse në këtë periudhë vepronin vetëm në pjesën verilindore të vendit dhe në Kosovë. Ende nuk kishte shpërthyer kryengritja e përgjithshme. Kryengritësit Kosovarë ishin të gatshëm dhe kërkonin autonomi të plotë dhe vetëqeverisje. (Hasan Ballanca. Gazeta "Liria e Shqipërisë" Nr. 4, datë 27.04.1912.) Beogradi me të gjitha format e metodat më armiqësore përpiquej të pengonte zhvillimin e kryengritjes. Agjuntura serbe bënte përpjekje më të mëdha për të bërë të mundur të dështonte kryengritja, por kryengritësit ishin të vendosur.

Gjithashtu ata ishin të vendosur edhe për kërkesat e tyre që parashtronin për zgjidhje. Këto kërkesa do t'i mbronin me veprime luftarake deri në jetën e tyre. Serbët kishin vënë të gjithë mjetet, ata përdornin të gjitha format e metodat për të komprometuar drejtuesit dhe udhëheqësit kryesor në kryengritje dhe paritë e vendit.

Ata përdornin paranë, terrorin dhe të gjitha format e komprometimit. Hasan Ballanca në këtë periudhë ka meritat e veta për kontributin patriotik dhe atdhetar që ka dhënë në dobi të kombit dhe të Atdheut. Ky duke i bërë jehonë luftës së kryengritëseve shqiptarë i shkruante gazetës "Drita" të Manastirit nga Kosova, se një komb sa do i vogël qoftë, nuk mund tu nënshtrohet shtypësve të tij, sa do të mëdhenj qofshin këto. Edhe në qoftë se pushtohet me fuqi ushtarake e më ashpërsi të tepërt, kjo nuk do të jetë e gjatë. )Gazeta "Drita" Nr.66 datë 03. Maj.1912.

Hasan Ballanca përderisa ishte përfshirë në kryengritjen e armatosur, ai ndiqte me vigjilencë depërtimin e propagandës dhe demagogjisë të qarqeve shoviniste të shteteve fqinjë. Hasani tërhiqte vëmendjen e gjendjes së krijuar në Shqipërinë e Veriut, në kufirin e Malit të Zi. Rreziku që paraqiste kjo gjendje do të dukej konkretisht pas pak kohë, kur shpërtheu lufta e Parë Ballkanike.

Hasani për këtë qëllim ndërmori një udhëtim nëpër Shqipëri dhe konkretisht në Shqipërinë e Veriut. Ai ishte i indinjuar për gjendjen e krijuar dhe ai po shikonte që Shqipëria po kalonte nga zgjedha shumë shekullore e osmanllinjve e po binte në kurthet demagogjike e shoviniste të shteteve fqinjë.

Hasan Ballanca dhe Sali Hidri i dërguan një letër atë ditë Ismail Qemalit dhe demaskonin veprimet e Xhon Turqve që bënin përpjekje për të shuar kryengritjen në Shqipëri. Hasan Ballanca shkruante në atë kohë artikuj gazetareskë me pseudonimin Mirosh Dibra dhe demaskonte veprimet shoviniste të fqinjëve. Ai shprehte shqetësimet ndaj tyre si dhe për luftën e armatosur që bëri populli shqiptar. (Mirosh Dibra. "Gjendja e Shqipërisë së Epërme". Gazeta "Drita" Manastir datë 3. 05.1912.)

Me zgjerimin e luftës së armatosur të popullit Shqiptar (Popullit tonë) po ndihej më shume se kurrë nevoja e një qendre të vetme politike, organizative dhe ushtarake, e cila të drejtonte këtë luftë, të siguronte dhe ndihma ekonomike e financiare në radhë të parë në armë e municione dhe çka kishte me tepër rëndësi, t'i bënte të njohur opinionit publik evropian luftën e drejtë të popullit tonë, synimet kombëtare të kësaj lufte.

Me këto synime udhëheqësit e luftës së armatosur në Kosovë, të ndërgjegjshëm se për realizimin e programit kombëtar kërkohej bashkimi e mobilizimi i mbarë popullit shqiptar në të katër anët e vendit u drejtohej një thirrje të gjithë shoqërive, komiteteve dhe patriotëve brenda dhe jashtë atdheut, ku i ftonin të bashkëpunonin me një komitet të vetëm, për të luftuar sëbashku deri sa të arrinin qëllimin e shenjtë "Lirinë administrative të Shqipërisë." Këtë thirrje e kanë nënshkruar përveç krerëve të kryengritjes edhe Hasan Ballanca si përfaqësues i Malësisë së Dibrës dhe Sali Hidri (Hoxha) nga Elbasani me cilësinë e sekretarit të përgjithshëm të krerëve të kryengritjes së Kosovës. (Gazeta "Liria e Shqipërisë" Sofje Bullgari datë 09.05.1912.) Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912 përgatitur nga Stefanaq Pollo e Selami Pulaha Tiranë 1978, faqe 236-237.

(Vijon numrin e ardhshëm)  
Përgatiti: Xhelal ROÇI

**Sheh Mustafa i Zerqanit, që me veprën dhe bëmat e tij, kundër pushtuesve osmanë, mbeti krenaria e Zerqanit, Grykës së Madhe, Dibrës dhe gjithë Shqipërisë. Por edhe pse një figurë me përmasa kombëtare, ai është lënë me të padrejtë në hije, pasi Lufta e Drinit të Zi më 1844, që ai e udhëhoqi me aq trimëri e zgjuarsi, duke shpalosur vlerat e një strategu të vërtetë ushtarak, fare pak është trajtuar nga historiografia jonë.**

# Sheh Mustafë Zerqani

## udhëheqës, organizator dhe heroi i vërtetë që bashkoi Nëntë Malet e Dibrës në Luftën e Drinit të Zi më 1844

Nga: HYSAN LIKDISHA, DESTAN RAMA

Pakkujt nga pashallarët turq të Perandorisë Osmane, për të mos thënë askujt, do t'i kishte rënë ndërmend, që pas afro 400 viteve nga vdekja e Skënderbeut, do ndeshesh me një stërnip të tij, i cili bashkoi Nëntë Malet e Dibrës, në një betejë të përgjakshme, në përmasa të atyre të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Kjo ka qenë beteja e njohur në historiografinë tonë, si Lufta e Drinit të Zi më 1844, ku organizatori, udhëheqësi dhe heroi i vërtetë i saj, ishte Sheh Mustafë Zerqani.

### JETA DHE SHKOLLIMI

Sheh Mustafë Zerqani, u lind në Teqenë e Zerqanit më 1799. Ishte djali më i madh i Hysenit. U rrit në një familje të madhe me shumë hyrje e dalje, në një mjedis plot tradita fetare e atdhetare. Mësimet e para i mori në vendlindje në mejtepin turk, të cilin e filloi më 1808 dhe e mbaroi më 1812. Në moshën 13 vjeçare i ati e dërgoi në Teqenë e Haxhi Osmanit në Peshkopi, ku vijoi mësimet fetare. Aty ai u shqua për vullnet e këmbëngulje ku u dallua jo vetëm si nxënës i shkëlqyer në mësimet, por spkati edhe si një fëmijë me prirje të rralla dhe tejet inteligjent për moshën që kishte. Për këtë drejtuesi i mësimet në Teqenë e Haxhi Osmanit, njoftoi prindërit se djali i tyre jashtë çdo parashikimi kishte përfunduar shkëlqyeshëm mësimet dhe veç kësaj ishte paisur edhe me cilësi mistike të sektit mysliman Kadri. Në vitin 1815, Mustafai shkoi në Dibër të Madhe, për të vijuar më tej mësimet në turqisht dhe arabisht. Atje pati rastin që të bjerë në kontakt dhe të njihet me një grup shokësh të zgjuar dhe atdhetarë. Në vitin 1818, kur dhe ishte jo më shumë se 19 vjeç, Mustafai shkoi për studime të larta për teologji në Stamboll, të cilat i përfundoi me rezultate të shkëlqyera. Dhe si një rast i veçantë më 1820-1829, bëhet myhyb në Teqenë Kadrie të Stambollit, për tu veshur "Sheh" në 1830, duke marrë kështu rrugën e vërtetë islamike aleviane, për të spikatur në fuqinë e tij mistike fetare.

### KTHIMI NË ATDHE

I veshur me rrobën fetare, Sheh Mustafë Zerqani, kthehet në vendlindjen e tij Zerqanit që aq shumë e donte, në vitin 1831. Kthimi në vendlindje përkoi me përpjekjet e Portës së Lartë për tu hequr malësorëve liritë dhe të drejtat që gëzonin prej kohësh në kuadër e autonomisë lokale. Ky veprim i Portës së Lartë e preku thellësisht zemrën djaloshare të tij. Ndaj krahas vprimitarive fetare, Sheh Mustafa, u vu në mbështetje të bashkëfshatarëve të tij të Zerqanit, Grykës së Madhe dhe gjithë Dibrës. Teqeja Kadrie e Zerqanit, nën drejtimin e Sheh Mustafës, padyshim që u kthye në një vend pelegrinazhi, jo vetëm për besimtarët alvetie, por edhe për gjithë patriotët e Grykës së Madhe dhe trevave përreth. I paisur me një kulturë të gjërë dhe ndjenja të fuqishme atdhetare, ai shumë shpejt fitoi respektin, dashurinë dhe autoritetin e padiskutueshëm jo vetëm në zonën e Grykës së Madhe, por edhe më gjërë gjithë trevën e Dibrës. Madje i shtriu lidhjet deri në krahinën e Matit, Martaneshit, Shëngjergjit, Elbasanit, Strugës, Dibër e Poshtme e më tej. Objektivi i tij ishte dhe mbeti tejet i qartë; të krijonte një rezistencë të hekurt kundër zbatimit të Reformës së Tanzimatit, e cila synonte shtypjen e drejtpërdrejtë dhe të egër të shqiptarëve nga ana e sundimtarëve osmanë, si dhe sigurimin e pagesës së taksave dhe mbledhjen e rekrutëve nga të gjitha krahinat. Ishte koha kur Porta e Lartë, kishte hasur vështirësi në zbatimin e Reformës së Tanzimatit, sidomos në rajonin e



Dibrës. Koha kishte sjellë si domosdoshmëri organizimin e krahinave në kryengritje të armatosur, për të mos i dhënë taksa e nizamë serasqerëve osmanllinj. Me shkollimin dhe intelektin e nivelit të lartë që zotëronte, këtë moment historik, më mirë se kushdo në krahinën e Dibrës, e rroku Sheh Mustafë Zerqani, i cili u vu në krye të Nëntë Maleve të Dibrës, për bashkimin e tyre në luftën e Drinit të Zi kundër Hajredin Pashës më 1844.

### LUFTA E DRINIT TË ZI 1844

Pas vrasjes së Rexhep Pashës, Divani i Lartë e kuptoi mirëfillit se për të bërë "zap" Dibërën, duheshin forca të mëdha. Për ndërmarrjen e këtij misioni, u rugua i gatshëm Hajredin Pasha, vëllai i Rexhep Pashës. Kjo edhe për faktin se atij i kishte mbetur "daltë në zemër", vrasja e të vëllait në trevën e Dibrës, në përpjekje për të mbledhur taksa e nizamë. Pasi mori aprovimin e Portës së Lartë, Hajredin Pasha, në pranverën e vitit 1844, erdhi nëpër Grykë të Radikës me shtatë taborre (shtatë mijë nizamë), gjë të cilën e thotë edhe kënga; "Hajredin Pasha po vjen Radikës...". Duke ditur historinë e Dibrës, ku i vëllai kishte lënë kokën, në përpjekje për ta nënshtuar, ai kërkoi forca ushtarake shtesë. Kështu brënda pak ditëve, erdhën në Dibër nga Manastiri edhe pesë taborre shtesë, në ndihmë të tij. Gjithë fusha e Sheherit (Dibrës së Madhe) u nxi nga çadrat. Sipas burimeve bibliografike "Dibra në vitet 1840-1845, dorëshkrim shkruar nga Munir Shehu, faqe 20, mësohet se krerët e Nëntë Maleve të Dibrës; Reçi, Dardha, Çidhna, Muhurri, Luznia, në Dibër të Poshtme dhe Gryka e Vogël, Gryka e Madhe, Bulqiza, Selishta në Dibër të Epërme, sapo kishin marrë lajmin se Hajredin Pasha në krye të një ushtrie të madhe po përgatitej për të sulmuar Dibërën, nën drejtimin e Sheh Mustafë Zerqanit, u mbledhën në kuvend tek "Guri i Shpuar në fushën e Dibrës së Madhe. Kuvendi veç të tjerave vendosi që të dergoheshin delegacione edhe në të gjitha krahinat e tjera të vendit, për të kërkuar ndihmë për të përballuar taborret e madha me ushtarë që Hajredin Pasha kishte nisur drejt Dibrës. Fjala e Sheh Mustafës e mbajtur në këtë kuvend, me krerët e nëntë Maleve të Dibrës, si dhe në të gjithë kuvendet e tjera, ishte thirrje që bëhej për ti bërë ballë pushtuesit, nën moton: "O burra t'i biem dushmanit". Fjala e tij ishte një zë që mobilizonte, të rrënoqhte, që të jepte fuqi për të sulmuar e fituar mbi pushtuesin edhe pse ai ishte shumë herë më i madh në numër e paisje luftarake. Nën udhëheqjen e Sheh Mustafë

Zerqanit, i cili me kryengritësit e Grykës së Madhe dhe Grykës së Vogël ishte vendosur në anën e majtë të Drinit të Zi, nisën luftime të ashpra me forcat osmane të Hajredin Pashës të vendosura në të djathtë të Drinit, të cilat në mësymje për të kaluar lumin për të sulmuar kryengritësit dibranë pësuan humbje të mëdha, ku mjaft ushtarë u mbytën në lumë. Hajredin Pasha duke parë qendresën e kryengritësve që nën drejtimin e Sheh Mustafës e Cen Lekës po përballonin burrërisht ushtrinë e madhe të tij, vendos për një sulm të shpejtë drejt Gjoricës, që të mos u linte kohë për tu grumbulluar kryengritësve dibranë të nisur për të ardhur në Gjoricë në ndihmë të Sheh Mustafës. Pashai turkoshak i trembej luftës me kryengritësit dibranë dhe për këtë gjë ai vuri në funksion për mposhtjen e tyre të gjitha llojet e dredhive (Shih Dibra në vitet 1840-1845, Munir Shehu dorëshkrim faqe 24). Kështu për përçarjen e krerëve të Dibrës, ai vuri në përdorim edhe blerjen e tyre me anë të të hollave, që i dërgonte Stambollit. Pas qendresës heroike disamujore, gushti i 1844, që muaj mjaft i rëndë por dhe i zyrtë për dibranët e veçanërisht për banorët e Grykës së Madhe dhe Grykës së Vogël. Kjo pasi Lufta e Drinit të Zi, nëpërmjet terrorit dhe blerjes me florinj, nga Hajredin Pasha, të ndonjërit prej krerëve udhëheqës të kryengritësve, si dhe ardhja e ndihmave të tjera në ushtarë për serasqerin turk nga Veziri i Shkodrës dhe Haxhi Pasha i Matit, e vështirësuan shumë dhe e vunë në pikpyetje fitimin e kësaj lufte. Sheh Mustafa si strateg lufte që ishte, diti me zgjuarsi, trimëri dhe mençuri ta zgjidhte situatën. Ai kishte besim të plotë tek mbështetja e popullit, i cili ishte ishte aleati i përhershëm dhe më besnik i tij. Të gjithë banorët e fshatrave pranë bregut të Drinit, përfshirë edhe gra dhe fëmijë ishin armatosur, me qëllim se në rast se turqit do të hynin në ndonjë fshat për të plaçkitur, djegur e vrarë, ata tu venin pushkën. Kështu sapo një nga krerët udhëheqës të krahinave, nën efektin e "verdshkave" të dushmanit dorëzohej tek Sulltani, shumë të tjerë ngriheshin në mbështetje të kryengritësve të kësaj beteje. Mjaft prekëse dhe emocionuese janë fjalët e udhëheqësit trim dhe të besës të Grykës së Vogël, Cen Leka, të përjetësuar në këngë; Hajredin Pasha tej mor hajvan/ Se s' shjetet Cena, pash mor me alltan./ se s'e thej besën ç'i kom dhanë/. (Për këto rreshta shih edhe tek "Fyelli i Dibrës" të Haki Stërmillit, faqe 74-75). Duke e parë veten në vështirësi, Hajredin Pasha, kishte vendosur për një sulm të shpejtë në Gjoricë, në mënyrë që të mos u jepte kohë forcave kryengritëse të grumbullohen. Por kryengritësit morën masa për ta mbrojtur Gjoricën. Në qendër të kësaj mbrojtjeje në Çerenec përballë Kojnarës, aty ku dhe ishin përqendruar forcat turke, ishte vendosur Sheh Mustafë Zerqani me kryengritësit e Grykës së Madhe dhe Grykës së Vogël. Në këtë përplasje me osmanllinjët, shkëlqeu qendresa dhe heroizmi i pashoqi i kryengritësve, ku për disa prej tyre është përjetësuar edhe në këngë: Kush janë n'ato gropa? / Cen Bajrami e Ahmet Loka./ Or Ahmet, ku e ke Canë?/ Fejtafejt me ni nizamë! / Kush asht ai n'ato llogore? / Rizvan Alla me sakorre/ I ka ba nizet e katër vorre/ Kush ia shpoi fesin pashës? / Fasli Malja qaku(plaku) i Krajkës/. Mustafa Shehu, ishte në këtë luftë, kreu i parë, udhëheqësi kryesor i të gjithë kryengritësve dibranë, organizatori i sprovarit të tyre, jo vetëm në këtë betejë, por në të gjitha kryengritjet e dibranëve pas vitit 1831. (Shih "Dibra në vitet 1840-1845" dorëshkrim nga Munir Shehu dhe "Histori e Shqipërisë" vëllimi i dytë, f. 59, Tiranë 1965). Këta tituj edhe pse të padeklaruar dhe të pathënë, Sheh Mustafë Zerqani i meritonte plotësisht, pasi treva e Dibrës dhe më gjërë kështu

e njohu atë. Ai nuk jepte urdhëra, por atë pyetnin të gjithë, për të gjitha çështjet dhe nevojat kryesore të luftës, deri të shpërndarja e arkave të pakta me fishekë e tek furnizimet me ushqime. – Fol or Sheh, ku e kemi vendin ne për të luftuar, or Sheh? etj. Dhe fjalës së tij i bindeshin të gjithë, sepse ai ishte më i respektuari. Ndaj në Luftën e Drinit të Zi 1844, Sheh Mustafë Zerqani, kishte ngarkesën dhe detyrat e një komandanti të përgjithshëm, për të cilën ka nevojë të domosdoshme lufta, e megjithatë, ai në asnjë rast nuk i bënte dallim vetes nga luftëtarët e tjerë. Por njësoj si ata futej dhe luftonte në vendet më të vështira e të rrezikshme duke u bërë kështu shembull e burim frymëzimi për kryengritësit, gjë që është përjetësuar edhe në këngë: "Sheh Mustafa me atin e zi/ Shembi Malet e i lëshoi në Dri/ nënqind vorret kush i bani/ Dibër e Male e Sheh Zerqani/. Të dy vëllezërit, Mustafë e Mehmet Shehu, luftonin përkrah njëri-tjetrit në këtë betejë. Pas luftimeve të përgjakshme, kur dhe u mbaruan fishekët, të dy vëllezërit nxorën shpatat duke i vringëlluar majtas e djathtas ku kositen turq sa mundën. Duke luftuar heroikisht aty në ballë të luftës, në arat e Çerenecit, karshi Dibrës së Madhe, ata pikasën Hajredin Pashën, i cili përpigjej të fuste në luftë disa ushtarë të tij që kishin frikë nga vdekja. Përnjëherë të dy vëllezërit morën grysh drejt tij, por u dualën përpara mbi tridhjetë turq dhe i rrethuan. Kështu ata ranë rob në duar të tyre. Hajredin Pasha dha urdhër që të mos vriten, porsa e mori vesh se kush ishin. Ai menjëherë përgatiti kalorësit përcjellës për të dërguar në Stamboll, komandantin e kryengritësve dibranë të Luftës së Drinit të Zi. Pavarësisht se në Çerenec dhe Gjoricë, asqerët e Hajredin Pashës ishin përgjysmuar, ai mendonte se Porta e Lartë do të gëzohet me zënien rob të Sheh Mustafës, gjë që atij do t'i shtonte rëndësinë pranë Divanit të Lartë.

### NË VEND TË MBYLLJES

Sulltani dëshironte ta bënte vetë gjyqin e Sheh Mustafës, i cili kishte luftuar gjithmonë kundër turqve, duke u bërë shkak që tu vriteshin gjitha ata ushtarë, gjë për të cilën thuhet se u bë shkak edhe për dënimin me varje të Hajredin Pashës nga Sulltani. Dibranët dhe shqiptarët e tjerë që banonin në Stamboll shkonin shpesh për ta parë Sheh Mustafën, në shenjë respekti për çfarë ai kishte bërë që Shqipëria dhe shqiptarët të çliroheshin nga turqit. Kur e morën vesh se ai do të dalë në gjyq para Sulltanit, i dërguan në burgun Podrum-Kalase një kostum të ri fetar, një çallmë dhe tespi, me shpresë se kjo lloj paraqitje do sillte mëshirë në dënimin e tij me vdekje. –Si? i qenke fetar, qenke sheh? –Por atëherë pse dole kundër fesë së islamit? –S'pate turp për kijafetin (çallmën) e Pejgamerit që mban mbi kokë? – Pse luftove kundër halifit të tij? – Mustafë Shehu iu përgjigj arabisht me një verset të nxjerrë nga Kurani: - In-nel vatane, min-nel iman (nuk ka fe pa atdhe). Sulltani u kap mat me këtë shprehje dhe e nxorri menjëherë jashtë me zemërim duke e dërguar në burg, ku më pas e internuan në Konje dhe Brusë ku dhe vdiq më 1849, pas një helmi që i hodhën në gjellë. .... Ky ishte Sheh Mustafa i Zerqanit, që me veprën dhe bëmat e tij, kundër pushtuesve osmanë, mbeti krenaria e Zerqanit, Grykës së Madhe, Dibrës dhe gjithë Shqipërisë. Por edhe pse një figurë me përmasa kombëtare, ai është lënë me të padrejtë në hije, pasi Lufta e Drinit të Zi më 1844, që ai e udhëhoqi me aq trimëri e zgjuarsi, duke shpalosur vlerat e një strategu të vërtetë ushtarak, fare pak është trajtuar nga historiografia jonë. Një paragraf kushtuar kësaj lufte në librin "Histori e Shqipërisë", volume i dytë f. 59, Tiranë 1965 dhe një nderim nga ish Kuvendi Popullor me "Urdhërin e Klazit të Parë", janë fare pak për këtë figurë komplekse atdhetare të shumpërmendur, por pak të njohur, që më shumë se një misionar i fesë mbeti një shqipëridashës i madh. Le të shpresojmë se rasti ifestimit në këtë vit, i 100 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, të shërbejë edhe për ngritjen në panteonin e lirisë edhe të kësaj figure ashtu siç dhe e meriton.

# histori

Nga ALI HOXHA

Çidhna është një ndër nëntë krahinat malore të Dibrës, të cilat në gojën e popullit dibran, sipas traditës, të paktën që nga periudha e Rilindjes, janë emërtuar, Nëntë malet e Dibrës.

Kur flasim për Dibrën, kemi parasysh atë trevë që shtrihet në rrjedhën e sipërme të Drinit të Zi, e cila ka si kufij natyrorë: vargmalin e Jabllanicës, Kaptinën e Martaneshit, malet e Dejës, Nezhden e Lurës, lumin Malla, lumin e Veleshicës, Vargmalin e Deshatit dhe vargmalin e Stegovës.<sup>1)</sup> Sipas traditës gojore popullore, hasur kjo edhe në dokumentet arkivore mesjetare.<sup>2)</sup> Dibra na del e ndarë në dy pjesë: Dibra e sipërme dhe Dibra e Poshtme. Në të parën përfshihen fshatrat e zonës fushore rreth qytetit të sotëm të Dibrës së Epër, si dhe gjithë zona malore që nga shpati ku ndahen ujërat e lumit Vardar me ato të degëve të Drinit të Zi, duke përfshirë këtu Rekën e Epër, Rekën e Poshtë, Zhupën, Drimkollin deri në zonën fushore të Debërçës së Strugës, si dhe Gollobordën.<sup>3)</sup> Pjesa tjetër veriore duke filluar nga kodrat e Qenokut, në anën e djathtë të Drinit dhe të Gurra e Mazhicës, në anën e tij të majtë, përbën Dibrën e Poshtme. Pikërisht në qendër të Dibrës së Poshtme, aty ku derdhet Seta në Dri, në të dy anët e Drinit të Zi shtrihet treva e Çidhnës, e cila përfshin një territor të tillë që nga fshatrat Çidhën e Sinë, përfshirë këtu dhe bjeshkët e Pllajut e të Xharxhishtit, në anën e majtë të Drinit dhe deri në fshatrat Kastriot e Rrenzë, përfshirë dhe bjeshkën e Gramës buzë Korabit, në anën lindore të Drinit.

Në luftërat heroike të popullit tonë për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë, të tokës e të kulturës nga vërshimet e pushtuesve të të gjithë kohrave kanë marrë pjesë me armë në dorë banorët e të gjithë krahinave shqiptare duke treguar heroizma të rralla. Për vetë pozitën e saj gjeografike, si vend i rëndësishëm strategjik në sistemin mbrojtës të Shqipërisë, Dibra gjatë gjithë shekujve ka luajtur një rol shumë të madh në luftërat e popullit shqiptar për liri e pavarësi, por në mënyrë të veçantë në shek. XV, për vetë faktin se në Çidhën (Sinë) të Dibrës është origjina, janë trojet dhe djepi i Kastriotëve (pronat e të cilëve shtriheshin prej Shufadaje në jug të Lezhës e prej Rodonit në bregdet deri në Prizren, duke përfshirë këtu edhe krahinën e Rekës në verilindje të Dibrës<sup>4)</sup>), pra dhe i vet Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.<sup>5)</sup> ajo, pa dyshim, ka mbajtur peshën më të madhe të luftërave kundër pushtuesve osmanë.

Në kryengritjen e Gjon Kastriotit kundër pushtuesve osmanë në vitin 1430, e cila që shkëndija që ndezi zjarrin e luftës së shqiptarëve për liri dhe që nuk u shua asnjë herë gjatë gjithë shek.XV, morën pjesë gjerësisht masat e gjera të fshatarësisë Dibër-Rekë<sup>6)</sup>. Popullsia e krahinës së Dibrës, ashtu si në të kaluarën, që përkrahu pa asnjë rezervë Gjon Kastriotin, edhe më pas përkrahu Gjergjin, të birin e tij, në luftën epokale që sapo filloi kundër sundimit osman.

Pikërisht, duke qenë i sigurtë në një përkrahje të tillë, kur ushtritë hungareze dhe të koalicionit thyen ushtritë turke në afërsi të Nishit, më 3 Nëntor 1443, Skënderbeu, i ndjekur nga 300 kalorës dibranë, braktisi frontin dhe "me shpejtësinë më të madhe arriti të shtatën ditë në Dibër . . . Ky është një vend . . . i përmendur fort ndër epirotët për burrat shumë trima që nxjerr. Veç kësaj, atë vend e njihte dhe e donte shumë Skënderbeu për besnikëritë dhe trimëritë e shumta dhe të shënuara që banorët kishin treguar për hir të mbretërisë së t'et, Gjonit, kur atij i binte në qafë otomani"<sup>7)</sup>. Prandaj "pothuaj e gjithë rinia (e Dibrës-A.H.) sikur të mos kujdesej për gjë tjetër, i kish rëmbyer armët dhe po i shkonte pas (Skënderbeut-A.H.) duke e quajtur shpëtimtar të lirisë"<sup>8)</sup> do të shkruante Barleti k "Historia e Skënderbeut".

Dibra, si krahinë lindore, zinte një vend të rëndësishëm në sistemin mbrojtës të Skënder-

# Rezistenca e Çidhnës dhe Dibrës në masakrën e vitit 1466

beut, sepse në të shtriheshin fushat kryesore të betejave nga pritej të vinin sulmet osmane drejt kryeqendrës së shtetit shqiptar-Krujës. Prandaj "ndër njëzet e ca beteja të tërbuara osmane të përballuar nga Skënderbeu në krye të popullit që luftonte për liri, shumica e tyre janë zhvilluar në territorin midis Dibrës, Tetovës dhe Ohrit. Të gjitha betjeat e zhvilluara në këtë truall, ku çdo pëllëmbë toke është ujitur me gjak, kanë përfunduar me fitore të bujshme për ushtritë e udhëhequra nga Gjergj Kastrioti"<sup>9)</sup>. E midis tyre, vend nderi të veçantë zë Beteja e Torviollit, beteja e parë e Skënderbeut kundër osmanëve, e cila u bë më 29 qershor 1444, jo rastësisht në Fushë-Çidhën, pikërisht aty ku, që nga ajo kohë dhe sot e kësaj dite, quhet Ferra e Pashës<sup>10)</sup>. Ai vend u quajt ashtu nga që ushtria turke e Ali Pashës mbeti ferrave, e pavarrosur, duke u thyer për herë të parë edhe miti i "pathyeshmërisë" së ushtrisë turke të asaj kohe. Disfatat që pësuan turqit në territorin e Dibrës si: në Torvjoll, në fushën e Otonetës, në Modricë, në Pollog, Li-vad, Oranik<sup>11)</sup>, në fushën e Meçadit, në grykën e Mokrës<sup>12)</sup>, më Vajkal dy herë etj., ishte shkak që turqit osmanë nuk mundën të përparonin as drejt perëndimit, as drejt veriut, por qëndronin të gozhdur në rajonet lindore plot "me shtigje të fshehta dhe gryka hyrjeje dhe daljeje të vështira"<sup>13)</sup>, siç thonë kronistët osmanë.

Në vitin 1453 Skënderbeu, i ndodhur në Dibër, kur mësoi lajmin për ardhjen e armikut "atëherë me shpejtësinë më të madhe mbloodhi aty më se 7000 njerëz"<sup>14)</sup>. Kjo u arrit sepse, siç shkruante Barleti, popullsia vendase "qëndronte gjithmonë në një gatishmëri të atillë, që s'prinin veçse shenjën e kryetrimt. Përveç kësaj, një numër i madh i banorëve të tjerë të krahinës, sidomos i fshatarëve, ishte i detyruar si prej një zakoni të caktuar të vendit që t'i shkonte prapa pa ndonjë shpërblim"<sup>15)</sup>. Gjithashtu edhe në kohën kur Skënderbeu përgatitej për çlirimin e Beratit, përsëri mbloodhi ushtarë në këtë krahinë. "Kastrioti vazhdonte të ndodhej akoma në Dibër për shkak të ushtrisë që kish filluar të mblidhte . . . Pasi mbaroi dhe gatiti gjithçka mirë e bukur, u nis me tërë ushtrinë për në Krujë<sup>16)</sup>. Mbas fitores në fushën e Ujit të Bardhë në vitin 1457 Skënderbeu e la menjëherë Krujën dhe shkoi me shpejtësinë më të madhe në Dibër. Atje pasi mbloodhi ushtrinë dhe pasi përtëriu forcat brenda një kohe fare të shkurtër, po priste me padurim armikun, pastaj "mori vendim që të shtonte përsëri ushtrinë . . . dhe forcat ushtarake u rritën dhe u shtuan me një shpejtësi për t'u admiruar"<sup>17)</sup>. "Ushtria kufitare që sipas rastit arrinte në 3-5 mijë luftëtarë dhe që komandohej nga Moisi Golemi, përbëhej kryesisht nga vendas (dibranë-A.H.), që njihnin çdo shteg e grykë të këtyre maleve".<sup>18)</sup>

Disa nga kapëdanët më besnikë të Skënderbeut si Moisi Golemi, Pal Kuka, Zaharia Gropa, Pal Maneshi, Vladan Gjorica etj., të cilët dihet se ishin dibranë, tregon faktin se besnikëria e tyre nuk ishte krejt e rastit.

Pra, si pasojë e një roli kaq të madh që luante kjo krahinë në veçanti dhe mbarë Dibra në përgjithësi si bazë furnizimi dhe rezervë e pashtershme e Skënderbeut në forca njerëzore dhe materiale për ushtrinë si dhe për besnikërinë e papërkrahur të dibranëve ndaj Skënderbeut, Dibra, i tërhoqi vëmendjen pushtuesit dhe u bë objekt nr.1 pas Krujës, sa që vetë Sulltani e mori në shënjestër këtë krahinë. Këtu duhen kërkuar shkaqet dhe motivet kryesore që e shtynë sulltanin jo vetëm të ndërmerre, por edhe ta drejtonte vetë personalisht ekspeditën e vitit 1466 e të bënte masakrën çnjerëzore në qytezën e Çidhnës, ku populli i saj, ashtu si gjithmonë, tregoi një rezistencë heroike. Ndaj gjatë gjithë periudhës 500-vjeçare të luftës së popullit shqiptar kundër Perandorisë Osmane, për meritat e tyre të veçanta në luftë për liri,

vetëm Krujës dhe Çidhnës preferuan t'u bënin "vizitat" e tyre sulltanët e Turqisë.

\* \* \*

Jemi në periudhën kur sulltan Mehmeti II dështoi në rrethimin e tretë të Krujës në verën e vitit 1466. Kronistët osmanë si Oruxhi, Anonimët, Ashik Pashazadeja, Bihishti dhe Neshriu informojnë shumë shkurt për zhvillimin e kësaj fushate të sulltan Mehmeti II. Bashkëkohësi i ngjarjeve, Tursun beu dhe pas tij Ibn Kemali dhe Idrisi Bitlisi përshkruajnë luftimet e zhvilluara në brendësi të vendit ndërmjet shqiptarëve dhe turqëve, pa përmendur asnjëherë rrethimin e Krujës dhe humbjet e ushtrisë osmane përpara mureve të kështjellës së saj<sup>19)</sup>. Sipas tyre, ashtu siç dëshmojnë edhe burimet arkivore perëndimore<sup>20)</sup>, sulltan Mehmeti II bashkë me të gjithë forcat ushtarake të Perandorisë prej 150.000 vetësh,<sup>21)</sup> hyri në Shqipëri në muajin maj të vitit 1466 dhe arriti të rrethojë qytetin e Krujës, i cili u bëri ballë me heroizëm të patreguar ushtrive osmane. Në këto rrethana Skënderbeu dhe popullsia që kishte braktisur qendrat e banuara (fshatrat), ishin strehuar në vendet malore ku nuk mund të depëronte armiku, dhe në të njëjtën kohë me sulme të herëpashërshme kundër ushtrive turke, i vinin në ndihmë nga jashtë qytetit të rrethuar të Krujës<sup>22)</sup>. I diskredituar me gjithë ushtrinë e tij përpara mureve të kështjellës së Krujës, pasi dogji e masakroi fshatrat e Krujës rreth e qark kalasë dhe pasi ndërtoi edhe kalanë e Elbasanit për t'i siguruar një pikëmbështetje të sigurtë ushtrisë turke prej 80.000 vetësh që la në kampin e Krujës, nën komandën e Ballaban Pashës për të vazhduar rrethimin, me shpresë, deri sa ta detyronte garnizonin e Krujës që të detyrohej të dorëzohej nga uria, me qëllim që të hakmerrej për disfatën e turpshme që i shkaktuan shqiptarët para mureve të Krujës, si edhe për të shprehur mllëfin e tij kundër Skënderbeut, vetë Sulltan Mehmeti II në gusht të atij viti (1466) gjatë rrugës së tërheqjes për në Stamboll, bëri një kthim të tillë nga Elbasani në Dibër, madje në Dibër të Poshtme, në Çidhën, dhe rrethoi e pushtoi qytezën e Çidhnës, duke masakruar barabarisht rreth 10.000 gra, fëmijë e pleq të larguar nga krahinat fushore e të strehuar aty.<sup>23)</sup>

Për mënyrën se si arriti sulltani ta pushtonte qytetin e Çidhnës dokumentacioni mungon. Lidhur me mënyrën e pushtimit mund të supozojmë se Skënderbeu, vet personalisht, i zënë me luftime për mbrojtjen e Krujës, si dhe duke pasë parasysh pozitën gjeografike të Çidhnës, e cila për nga natyra ka pozitë strategjike shumë të mbrojtur, pasi kjo është një kala natyrore, ai pa dyshim, mbrojtjen e saj do t'ia ketë besuar një garnizoni shumë të vogël luftëtarësh, pasi shumica e luftëtarëve dibranë duhet të ketë qenë, si zakonisht, përkrah Skënderbeut në ndihmë të Krujës. Kështu që ky garnizon i vogël do të ketë qenë i pafuqishëm për të mbrojtur qytezën e Çidhnës dhe krahinën nga hordhitë turke prej më se 70 mijë vetësh, në krye të të cilave ishte vetë sulltani. Veç kësaj nuk përjashtohet edhe mundësia e tradhëtisë nga brenda.<sup>24)</sup>

Sulltani masakrën e bëri në Çidhën dhe në mbarë Dibrën, sepse, Dibra, së pari, ishte baza kryesore e furnizimit me luftëtarë që i vinin në ndihmë vazhdimisht Skënderbetu në Krujë e gjekhtë dhe që përbënin repartet më besnike të ushtrisë së tij; së dyti, e bëri masakrën në Çidhën, sepse pikërisht në këtë vend ushtria e sulltanit që kthyer e tëra në kërmë në betejën e 29 qershorit 1444, që në histori ka hyrë me emrin Beteja e Torviollit, dhe së treti, sulltani e bëri masakrën pikërisht në Çidhën, me qëllim që të hakmerrej drejtpërdrejt mbi Skënderbeun, të zhdukte nga faja e dheut trojet e gjakun e Kastriotit, pasi aty, veç të tjerash, kishte njerëz

nga gjaku i Skënderbeut<sup>25)</sup>, gjë të cilën na e vërteton prania e Dimitër Kastriotit në Sinë, i përmendur në Defterin Emëror të Dibrës të marsit 1467.<sup>26)</sup>

Ushtritë osmane sa herë që në ekspeditat e tyre pësonin disfatë prej Skënderbeut përpara mureve të Krujës ose në beteja të tjera kudo gjekhtë, në pamundësi për t'u hakmarrë ndaj luftëtarëve, gjatë tërheqjes së tyre digjin pro-dhimet bujqësore duke u vënë zjarrin fushave dhe fshatrave, si dhe vrisnin e masakronin gra, fëmijë dhe pleq të pambrojtur që hasnin rrugës. Por masakër si ajo e Çidhnës e gushtit 1466 për nga organizimi, në krye të së cilës që vetë sulltani, Mehmeti II, si dhe për nga shkalla e urrejtjes me të cilën u krye, nuk është dëgjuar të jetë bërë në asnjë vend tjetër të Shqipërisë gjatë gjithë periudhës 500 vjeçare të luftërave të popullit shqiptar për liri e pavarësi kundër pushtuesve osmanë. Edhe kronistët osmanë, megjithë urrejtjen që kanë për shqiptarët, kur flisnin për zhvillimin e luftimeve, janë të detyruar të pohojnë trimërinë e shqiptarëve: "Ata zunë shtigjet e maleve dhe të luginave të rrezikshme, ku kishin kullat e tyre dhe bënë ç'ishte e mundur për të rezistuar dhe për të kundërshtuar. Nga që ishin tepër të këqinj, ata rezistuan me kokëfortësi dhe tërbim të madh"<sup>27)</sup>. Duke folur për betejën e viteve 1466-1467 një tjetër kronist turk, Ibn Kemal pohon: "Çdo kryengritës prej atyre të panështruarve ishte si një sundimtar në vehte në çdo majë mali. Nga kokëfortësia e tepruar e kishin për turp t'i nënshtroheshin qoftë edhe një sundimtar. Ata, si tigrat kthetëfortë dhe luftarakë luftonin edhe me retë që kalonin sipër tyre. Edhe luftëtari më i dobët i tyre është nga më trimat e fushës së luftës, tamam sikur të ishte kalorës i hipur në kalin legjendar. Ai nuk ka as kalë, as edhe mjete lufte, por ka në vend të kuajve shtiza që flakërojnë si vetëtima, maja e të cilave është plot helm si thumbi i grerëzave, ka edhe një hark prej druri bashkë me disa shigjeta, por, megjithatë, ai është më i fortë se hekuri".<sup>28)</sup> (vijon numrin e ardhshëm)

## REFERENCAT

- M. Trepça-A.Hoxha, Vështrim historiko-gjuhësor mbi toponimet e trevës së Dibrës, në "Studime filologjike" nr.3, Tiranë, 1982, fq.171;
- A.Hoxha, "Defteri emëror i vilajetit të Dibrës i vitit 1467 dhe disa mendime rreth vlerës së tij historike", në Dibër dhe dibranët", Peshkopi 1981, fq.58-73 dhe "Mbi lokalizimin e fushës së betejës së Torvjollit" në "Studime Historike", Nr.3, 1979, fq.230-232;
- S. Alliu-H.Sadiku;
- "Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke e shek.XV", Tiranë 1967, fq.22;
- Kristo Frashëri, "Nga ishin Kastriotët, ku lindi Skënderbeu", në "Mësuesi", Tiranë, më 1974, nr.35 dhe 36. H. Ndreu "Toponimia në ndihmë të Kastriotëve, në "Mësuesi", Tiranë 1975, nr.15. A.Hoxha, "Mbi lokalizimin e fushës së betejës së Torvjollit, në "Studime Historike", Tiranë, 1979, nr.3, fq.234-235;
- Th. Murzaku, Lufta e banorëve të tokave lindore dhe verilindore shqiptare kundër përfaqësuesve turq në fund të shek. XIX dhe gjatë shek.XV, në Konferenca e dytë e Studime Albanologjike, Tiranë, 1969, fq.197;
- M. Barleti, Historia e Skënderbeut, Tiranë, 1967, fq.69;
- M. Barleti, Po aty, fq.65;
- Th. Murzaku, vep. e cit., fq.199;
- A. Hoxha, "Mbi lokalizimin e fushës së Betejës së Torvjollit" në "Studime Historike", 1979, nr.3, fq.229-236;
- S. Alliu, H. Sadiku, "Mbi lokalizimin e disa betejave të Skënderbeut" kumtesë, në "Dibra dhe dibranët", Peshkopi, 1981, fq.47-48;
- S. Aliu-H. Sadiku, po aty, fq.45-47;
- Tursun beu, fq.154 (cituar sipas Th.Muzakut);
- M. Barleti, po aty, fq.301;
- M. Barleti, po aty, fq.302;
- M. Barleti, po aty, fq.313;
- M. Barleti, po aty, fq.382;
- Th. Murzaku, vep. e cit. fq.199-200;
- Tursun beu Tarih-i eb-ul feth, në Tarih-i al-osman-i mecmuasi, 1914-1916, numrat 26-38, fq.133-135; Ibn Kemal, Tevarih-ial-i osman def't VIII, Ankara 1957, fq.274-279 (cituar sipas S.Pulahas);
- J. Radenic, Gjuraqj Kastrioti Skënderbeu i Arbanija u XV veku, Beograd 1942, dok. nr. 320, 321, 325, 332 (cituar sipas S.Pulahas);
- Gjergj Kastrioti dhe lufta shqiptaro-turke e shek.XV, Tiranë 1967, fq.83;
- Po aty, fq.83. 23) Po aty, fq.86; 24) Po aty, fq.86;
- A. Hoxha, "Mbi lokalizimin e fushës së betejës së Torvjollit" në "Studime Historike", Tiranë 1979, nr.3, fq.235;
- "Suret-i defteri esami vilayet Dibra ve . . . 871 hixhri" (Defteri emëror i vilajetit të Dibrës, Dylgohericës . . . (mars 1467, fq.66);
- Ibn Kemal, vep. e cit. def't.VII, fq.278;
- Tursun beu, vep. e cit. fq.133;
- 32/a) Ibn Kemal, vep. e cit., def't.VII, fq.274-275 (Marrë nga Burime Osmane, Tiranë 1968, fq.192);

# Pasioni pedagogjik dhe vlerat e shoqërisë

Nga BASHKIM LAMI

Të shkruash për jetën dhe veprën e një njeriu shembull të një treve, është përgjegjësi e madhe, pasi duhen kapur shumë detaje të veprimtarisë së shtrirë në kohë të ndryshme dhe duhen thënë gjërat me realizëm, por besoj se me këto pak rrjeshta, tregohet imazhi i njeriut drejtues pedagogjik, që punoi fort, përvleratpozitive të shoqërisë.

Në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, jeta ishte tepër e vështirë kudo në Shqipëri, por në fisin "Dervishi" të fshatit Krajë, krahas urtësisë e besimit të tyre fetar, ata mendonin mirë, që për të shkalluar varfërinë, u duheshin më shumë dije shkollare për fëmijët. I vendosur për këtë ishte edhe Rizai që kishte 6 fëmijë, që djalit e tij të parë, Myfitin, e më pas edhe të tjerët, i futi në rrugën e shkollimit.

Myfit Dervishi, ka lindur më 9 tetor 1938, në fshatin Krajë, të rrethit Dibër. Filloi punën në arsim për herë të parë si mësues, në vitin 1952, i përzgjedhur nga nxënësit që mbaronin 7-vjeçaren me rezultate të larta. Po në këtë vit u kualifikua me rezultate të larta në një kurs tremujor. E nisi mësuesinë në Steblevë të Klenjës, pastaj në fshatin Strikçan të Zerqanit, në Katund të Ri e në Tomin, deri në vitin shkollor 1956-1957. Gjatë këtyre viteve, krahas punës, mbaroi shkollën e mesme pedagogjike në Peshkopi. Në shtator 1957 e emërojnë zv/drejtor i shkollës 8-vjeçare në qytetin e Peshkopisë, për lëndën Gjuhë Shqipe në ciklin e lartë të kësaj shkolle. Nështator 1961 shkon në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës, në degën Gjuhë-Letërsi-Histori, që e përfundon me rezultate të larta. Myfiti arriti të njohë me baza shkencore e metodike lëndën e gjuhës shqipe dhe të historisë, sipas degës që studioi. Ai ishte i vëmendshëm dhe i ndjeshëm në marrëdhëniet me njerëzit, kishte besim në bashkëbisedim, mendohej thellë për atë që duhej bërë, vraponte pas rolit pozitiv, ku përpara se të fliste si drejtues mendonte si t'a ndihmonte tjetrin, duke përdorur gjithnjë metoda të ndryshme, që e bënë të ishte pandërprerë afër punës dhe afër njerëzve. Në gusht 1963 e emërojnë drejtor të shkollës 8-vjeçare në Bulqizë. Pas një viti pune, e dërguan në Shkollën e Bashkuar Ushtarake në Tiranë, për oficer rezervist në degën e kimisë.

Në vitin 1965 kthehet përsëri në arsim, drejtor në shkollën 8-vjeçare në Bulqizë, ku mësonin 1480 nxënës dhe punonin 62 mësues. Në vitin shkollor 1967-1968 u hap shkolla e mesme pa shkëputje nga puna, në fillim gjimnaz dhe një vit më pas, u kthye në shkollë profesionale me degët minerale, gjeologjike dhe elektro-mekanike. Kjo shkollë do të shërbente për ngritjen e nivelit arsimor të punëtorëve, që punonin kryesisht në ndërmarrjen e nxjerrjes së kromit dhe atë gjeologjike të Bulqizës dhe në këtë shkollë u diplomuan me qindra



Myfit Dervishi

specialistë e kuadro të Rajonit të Bulqizës. Koha shtronte detyra të rëndësishme për arsimin 8-vjeçar dhe për arsimin e mesëm. Në vitin 1970 u hap shkolla e mesme e ditës me degën miniera, për të rinjtë e të rejtat e këtij qyteti, duke shërbyer si themel edhe për të ardhmen e arsimit në këtë qytet.

Si drejtor shkolle dhe si mësues, Myfiti vazhdimisht miqësohej me mësues e nxënës, pasi parimisht ai nxiste ambicinet, aftësitë dhe imagjinatën, që i çonin mësuesit në besimin e plotë për të arritur objektivat. Ai të ngjallte optimizëm dhe të shkëputte si me magji nga idea e të pamundurës. Punonte pa zhurmë duke shprehur energji të mëdha diturie për jetën e profesionin dhe i mbronte me dinjitet pikëpamjet e tij humane dhe profesionale, duke menduar e vlerësuar vazhdimisht me sinjeritet e dashamirësi çdo të mirë e të bukur, që afron puna dhe jeta në situata nga më absurdet, kur të paaftët krekoseshin për të nxjerrë "zërin e gjellit", por nuk e nxirrnin dot.

Myfiti ishte kërkues metodist në punë, i dashur dhe njohës i shkëlqyer i anës pedagogjike e psikologjike të problemeve që lidheshin me nxënësit. Në saj të punës intensive kualifikuese dhe organizuese u arrit që shkolla e Bulqizës të bëhet një qendër e rëndësishme kualifikimi për të gjithë mësuesit e zonës Bulqizë e Zerqan.

Në vitin 1975 deri në vitin 1980 e emërojnë drejtor në shkollën 8-vjeçare të Fushë Bulqizës. Aty punoi në mënyrë të palodhur, për hapjen e shkollës së mesme bujqësore pa shkëputje nga puna, në vitin 1976, për kooperativistët dhe specialistët e kooperativës bujqësore të Fushë-Bulqizës. Në vitin shkollor 1980 e caktojnë përsëri, drejtor i shkollës 8-vjeçare të qytetit Bulqizë, ku vazhdoi punën pa e ndërprerë, deri në tetor të vitit 1994 kur mbushi moshën për pension. Ai për 32 vjet kreu me shumë profesionalizëm detyrën e drejtorit në disa shkolla dhe puna e tij u skalit në mendjet e shumë mësuesve e nxënësve pasi gjithmonë ishte shembull për plotësimin e objektivave.

Myfiti ishte një shembull i veçantë në organizimin e gjithë veprimtarisë edukative-mësimore

në shkollë, duke qenë ndihmues, kërkues e zbatues serioz i detyrave, duke ruajtur gjithnjë marrëdhënie shumë të mira me mësuesit e nxënësit. Myfiti ka ditur me mjeshtëri të mbjellë pasionin e dëshirën për punë, duke qenë gjithnjë i dashur me komunitetin, me mësuesit e me nxënësit. Pasionin e tij, për arritje më të larta, e rrezatonte natyrshëm në çdo ambient, në çdo aktivitet e ballafaqim, duke qenë vetë një metodist model. Në bisedë me Myfitin zgjoheshin kujtime të vrya të dashurisë për mësuesit e nxënësit, që sot janë të shpërndarë kudo brënda e jashtë Atdeut. Ai kujton me respekt mësuesit e tij, por edhe kolegët që e ndoqën me hapa të sigurtë, në rritjen e tyre profesionale, duke kapërcyer vështirësitë e kohës, kur procesi mësimor dhunohej rregullisht me urdhërat nga

ku siç thotë vetë Ai, nuk u pajtua asnjëherë me braktisjen e fëmijëve nga njëri prind, për asnjë lloj arsësie, pasi zemra e mësuesit nuk mund t'a pranonte keqedukimin e fëmijëve. Punoi shumë për ruajtjen e unitetit në familje, për 10 vjet, si drejtues shoqëror dhe këshilltar në qytetin e Bulqizës, ku kishte pasuri kromi, por varfëria dhe jeta sociale ishin mjaft të rënda. Edukimi në shoqëri, e familje dhe sidomos i brezit të ri në shkollë, ishin prioritetet të përditëshme për Myfitin, pasi ishte i bindur se pa këto arritje nuk mund të arrihet demokracia në shoqërisë.

Drejtoi për 32 vjet me sukses në shkollat e Bulqizës bashkë me mësuesit dhe arritën të krijojnë kushte të favorshme për nxënësit, me "larmi situatash pedagogjike", duke u dhënë atyre alternativa të



lart, për mësuesit e nxënësit, për punë të tjera në bujqësi e minierë me aksione, pra mësimi bëhej i dorës së dytë. Myfiti përveç punës drejtuese në shkollë, gjendej i gatshëm për të punuar për zgjidhjen e problemeve familjare të qytetarëve,

kulturës e veprimt në përputhje me dëshirat e aftësitë e tyre personale, ku shkollat u bënë vatër e madhe e "demokracisë së vogël". Drejtues e mësues të tillë si Myfit Dervishi meritojnë vlerësim, respekt e dashuri njerëzore, pasi janë

pjesa më aktive që kanë investuar moralisht e fizikisht për një shoqëri demokratike. Për punë të palodhur në drejtim të ngritjes të nivelit cilësor në procesin mësimor edukativ si mësues dhe drejtor shkolle, është dekoruar me medaljen "Naim Frashëri" në vitin 1982 dhe ka marrë disa herë vlerësime nga institucionet e Bulqizës. Me rastin e 7 marsit 2011, Këshilli Bashkiak i Bulqizës, e ka shpallur "Qytetar Nderi", duke vlerësuar punën e tij të paharruar për arsimin në këtë qytet.

Edhe Sofia, bashkëshortja e Myfitit, e ndoqi në çdo hap edhe si kolege, duke rrezatuar gjithmonë kulturë familjare e profesionale. Rritën me dashuri e përkushtim katër fëmijë. Mirën që u bë mjeke, Ildën që trashëgoi profesionin e mësuesisë së prindërve, Rolandën e Kelin që mbaruan inxhinierinë dhe të gjithë tashmë punojnë në Tiranë, duke qenë shembulltë të mirëslljes dhe përkushtimit në punë ashtu, si dhe prindët e tyre. Myfiti tani pensionist banon në Tiranë dhe ndihet familjarisht i lumtur, me plot nipër e mbesa dhe krenar për vitet e rinisë, sekudo ku ka punuar, mësuesit, nxënësit dhe komuniteti e kujtojnë si drejtor shembullor, i pa lodhur për mësimin dhe edukimin e brezit të ri. Në çdo qytet, fshat e shkollë ku punoi z. Myfit Dervishi, ka paraqitur aftësi profesionale të nivelit të lartë, duke punuar me dëshirë e pasion, arriti të udhëheqë kolektivat e mësuesve, drejt arritjesh mësimore-pedagogjike me synime të qarta dhe baza të forta shkencore, duke u bërë kështu shembull në fushën e arsimit, për mësuesit e rinj, në trevën e Dibrës.

Me këtë rast Myfitit e Sofies ju urojmë jetë të gjatë e shëndet bashkë me gjithë familjarët, miqtë e shokët kudo që punojnë e jetojnë!

## Dy libra që vruullojnë mesazhe jete

Kur përfundova së lexuari dy librat më të fundit "Dasma e Mirës" dhe "Hej oficer" të shkrimtarit Mehmet Dume mu duk sikur ecja llogoreve, blerimeve, udhëve me plot mbresa jete. Sigurisht që ajo që më tërhoqi ishte të shkruarit thjeshtë e bukur, mesazhet mbresëlënëse, gjurmët dhe madhështia e njerëzve të thjeshtë, dashuria dhe nderimi i autorit për njerëzit, shokët, jetën dhe traditat e vrya popullore. Mehmet Dume ish skënderbegas dhe akademist mbi njëzet vjet shërbeu në detyrën e komisarit të brigadës nëpër rrethet e ndryshme të atdeut. Ai krahas llogoreve të blerta të atdeut nuk harroi as vendlindjen. Librat dhe shkrimet e Mehmet Dumes janë "bukë" me vlera të çmuara sepse janë pasqyrë e shpirtit të brezave, të njerëzve të thjeshtë. Redaktori i të dy librave studiuesi i talentuar dibranë Shaqir Skarra në të dy librat ka bërë recënca koncize, të argumentuara, në të cilat shpërfaqëshin vlerat ideologjike të dy librave të fundit. Mehmet Dume shkruan me shpirt, me zemër, pra gdhend copëza jete, personazhe, ngjarje me plot emocion. Librin "Dasma e Mirës" e ka amanet nga nëna e shtrenjtë që nuk jeton më. "Cilido që do të lexojë këtë libër, shkruan studiuesi Shaqir Skarra do ta ketë të pamundur që të mos evidentojë dhe të most e mbetet në mendje dasma

karakteristike e Shqipërisë së Jugut, e cila është pasqyruar me vërtetësi dhe me dashuri, me detaje sa çdo njeri do ta ndjente veten në këtë dasëm gjatë leximit të librit" Autori Mehmet Dume futet thellë në jetën njerëzore ndaj gjithçka në formë të duket e thjeshtë, është shumë domethënëse, të lë plot mbresa në kujtesën lexuesit. Mira një Kozetë e Viktor Hygoit tek romani të "Mjerët". Jetimja e vuajtur, e djegur për prindërit e saj dhe e përkushtuara nga jeta tinzare dhe e egër kur të bën që të vuash. Por Mira që trajtohet në këtë libër ndryshon, është disi ndryshe dhe e veçantë për jetën e saj dhe disi ndryshe na e jep dhe vetë autori portretin e Mirës.

Romani "Dasma e Mirës" është më tepër se një libër familjar, është një prozë e shkruar ndryshe nga sa kemi lexuar deri më tashmë. Edhe libri tjetër me poezi "Hej oficer" të lë mbresa të thella poezi e këtij ish ushtaraku të lartë ku do tju drejtohet ish kolegëve të tij: "Ju përshëndes ju / flokëbardhëve / e të kërrusur / nga pesha e viteve / që keni kaluar..."

Ish ushtaraku Mehmet Dume, edhe pse në pension nuk resht asnjë herë, bredh si bleta e na sjell ne nektarin porzën dhe poezinë më të bukur: Ja se çfarë thotë në një varg:

"Jeta ime kështu që / Su gëzova



asnjëherë / Thirrjet shkuan gjer në re / Tërë jetën mbeta i mjerë..."

Një poezi vërtet apel që autori rrekjet jo më kot të kërkojë atë që me të drejtë ju takon ish ushtarakëve. Në të gjitha shkrimet dhe poezitë e Mehmet Dumes vruullojnë mesazhe jete, vruillon dashuri njerëzore, urejtje nda fallsitetit pushtetar. Urime biri i Çepanit të Skraparit! Kurdoherë të këndoftë pena siç të ka kënduar pushka, o ushtarak, o brez i artë i Arbërisë. /M.Buci.

**PROMOVIM LIBRI**

**Dr. Nexhat Agolli - atdhetar i harruar**



Diten e enjte dt. 19 Korrik 2012 ora 19:00 ne sallën e Teatrit ne Diber te Madhe-Maqedoni, u promovua libri me karakter biografik mbi politikanin dhe juristin Dr. Nexhat Agolli, i lindur me 1914 ne Diber te Madhe dhe i vrare pabesisht nga trupat serbe me 28 prill te 1949. Ky liber monografie ishte i pergatitur nga ish-Diplomati dhe politologu Tetovar Mahi Nesimi.

Te pranishem ne kete aktivitet promovues ishin Kryetari i Komunes Diber e Madhe-Maqedoni Dr. Argetim Fida, intelektual dhe personalitete te tjera te artit, kultures, te arsimit dibrane etj. Te ftuar nga Tirana per promovimin e librit ishin, Kryetaria e Komitetit per Rugen e Arberit Znj. Yllka Causholli, si dhe dy nenkryetaret e Komitetit per Rugen e Arberit, Inxh. Tofik Jegeni dhe perfaqesuesi per Diasporen Shqiptare ne SHBA, Z. Ibrahim Kolari, Kryetari i Shoqates Kosova Z. Dashamir Uruci, Poeti Agim Doci, si dhe mjaft dashamires te librit dhe kultures.

Kryetari i Shoqates Bashkesia Dibrane Z. Faruk Borova ne pamundesi per te qene prezent ne kete aktivitet, pershendeti promovimin dhe ftesen e organizatoreve. Per rolin dhe veprimtarine e atdhetarit Dr. Nexhat Agolli, fjalën e moren studiet dhe historian, te cilet ngjallen ne zemrat e te pranishmeve kujtime historike nga e kaluara dhe veprimtaria patriotike dhe luftarake e Nexhat Agollit si dhe nga pabesia e vrasjes se tij ne praneveren e vitit 1949. Kryetari i Komunes Diber e Madhe-Maqedoni Z. Argetim Fida pershendeti aktivitetin dhe te pranishmit, duke theksuar ne fjalën e tij se per ne si dibrane figura te tilla si ajo e Nexhat Agollit na nderojne si komb, e te tilla figura duhet te promovohen dhe jo te lihen ne harrese nga ne. Ndersa Kryetaria e Komitetit per Rugen e Arberit

Znj. Yllka Causholli, falenderoj iniciatoret e aktivitetit per ftesen e tyre per te qene te pranishem ne kete promovim, per kete figure kaq te lart te kombit shqiptar. Ajo gjithashtu informoj publikun dibran per iniciativat e rendesishme qe qeveria shqiptare po nderrmer per perfundimin me procedura te pershpejtuara dhe me sukses te Ruges se Arberit, si dhe te pjeseve me te veshtira te saj. Ndersa kryetari i Shoqates Kosova Z. Dashamir Uruci, solli ne ndergjegjen e publikut dibrane mbesa dhe kujtime fisnikerie nga figura e paharuar e atdhetarit Agolli. Ne kete promovim poeti kombetar Agim Doci solli permes fjaleve poetike kujtime dhe vleresime per rolin fisnik te Nexhat Agollit si figure kombetare.

Ne fund fjalën e mori autori i librit Z. Mahi Nesimi i cili tregoj per publikun se cilat ishin impresionet qe e ben te mundur qe ai te nderrmerte kete iniciative per botimin e biografise dhe te vepres se atdhetarit Nexhat Agolli, ku historiografia shqiptare duhej te shkruante kohe me pare per te-theksoi autori. Aktiviteti u mbyll me nje koktej per te pranishmit.

/ Saimir Shatku



**Të ruajmë traditat**

Nga: **SHUKRI HAJDARI**

Shkolla 9 vjeçare e Gjoricës në rrethin e Bulqizës është ndër më të dalluarat jo vetëm në procesin e mësimin e të edukimit por edhe në veprimtaritë kulturore artistike e fizikurore e sportive si pjesë e pa ndarë e gjithë punës në shkollë. Shumë nga bashkëvendësat e mi kujtojnë me nostalgji veprimtaritë e lojrat sportive dhe argëtuese që zhvilloheshin në fshatrat tona. Ishte krijuar një traditë dhe sot ndjejmë një kënaqësi që jo vetëm nuk kanë humbur por po ruhen e çohen përpara edhe në saj të ndihmës që japin vazhdimisht shkolla dhe mësuesit e edukimit fizik Ermira Dumani dhe Edmond Miftari. Gjorica ka patur ekupe që kanë konkuruar denjësisht në fshatrat e tjerë duke përfaqësuar dhe rrethin në veprimtari kombëtare. Mjaft të rinj edhe sot ndjekin shembullin e mirë të volejbollistëve Fadil Cani, Zenel Izvira, Munir Tola, Bashkim Lila etj që me punën e pasionin e tyre mbajtën gjallë lëvizjen fizikurore dhe sportive në komunën tonë e më gjërë. Veprimtaritë në shkollën e Gjoricës fillojnë me kampionatet e garat midis klasave në futboll, volejboll, atletikë, kroset për tu zgjedhur pastaj dhe ekipet që do të përfaqësojnë shkollën. Është synu-

ar të përfshihen një masë sa më e madhe e nxënësve me objektivin që mundësisht çdo nxënës të meret me një lloj sporti. Takimet me shkollat e tjera si me Kllobçishtin (Maqellarë), Shupenzën, Viçishtin, në volejboll për vajza dhe djem është ruajtur jo vetëm tradita e fitoreve, por është punuar me objektiv për të zhvilluar lojra mjaft të bukura nëpërmjet përdorimit gjithnjë e më mirë të elementëve teknik në lojën e volejbollit duke fituar admirimin e mjaft sportdashëve. Për nxënësit e dalluar janë dhënë stimuj të ndryshëm, fletë nderi etj. Viti 2012 si vit i 100 vjetorit të shpalljes pavarësisë e ka bërë më të gjallë dhe të larmishme jetën kulturore dhe artistike të shkollës. Periodikisht jepen shfaqje me tematikë të veçantë sipas ngjarjeve apo festive që organizohen. Konkursi i fjalës artistike i zërave më të bukur etj. Në prag të mbylljes së vitit shkollor u dha një koncert me këngë e recitime. Një monolog me fragmente të shkurtëra u pregaditën nga drama "Epoka para gjyqit" sid he komedia 14 vjeç dhëndër"

U dalluan nxënësit Mirela Kaci, Xhoana Dumani, Xhesika Markja, etj. Shfaqja u ndoq nga prindër, nxënës e mësues të shkollës. Dekorimit të disa mësuesve "Qytetar nderi" të komunës tonë shkolla i kushtoi një vëmendje e pregaditje

dinjitoze. Angazhimi i mësuesve, drejtorit të shkollës Shaban Izvira i tejkaloi parashikimet tona për një veprimtari që la mbresa e krijoi emocione që nuk do të harrohen kurrë nga pjesëmarrësit e shumë të që kishin mbushur sallën. Meritë të veçantë për mbajtjen dhe freskimin e repertorit të shfaqjeve ka edhe mësuesi i muzikës Hajri Alimani. Drejtorja e shkollës ka koordinuar mjaft mirë ndihmën dhe bashkëpunimin e mësuesve ku vlen të përmendet puna e mirë e Liljana Xhekës, Donika Bardhit etj. Për një bashkëpunim të tillë shkolla jonë u vlerësua edhe nga ministria e arsimit dhe shkencës për hartimin dhe realizimin e projektit për ruajtjen e mjedisit. Bashkëpunimi me komunën ka qenë mjaft efektiv dhe inkurajues. Në saj të këtij bashkëpunimi për nxënës të dalluar rreth 65, për nxënës me aftësi të kufizuara 10, për nxënës jetim 5 janë dhënë shpërblime e stimuj material. Gjithashtu për nxënësit e dalluar në veprimtaritë kulturore artistike e fizikurore e sportive u organizua edhe një eskursion në Lezhë me mjaft vlera njohëse dhe educative. Kjo përvojë është mirë të ruhet, ajo tashmë është kthyer në një traditë që duhet çuar përpara.

\* Mësues në shkollën 9 vjeçare Gjoric

Doni te informoni komunitetin rreth jush per di cka qe ju intereson atyre?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

# Sali Çaka dhe diktatura

tregim

Nga QAZIM HATA

**N**uk mbaj mend se çfarë viti ka qenë, vetëm se di se kam qenë fëmijë i vogël, ka qenë verë dhe ndoshta muaj gusht. Sapo kishte rënë muzgu në fshat dhe qe një natë e zakonshme e asaj stine të nxehtë e të thatë. Në fakt, ato ishin mbrëmje të magjishme vere, e cila rrëshqiste ngadalë dhe pa u ndier mbi fshatin tonë, që jetonte për hir të ëndërrimit.

Gjithçka ishte ëndërr, pasi realiteti, po ta mendoje thellë dhe të gjykoje rreth tij, ishte i frikshëm. Ndoshta, prandaj ne fëmijët i dëgjonim me aq kureshtje e babëzi rrëfimet e vëllait të madh, i cili aso kohe, megjithëse adoleshent, lexonte shumë dhe na e mbushte kohën me rrëfime nga më trilleret dhe më fantastiket, brenda të cilëve gëlonte një jetë e panjohur dhe që na joshte me shpirtin e aventurës dhe të lirisë.

Ne vëllezerit më të vegjël, por dhe vërsnikët tanë, që mblidheshin në shtëpinë tonë të madhe, mezi prisnim që ai të niste rrëfimet që s'kishin të sosur, të cilat i shoqëronte me një muzikë të improvizuar aty për aty, që tentonte të imitonte sekuencat filmike apo dramatike të filmave apo dramave, që jepte i vetmi kanal televiziv shtetëror.

Në një nga këto netë, dy krisma çanë ajrin e bymyer të mbrëmjes verore dhe pastaj ato u pasuan nga dhjetëra të tjera, me breshëri, që herë zgjateshin e zgjateshin pafundësisht, herë ndërpriteshin si gjuhëza të frikshme...

-Po perëndon një epokë, -tha vëllai ynë i madh dhe ne pamë të mahnitur profilin e tij ëndërrimtar, të hequr e të dobët, sikur po thoshte një zbulim të madh, që i kishte munguar deri atëherë njerëzimit.

Sakaq si rrufeja në fshat u përhap lajmi se një i burgosur politik kishte thyer burgun e Spaçit dhe endej anëve tona, në kërkim të një shtegu për të ikur jashtë atdheut. Babai iku me ngut, veshur me kapotën ushtarake dhe një pushkë simanove zbori, nën tingujt e çangës së kooperativës, që kumbonte si një shpirt i keq. Teksa shtynte prapa derën e avllisë, ai nëmte e mallkonte atë çangë të ndyrë dhe soj e sorollop që komandonin rënien e saj ogurzezë. E kishin ngritur me ngut nga prehja e tij e pakët, pas punës së rëndë në fermë, pasi qe dhënë alarmi, se një i quajtur Sali Çaka pati përdhosur faltoren gjyotinë të komunizmit, burgun politik, duke u arratisur nga telat me gjëmba, nën hundën e rojeve të vdekjes së paralajmëruar.

Përsëri tingujt e çangës çanë ajrin e trashë të asaj stine të thatë. Tani çanga binte me ngut, me alarm, me ngulm, a thua se kishte filluar ndonjë luftë... Një gjë ishte e sigurtë për ne fëmijët, se diçka po ndodhte. Shikonim njëri-tjetrin në sy dhe nuk flisnim.

Edhe nëna dukej e trishtuar. Ajo nuk ishte në gjendje të shpjegonte rreth asaj që po ndodhte. Vëllai ynë i madh ishte disi më i vetëdijshëm rreth asaj që po ndodhte. Ai fliste shumë rrallë dhe me fjalë qetësuese. Në fytyrën e tij dukej qartë tronditja. Atë natë nuk hëngrëm darkë. Na qe prerë oreksi nga frika e trishtimi. Zakonisht ne flinin në katin e parë të shtëpisë, por atë natë fjetëm në katin e dytë. Fjetëm të gjithë fëmijët nën një jorgan, ndryshe nga herët e tjera. Gjumi na zuri shumë vonë. Aty nga ora dy e mesnatës, ra porta e madhe e shtëpisë. Nëna u ngrit dhe e hapi. Ishte babai, i cili në krah mbante pushkën simanove dhe qe veshur ushtarake. Pasi babai hoqi pushkën nga krahu, nisi të tregonte rreth asaj që kishte ngjarë.

"E kapën të shkretin", -nisi rrëfimin ai. "E kapën",

murmurinte babai me një zë të mekur e të mbytur, që sikur i dilte nga një pus i nëndheshëm. "Kë kapën?, -pyeti nëna. "Sali Çakën, - u përgjigj babai. Unë u tremba shumë. M'u sikur babai tha se kishin kapur Sali Kaçakun. Kaçakët i kisha shumë frikë. Ata i konsideroja si njerëzit më të rrezikshëm në botë, se gjyshja më tregonte histori të shumta me kaçakë. Ajo thoshte se ishin histori të vërteta.

Babai vazhdonte të tregonte për Sali Çakën dhe jo për Sali Kaçakun. Atë e kishin kapur në fshatin Venisht. Babai ishte i pikëlluar për kapjen e tij. Kur e kishin kapur, në dorë i kishin gjetur një sqepar të vjetër. Këmbët i kishte pasur të zbathura e të gjakosura. Në njërin xhep të xhakëtës i kishin gjetur dy kokrra domate të squllura. Domatet i kishte marrë në Arat e Përroit të Mandrres, ku roje pati rastisur një bashkëfshatari ynë. Roja thoshin se e kishte njohur dhe e kishte orientuar për t'u larguar. Sot edhe mua më besohet se kështu ka ndodhur, për faktin se ky njeri, që qe roje domatesh në atë kohë, qe një antikomunist i vendosur. Gjë të cilën e tregoi me vepra, gjer ditën që u nda nga jeta. Ky qe Kasem Skarra nga fshati Shumbat.

Sali Çaka kishte qenë një oficer tepër i përgatitur. Ai kishte qenë dhe patriot i vërtetë. Disa vite kishte shërbyer dhe në repartin ushtarak të Venishtit, ku baballarët tanë bënin zborin. Kam dëgjuar shpesh tek flisnin për cilësitë e rralla të tij.

Ai kishte qenë nga Progonati i Tepelenës. Regjimi komunist e pati dënua me vite të gjata burgu në burgun famëkeq të Spaçit. Akuzat ndaj tij kishin qenë absurde. Pra, ky njeri i mirë e fisnik u dënua politikisht. Saliu, së bashku me një shokun e tij, arritën të arratiseshin nga burgu i Spaçit. Pas kësaj arratisje, i gjithë veriu i vendit u vu në gadishmëri. Tani më kujtohet se dhe ne fëmijëve të shkollës na shpërndanin nëpër pyll, duke rrahur dushqet me shkop, se pyje nuk pati më. Ne kërkonim pa e ditur se çfarë kërkonim. Të gjithë levat e shtetit komunist qenë vënë në ndjekje. Sigurimi i Shtetit, ministria e Brendshme, policia, repartet ushtarake, organizatat e masave dhe të gjithë bashkëpunëtorët e regjimit, kishin zënë të gjitha rrugët dhe shtigjet e mundshme.

Në natën e tretë të arratisjes, Saliu dhe shokun e tij i panë për herë të parë në lumin Drin, afër fshatit të quajtur Fushë Alie. Ishte natë. Prozhektorët e shumtë do të ndriçonin të gjitha shtigjet e lumit Drin. Shoku i Saliut nuk kishte ditur not, por Saliu e kishte vënë në shpinë dhe i kishte hyrë Drinit me not. Sapo ata qenë futur në ujë, mbi ta do të derdhej një lum me plumba.

Shokun e tij, megjithëse të plagosur rëndë, arriti ta nxjerrë në anën tjetër të lumit. Saliu e kish mbuluar shokun me ca dega shelgu të thata, e kishte përqaftuar fort dhe ishte ndarë prej tij, duke i premtuar se do të kthehej ta merrte sapo të qetësohej pak gjendja. Të gjitha këto veprime të shpejta ai i kishte bërë nën trysninë e plumbave të Diktaturës.

Rruga nga lumi Drin deri mbi fshatin Venisht mban mbi dy orë. Sali Çaka, zbathur, zhveshur, i pangrënë, do ta bënte këtë rrugë vetëm për dyzet minuta. Ai e njihte mirë terrenin, shtigjet, por lodhja gjer në rraskapitje, çfilitja dhe dhimbja për shokun që kishte lënë duke luftuar me vdekjen, ia kishin humbur orientimin. Ai qe afruar fare pranë repartit ushtarak të Venishtit ku dhe pati shërbyer për disa vite. Këtu e zunë Sali Çakën. Atij nuk i ishte dridhur aspak qerpiku i syrit. Në fytyrën e tij, rrëfente babai, vërehej një krenari e pa parë. Ai nuk pyeste për vete, por interesohet për fatin e shokut të tij të plagosur. Shokun e tij e kishin gjetur mbuluar me shelgje, të gjakosur për vdekje.

Pas dyzet minutash, kishte ndërruar jetë. Atë minutë që kishin arrestuar Saliun, atë minutë qe ndarë nga jeta shoku i tij i ngushtë. Se ç'u bë me trupin e të vdekurit nga plumbat e regjimit, nuk e mori vesh njeri. Ky qe fati i jetës dhe i vdekjes në vendin tim, në kohën e një regjimi absurd. Saliu e çuan prapë në burg, prej të cilit doli pas shumë kohësh, vetëm kur ra komunizmi.

Me fillimin e demokracisë, mora vesh se e kishin caktuar komandant në pikën kufitare të Kakavijës. M'u bë qefti shumë kur e pashë për herë të parë në ekranin e televizionit. Duke dhënë një intervistë, në lidhje me detyrën që mbante. Njëkohësisht, u ndjeva keq. Kjo detyrë m'u duk fare e vogël dhe e parëndësishme për një njeri që pati vuajtur aq shumë në emër të lirisë.

Haja veten me dhëmbë kur mendoja se persona që i kishin shërbyer me zell regjimit kriminal hiqeshin si apostuj të regjimit të ri demokratik dhe mbanin detyra e poste shumë më të larta se të Sali Çakës.

M'u kujtuan fjalët e vëllait të madh, atë natë të largët të arratisjes së Sali Çakës "Po perëndon një epokë". Edhe sot, pas kaq vitesh, koha ka ngecur në një keqkuptim të madh. Por vëllai kishte të drejtë, se ajo epokë pati perënduar në shpirtin e tij të lirë, por në reaitetin e gjallë, imazhi i saj gri nuk ka perënduar as sot, kur flitet aq shumë për lirinë e individit dhe shoqërinë demokratike.



Keni nje liber per te promovuar?

vetem shkruani ne emailin

<rrugaearberit@gmail.com>

**"Jeta është si një libër me dy kapak ku njërin kapak dhe fletët e librit i kam shkruar. Më mbetet vetëm kapaku i dytë të cilin do ta mbyll këtu në fshat"**

# Njeriu i mirë Vexhi Hoxha

**"Po nuk u kënaqe kur jep, nuk kënaqesh kur merr"**

Nga RRUZHDI BITRI

Gjithmonë ndodh që kur disa njerëz të mos i kemi mes nesh, të na lënë pas vlerat e tyre, e kur këto vlera bëhen pasuri e të gjithëve, themi se këto njerëz janë mes nesh. I tillë është edhe Vexhi Hoxha i Bliçes, emri i të cilit nuk është shkruar vetëm në gurin e varrit të tij, por ka mbetur në kujtesën e bashkëfshatarëve të mi dhe në gjithë pellgun nga Peshkopia e deri në Reç, nga Selishta e deri në Kala të Dodës, si njeriu i mirë i Bliçes.

Vexhi Hoxha u lind më 24 prill të vitit 1926 në një familje të varfër por që jetonin me punë e ndershmëri të madhe. Vlerave dhe emrave të shumtë të këtij fisi do ti shtohet dhe emri i Vexhiut ose Xhiut siç do të thërrijet nga vëllezërit e fëmijët e tij e më pas nga të gjithë bashkëfshatarët. Jeta e ndëshkoi me vdekjen e babait të tij ku mbeti jetim në moshën 13 vjeçare. Që nga ky moment do të binin mbi shpatullat e tij të njoma përgjegjësia për të rritur bashkë me nënë Zatiën 3 vëllezërit dhe motrën: Faikon, Xhemalin, Shamen dhe Esatin. Puna e rëndë e bujqësisë që në këtë moshë Xhiun e poqi para kohe. Fati i madh zonës tonë ishte hapja e të parës shkollë e cilësisë më të lartë siç ishte Internati i Kastriotit. Në këtë shkollë me emër të mirë u arsimuan bashkë me Vexhiun edhe emrat e njohur si Xhavit Spata, Xhemal Bitri e Selman Tota. Të gjithë këto emra kanë qenë shokë klase me Besa Imamin (Artiste e Popullit). Vexhi Hoxha e mbaron këtë shkollë në vitin 1939 me rezultate shumë të larta ku deftesa e tij mban emrin e drejtorit Ferit Imami. Mbarimi i luftës e gjeti të pjekur por edhe me pasione e kërkesa të mëdha për jetën. Megjithë kërkesat që iu bënë herë pas here nga Selim Alliu (mësues i popullit) për tu bashkuar me armatën e madhe të mësuesve, Vexhiu me dashamirësi nuk pranoi, sepse ai tashmë kishte filluar të mësonte në mënyrë audidakte arabishten për tu bërë vite më vonë imam i përkryer. Ndiqja e pakursyer që i dha Ramadan Hoxha, si një ndër hoxhallarët më të kualifikuar dhe më me zë në trevën dibrane, e bënë Vexhiun që të çertefikohej si imam nga Myftyu i Dibrës Sali Ferhati dhe në vitin 1949 ai emërohet imam i Bliçes së poshtme. Detyrën e imamit do ta kryente deri kur vdekja aksidentale më 2 maj 1999 do ta ndante nga kjo botë. Pasi filloi detyrën e imamit të Bliçes së poshtme atij iu rritën përgjegjësitë. Rritja dhe arsimimi i vëllezërve ishte detyrë që i buronte nga shpirti i madh që kishte ky njeri. Martesa e tij në vitin 1956 me vajzën e Rustem Bitrit (Arzen) do ti sillte përveç mirësive edhe luftën politike pasi Rustem Bitri ishte i pushkatuari i parë nga diktatura komuniste në fshatin Bliçe në vitin 1946. Megjithë hijen politike tashmë ai do të vazhdonte të ishte po aq i lidhur me njerëzit e fshatit e më gjërë.

Cilësitë e tij të punës dhe përkushtimit, pasionit të klerikut dhe marrëdhënjeve me njerëzit do ta rrisnin atë së tepërmi. Nga shërbimet e veçanta që kryen hoxhallarët e Bliçes si Ramadani ashtu dhe Vexhiu ishte lufta kundër analfabetizmit. Akoma i kanë të freskëta njerëzit kurset në gjuhën shqipe që organizonin këto të dy nga vitet 1952-1960. Këto kurse nuk bëheshin për moshat shkollore, pasi shkolla e fshatit ishte hapur qysh në vitin 1946 dhe kishte filluar të arsimonte në mënyrë shumë cilësore djemtë e vajzat e fshatit. I mbujtur me dashuri të madhe për njerëzit, për dijen, punën, këshillat e tij dhe zgjidhjet që u jepte situatave të vështira do

të ktheheshin në urtësitë e njeriut të mirë. Nga viti 1967 e deri në vitet 1990, edhe pse feja ishte e ndaluar Vexhiu nuk i ndërpreu për asnjë çast shërbesat fetare, për njerëzit e fshatit dhe më gjërë në fshatrat e zonës. Këto shërbesa i kryente natën dhe pa asnjë lloj shpërblimi. Vitet që do të kalonin do ta gjenin Vexhiun në të gjitha frontet e vështira të punës në kooperativë. Ndërgjegja e tij e lartë do të ishte modeli më i mirë për njerëzit. I mbujtur me idenë se vetëm djersa të gëzon, ai brumosi edhe tek djemtë e tij cilësitë e punës e të ndershmërisë. Të katër djemtë e tij; Ramazani, Haliti, Shefqeti e Limani u rritën dhe edukuan me këto cilësi të larta ku dhe do të sihin nxënësit më të mirë në të gjitha shkollat që ndoqën. Marrëdhënjet në familje, me grua dhe djemtë i kishte shumë të hapura. Ai ishte i vetmi në fshat që në rritjen dhe edukimin e fëmijëve përdori vetëm fjalën dhe shembullin e mirë në edukimin e fëmijëve. Motoja e tij ishte "harami të kthen prapa" dhe këtë moto u kultivoi edhe fëmijëve të tij. Punët shoqërore do ti merrnin një pjesë të mirë të kohës, por do ti shpalosnin e dhe shpirtin e tij të madh. Kur njëri nga djemtë e tij kishte siguruar një leje pune për në Ndërmarjen bujqësore, Vexhiu si kryetar këshilli ia jep një familje tjetër në fshat: "Ka më shumë nevojë ajo familje, i thotë të birit me qetësinë e tij që e karakterizonte. Ka patur mjaft raste që në dyqanin e bukës kishte familjar që prisnin të

merrnin bukën e fëmijëve pa lek dhe rrinin të struktur deri sa të mbaronte radha. Në një rast të tillë Vexhiu paguan bukën e 4 personave. Kur i biri i në darkë i kërkonte lek për të blerë ushqime ky ia kthen: "Të tjerët janë pa bukë, ne do bëjmë pa ushqime". Shpesh në bisedë me të tjerët do të shprehej: "Po nuk u kënaqe kur jep, nuk do kënaqesh kur merr". Kurse të rinjëve u thoshte shpesh: "Kujdes me forcën, përdoreni atë për ndihmë. Takati e mendja shiten vetë"

Vitet tetëdhjet kur ishte bërë tufëzimi dhe ishte ndaluar pazari shkon në Zalldardhë për të blerë një lopë bashkë me djalin e tij. Pasi djali e uli pazarin edhe pesë mijë lek u nisën për në fshat. Rugës filloi të zihej me djalin se i kishte hyrë në hak atij që i blenë lopën. Në darkë u thotë fëmijëve se këtë lopë unë nuk e bëj hallall po nuk i çuam pesë mijë lekët familjes që blemë lopën. Dhe në fakt kështu u bë. Nuk ka bashkëfshatar që të mos ketë marrë ndihmën e Xhiut në momente të caktuara. Përgjigja e vetme që të jepte në këto raste ishte: "Po si ore, vij menjëherë dhe linte punën e tij përgjysmë e nisëj atje ku e kërkoni. Vitet nëntëdhjet e gjetën Vexhiun imam zyrtar (sepse detyrën e kishte kryer në ilegalitet) të fshatit Bliçe e Poshtme dhe për ca kohë imam i të dy xhamive. Djemtë e tij bashkë me të shumtët nga fshati u sistemuan në Tiranë dhe filluan të investojnë djerësen, mendjen e punën për tu integruar në



metropol, ndërsa Vexhiu vazhdonte të shërbente në fshatrat e Çidhnës. Dy muaj para vdekjes, njëri nga djemtë kishte shkruar për ti mbushur mendjen për të ardhur në Tiranë. Ai iu përgjigj djalit: "Jeta është si një libër me dy kapak ku njërin kapak dhe fletët e librit i kam shkruar. Më mbetet vetëm kapaku i dytë të cilin do ta mbyll këtu në fshat". Dhe vërtet me librin e Mevludit në dorë vdes aksidentalisht në vendin e quajtur "Guri i xhenazes" vend ku kishte falur vetë sa e sa të vdekur nga fshati. Në varrimin e tij më 2 maj 1999, Myftyu i Dibrës Ahmet Çushi do të thoshte: "Është rast i rrallë që një shërbyes i fjalës së Zotit me librin e mevludit të dorë të ndahet nga jeta. Ky ishte njeriu i mirë Vexhi Hoxha nga fshati Bliçe. Sot që mungon fizikisht ka lënë pas urtësinë dhe modelin e njeriut të mirë. Ah sikur njerëzit të kishin shpirtin e tij bota do të ishte ndryshe."

## Ju tregoj për "grupin armiqësor" të Shupenzës

(Vijon nga faqja 14)

privat. Vajza e madhe Shazia, me mbarimin e shkollës 8-vjeçare, fitoi garat për shkollën e fizikulturës, por nuk iu dha e drejta për vijimin e saj. Shkurt nga 7 fëmijët e mi asnjëri nuk i është dhënë e drejta të vijojë arsimin e lartë, por vetëm të mesëm edhe atë bujqësor dhe jo gjimnaz. Dhe e gjitha kjo për shkak të biografisë së keqe. Nga të 7 fëmijët vetëm njërin kam martuar si shokët me dasëm, të gjithë martesat e tjera të fëmijëve janë bërë pa dasëm për shkak të biografisë së keqe.

**- Ku e keni vuajtur dënimin dhe sa vite ?**

Fillimisht pas dënimit kam shkuar në burgun e Ballshit Fier, ku kam qendruar për 7 vite. Pastaj në Spaç Mirditë, 10 vite ku dhe jam liruar pasi vuajta plot 17 vite burg. Gjatë gjithë periudhës së qendrimit në burg kam punuar në ndërtim dhe jo në galeri për nxjerrjen e mineraleve pasi gjendja ime shëndetësore ishte rënduar së tepërmi nga torturat çnjerëzore që mu bënë në hetuesi që vetëm natës së vorrit ja tregofsha.

**- Mund të na përshkruani si erdhi lirimi juaj?**

Janar '91, isha në Durrës. Punoja tek vilat e udhëheqjes. Në një mbrëmje teksa po ndiqnim televizionin jepet lajmi se për kategorinë e të persekutuarve politikë nuk përfitojnë lirimin nga burgu të dënuarit "për tradhëti të lartë ndaj atdheut", "terrorizëm" dhe "spionazhi direkt". Kështu sipas këtij informacioni mediatik unë nuk përfitoja lirimin nga burgu. Të nesërmen pasi na reshtojnë, emir im lexohet i pari, duke më veçuar së bashku me 5 persona të tjerë që na rikthyen brënda burgut për vijimin e vuajtjes së dënimit. Qendrojmë edhe 9 ditë të tjera, ku më pas 3 prej nesh lirohen përfshirë edhe unë dhe 3 të tjerë mbeten sërish në burg. Pas lirimit nuk mund të harroj dashamirësinë e policëve që u interesuan për transportin tonë drejt vendbanimeve. Ishte mbrëmje vonë kur nga Durrësi përfundua në Milot, ku policia u interesua për akomodimin tonë në ambientet e kësaj policie për kalimin e natës. Për herë të parë atë natë dëgjua thirrjet e policëve "poshtë Enver Hoxha". Të nesërmen policia në siguroi udhëtimin drejt shtëpive tona.

**- Çfarë ndjetë kur pas 17 vitesh u rikthyet në vendlindjen tuaj Boçevë të Shupenzës?**

Natyrisht mall për vendlindjen, familiarët, miqtë dhe njerëzit dhe një lloj ankthi se si do më presin, a do më afrohen apo do vazhdojnë të më trajtojnë si "delja e zezë". Dhe këto dyshime

shpejt u provuan pasi dita që unë u riktheva përkonte me vdekjen e gruas së xhaxhait e cila në njëfarë mënyre më kishte rritur. Pasi merret vesh rikthimi im, vetëm djemtë erdhën për të më takuar dhe jo farefisi. Në mungesë të pjesmarrjes në funeralin e përcjelljes për në varreza të bashkëshortes së xhaxhait, pasi ende nuk isha çliruar nga të qenit me biografi të keqe, kërkoi dhe realizoj një ndalesë të kortezhit në rrugë për t'i dhënë lamtumirën e fundit asaj.

**- Po më pas si rrodhën ngjarjet dhe tashmë pas fitores së demokracisë a ndjeheni të rehabilituar?**

Pas '92 u përfshiva intensivisht në proceset demokratike dhe që nga viti '95 e në vazhdim ushtroj detyrën e kryetarit të Shoqatës të Persekutuarve Politik të Rrethit Bulqizë. Buzëqesh siç dhe e ka zakon ky njeri i mirë, që vitet e burgut nuk ja kanë zbehur aspak vlerat e larta njerëzore të mirënjohjes, mirkuptimit dhe dashurisë për njerëzit, pa mlllef dhe qefmbetje me askënd, pas një pauze të shkurtër vijon: - Nuk mund të them se jam i zhgënjyer nga proceset demokratike, por ka raste që brengosem kur shoh se roli i shoqatës sa vjen dhe po asfiksohet duke i mbetur vetëm emri. - S'ka sesi të mos brengosesh kur shoh se ish hetuesi im që ka ushtruar ndaj meje torturat nga më çnjerëzoret, arriti të ngjisë shkallët e karrierës njëlloj si në diktaturën komuniste, duke punuar si zyrtar i lartë i shtetit në Kuvendin e Shqipërisë. Ndërsa nga familja ime, 7 fëmijë dhe dhjetra nipër e mbesa, asnjë i punësuar në shtet. E megjithatë, pa as mëdyshjen më të vogël, sa të jem gjallë zemra dhe shpirti im kanë qenë e mbeten në përkrahje të reformave për konsolidimin e demokracisë në vendin tonë.

**- Jeni kompensuar për vitet e qendrimit në burg dhe sa keni përfituar deri më tani?**

Deri më tani, përfshirë edhe letrat me vlerë, kam përfituar vetëm 10 milion lekë të vjetër. Mbeten ende për tu marrë edhe rreth 90 milion lekë, por rrezik se unë nuk do t'i gëzoj ata pasi moshë dhe vitet e qendrimit në burg bëjnë të vetën, por do t'i gëzojnë fëmijët e mi të cilët për shkakun tim edhe pse pa faj, vuajtën në pjesën më të mirë të jetës, rininë e tyre.

**- Me këtë pamje që keni ju dukeni krejt gjallëri e jetë!**

Pasi bën një qeshje të lehtë, gjë që e ka shoqëruar gjatë gjithë këtij rrëfimi, krejt fisnikëri shton: - Pavarësisht moshës dhe vuajtjeve, janë fëmijët, nipërit e mbesat që më entuziazmojnë e motivojnë për tu ndjerë mirë. Janë pikërisht këta që më japin forca e më bëjnë optimist dhe të ndjehem ende i fortë, pse jo, i rinuar!

Së shpejti në qarkullim

# HISTORIA E DIBRËS

nga **PROF. KRISTO FRASHËRI**



Në muajin shtator të këtij viti do të botohet libri "**HISTORIA E DIBRËS**", i historianit **Kristo Frashëri**.

Botimi i këtij libri po bëhet i mundur nga Bashkia Peshkopi, me ndihmën financiare të firmës "Selami" shpk me president z. Musa Selami, të cilët kanë paguar të drejtën e autorit.

Për kontribute për botimin e librit  
në një tirazh më të madh dhe çmim të arsyeshëm për sa më shumë lexues,  
ftojmë biznesmenë dhe individë të japin ndihmën e tyre në këtë botim historik për Dibrën.

Kontributet e tyre do të bëhen publike dhe njëkohësisht do të reklamohen  
për çdo rast të publicitetit të librit.

Për të dhënë ndihmesën tuaj ose për më shumë informacion,  
mund të kontaktojnë në këtë numër telefoni:

**+355 69 20 68 603**

ose mund të na shkruajnë email

**<mbbotime@gmail.com>**

*Stafi i M&B*